1.1 Zhvillimi i Sektorit Energjetik Shqiptar

Qeveria Shqiptare me 26 Qershor 2003 aprovoi Strategjine Kombetare te Energjise dhe aktualisht Qeveria është ne fazen finale te perditesimit te draft dokumentit te ri, qe është perfunduar tashme dhe është ne fazen finale te aprovimit te tij) si nje dokument baze te zhvillimit te te gjithë sektoreve energjetike deri ne vitin 2020. Strategjia analizon tre ceshtje kryesore:

- 1) situaten e furnizim-kerkeses se energjise deri ne vitin 2020;
- 2) strukturen institucionale te sektorit te energjise dhe
- 3) pergatitjen e paketes financiare dhe te skedulit kohor per implementimin e seciles mase ne baze te rekomandimeve te rezultuara nga Strategjia Kombetare e Energjise. Qellimi i Strategjise te Energjise është zhvillimi i nje sektori energjitik efektiv qe:
 - garanton sigurine e furnizimit me burime energjitike ne pergjithesi dhe ate elektrike ne vecanti,
 - Nxit perdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal ne mjedis ne menyre te tille qe sektori energjitik te jete nje sektor mbeshtetes per nje zhvillim te qendrueshem te te gjithë sektoreve ekonomik.

Objektivi Primar i Strategjise Kombetare te Energjise është:

Ristrukturimi i sektorit energjetik bazuar ne parimet e ekonomise se tregut dhe ne zhvillimin e nje politike bashkohore energjetike.

Objektivat specifike te Strategjise Kombetare te Energjise jane:

1. Rritja e sigurise dhe besueshmerise ne furnizimin me energji ne pergjithesi dhe energji elektrike ne vecanti ne nivel kombetar dhe lokal;
2. Rritja e eficiences se energjise si gjate prodhimit ashtu dhe perdorimit te burimeve energjitike me synim ndotjen minimale te mjedisit;
3. Krijimin e nje tregu elektrik konkurrues bazuar ne kerkesat e Bashkimit European per reformimin e sektorit elektroenergjitik (Direktiva 2003/54 EU) dhe detyrat e Shqiperise nen Memorandumet e Athines per mbeshtetjen e integritimit te sektorit elektroenergjitik shqiptar ne Tregun Rajonal Energjitik te Europes Juglindore.
4. Krijimi i nje sektori energjitik te afte si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike;
5. Optimizimi i sistemit te furnizimit me burime energjitike duke u mbeshtetur ne konceptin e planifikimit me kosto te ulet dhe ndikim minimal ne mjedis;

6. Rritjen e ndjeshme te investimeve ne sektorin e energjise nepermjet nxitjes se kapitalit nga Institucionet Financiare Nderkombetare si dhe kapitalit privat;

Zbatimi i Strategjise Kombetare te Energjise eshte i domosdoshem per te plotesuar detyrimet e vendit tone perkundrejt Tregut Rajonal te Energjise Elektrike ne vendet e Europes Jug-Lindore, te plotesojme te gjitha obligimet nderkombetare qe kane te bejne me mbrojtjen e mjedisit dhe te harmonizojme e konvergjoje zhvillimin e sektorit energjistik ne perputhje me Direktivat e Bashkimit Europian per te bere te mundur asocijimin e Shqiperise ne familjen Europiane.

1.2 Ndikimi ne Mjedis nga Sektori Energjetik Shqiptar

Kontaminimi i burimeve ujore vleresohet te kete qene i rendit prej 8 milion m³/vit (gjate vitit 1989), duke permbajtur 100-200 mg/l (gjate vitit 1989) te naftes bruto si dhe komponime te fenoleve dhe te sqfurit. Ndersa gjate vitit 2008 per shkak te renies se prodhimit shifrat e mesiperme llogariten afersisht 1.1 milion m³/vit. Vlen te theksohet per shkak te masave te rrepta te marra nga Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes ne bashkepunim me Ministrine e Mjedisit, duke perforcuar anen ligjore mjedisore perkundrejt kompanive te reja koncesionare eshte bere e mundur qe gjate periudhes 2008-2011 te merren nje sere masash ne drejtim te permiresimit te mjedisit ne keto zona.

Industria e naftes dhe gazit shkarkoi ne vitin 1989 rreth 23 milion m³ hidrokarbure dhe me permbajtje te koncentreve te H₂S. Humbjet ne tubacione te gazit jane te medha dhe llogaritet afersisht se emetohen ne atmosfere si emetime fugjitive rreth 15-20% te prodhimit te gazit natyror. Rafinimi i naftes eshte nje tjetere burim kryesor i ndotjes. Emisionet e SO_x nga aktivitetet e rafinimit arrinin afersisht me 1 million m³/vit per vitin 1989 dhe rreth 0.35 million m³/vit, por ndotjet e tokes dhe ujit paraqesin situaten shume me serioze. Impianti i hidropastrimit i rafinerise se Ballshit nuk ka punuar per nje numer vitesh (ai u riaktivizua ne pune gjate vitit 2001), duke cuar keshtu ne nivele te larta te ndotjes nga hidrokarburet (90-450) mg/liter, sqfuri (160-190) mg/liter dhe fenolet 3ppm.

Prodhimi i lendeve djegese ka qene nje nga kontributet kryesore te ndotjes se mjedisit ne vend. Ndotjet e ngurta nga prodhimi i qymyrit dhe naftes kur keto industri punonin me kapacitet te plote llogariteshin mbi 1.5 Mton/vit per 1989 dhe jane zvogeluar afersisht me 0.2 Mton/vit ne 2008. Megjithate, problemi me i madh jane rrjedhjet e naftes bruto dhe mbetjet e rafinerive, ne lumenjt, liqenet dhe ne fushat tona naftes mbajtese. E tere zona prej qindra km² perreth rafinerise se Ballshit dhe Fierit eshte privuar nga aromat e pakendshme, ndersa ne lumenjte dhe perrejte e ksaj zone uji eshte me nje koncentrim te larte te mbetjeve te hidrokarbureve. Teknologjia e vjeter e perdorur gjate shpimit dhe operimit te puseve te naftes dhe gazit eshte me shkarkim te sasive te rendesishme te naftes bruto nga operimet e puseve drejt lumenjve ku ato notojne (pluskojne) si shtrese siperfaqesore.

Krahasimi i emetimeve nga sektori i energjitikes ndermjet vendit tone per vite te ndryshme dhe disa nga vendeve te Bashkimit Europian per vitin 2008 eshte treguar ne figurat 1 & 2 per SO₂ dhe NO_x. Figura 1 tregon qe emetimet e SO₂ per banore ne vitin 1990 kane qene gati dy here me te medha se sa mesatarja e BE dhe per periudhen 1994-2008 keto kane rene poshte nivelit te mesatares. Figura 2 tregon qe emetimet e NO_x per banore te vendit tone jane 10-15 here me te ulta se sa ato te BE (viti 2008) dhe kjo ka ardhur kryesisht nga niveli i ulet industrial i zhvillimit te vendit.




Figura 1.: Emetimet e SO₂ nga djegia e lendeve djegese ne kg/banore per vitin 2008 (Shqiperia per vitet e shenuara).

Figura 2.: Emetimet e NO_x nga djegia e lendeve djegese ne kg/banore per vitin 2008 (Shqiperia per vitet e shenuara).

Ne figura 3 eshte dhene krahasimi i vendeve te mesiperme persa lidhet me emetimet e CO₂ per banore. Sic shihet nga figurat 3&4, Shqiperia gjate gjithe periudhes 90-2008 ka pasur emetimet me te ulta te CO₂ per banore dhe kjo lidhet me arsyet e meposhtme:

- Konsumi i energjise per banore tek ne eshte me i ulet ne krahasim me te gjithe vendet e marra ne analize;
- Prodhimi i energjise elektrike deri tani bazohet ne HEC-e;
- Sherbimet energjitike ne sektorin residencial perdorin energjine elektrike per te siguruar ngrohjen, ujin e ngrohje dhe gatimin,
- Konsumi i energjise nga sektori industrial u zvogelua per periudhen 1990-94 dhe pas ketij viti ka filluar nje rikuperim i lehte per te gjithe periudhen ne vazhdim.

Treguesi i dyte shume i rendesishem eshte emetimi i CO₂ per GDP e prodhuar te shprehur ne milion dollare (figura 4). Ashtu sic edhe tregohet ne figuren 4 ky tregues ka vlera gati 8-14 here me te medha se sa mesatarja e vendeve te zhvilluara per keto arsye kryesore:

- Teknologjite qe perdoren ne Shqiperi jane te nje niveli shume te vjeter dhe me konsum te larte energjie;
- Produktiviteti i shoqerise shqiptare eshte shume i ulet ne krahasim me vendet e industrializuara;
- Nje pjese e madhe e te gjithe burimeve energjitike eshte konsumuar ne sektorin residencial dhe ate te sherbimeve per te plotesuar komfortin e tyre dhe jo per te prodhur te mira materiale ne sektorin e industrise per te pasur vlera te larta te GDP.




Figura 3.: Emetimet e CO₂ nga djegia e lendeve djegese ne ton/banore per vitin 2008 (Shqipëria edhe per vitet e shenuara).




Figura 4.: Emetimet e CO₂ nga djegia e lendeve djegese ne ton/USD Milion GDP per vitin 2008 (Shqipëria per vitet e shenuara).

1.3 Strategjia e Zhvillimit te Sektorit Elektrik

Ne vijim do te jepen shkurt, mbeshetur ne Strategjine Kombetare te Energjise, Masterplanet e Zhvillimit te Gjenerimit, Transmetimit dhe Shperndarjes se Energjise Elektrike. Pershkrimi i tyre do te ndihmoje per te kuptuar me mire rendesine shume te madhe qe ka Nen Projekti i **Juglindjes**, si ne raport me gjenerimin, transmetimin (pjesë e te cilit ai eshte) dhe shperndarjen (tek e cila do te kete nje ndikim shume te ndjeshem) sidomos per ne Qarqet e Gjirokastrës dhe te Korces..

1.3.1 Strategjia e Zhvillimit te Masterplanit te Gjenerimit te Energjise Elektrike

Per periudhen afatshkurter (deri ne vitin 2020), dhe duke pasur parasysh edhe kohen e ndertimit te centraleve te reja, nevojat shtese gjeneruese te Shqiperise do te plotesohen vetem duke rritur importin (si ngarkese baze deri ne 2.5-3 TWh). Nderkohe, duke pasur parasysh pasigurite ne lidhje me sasite e mundshme qe do te importohen, eshte e domosdoshme te konsiderohet shtimi i kapacitetit gjenerues per te reduktuar vartesine nga importi dhe nga kushtet hidrologjike te vendit.

Shtimi i kapaciteteve te tjera termike, do te beje te mundur shfrytezimin me eficence te kapaciteteve ekzistuese te HEC-eve, per te punuar ne ngarkese mesatare dhe ne pik, per plotesimin e nevojave dhe si rrjedhim do te kete nje impakt pozitiv duke lehtesuar shkembimin e energjise se pikut (pra eksportuar ne pik) dhe duke importuar energjine ne baze. Per pasoje, eshte e rekomandueshme te mbahet ne planifikim niveli i importit te vitit 2001 (1.7 TWh/vit) se bashku me venien ne pune te TEC-it te Vlores CCGT (97 MW), i cili tashme eshte pothuajse ka mbaruar testimet perfundimtare dhe eshte vene ne pune.

Ky kombinim HEC-e ekzistuese, Import, TEC-e te reja Moderne dhe HEC-e te reja perben Masterplanin e Gjenerimit te Energjise Elektrike qe siguron furnizim te plote me energji elektrike, kosto minimale tek konsumatorët fundor dhe emetime minimale ne mjedis




Figura 5.: Masterplani i Zhvillimit te Gjenerimit te Energjise Elektrike

1.3.2 Strategjia e Zhvillimit te Masterplanit te Transmetimit te Energjise Elektrike ne vend

Rrjetat e tensionit te larte 220 kV dhe 110 kV aktualisht operojne prane limiteve te tyre termike dhe ne sistemin e transmetimit kane nivel te larte humbjesh. Implementimi i fazes se pare lejon reduktimin e humbjeve teknike, duke nderhyre ne rrjetat e TL dhe TM, duke marre parasysh ndertimin e nenstacioneve 400/110 kV, zevendesimin e sistemit 35/6 kV dhe ndertimin e nenstacioneve te reja TM/TL. Mbeshtetur ne investimet qe do te realizohen do te kemi nje reduktim te metejshem te humbjeve teknike me 10%, per te qene brenda limiteve teknike dhe ekonomike te pranueshem. Sistemi i transmetimit i propozuar sipas masterplanit perkates, arrin objektivin e humbjeve vjetore prej 2% ne vitin 2015. Ne Tabelen 1 tregohet reduktimi i humbjeve ne transmetim per periudhen 2002-2015.

Tabela 1.: Reduktimi i humbjeve ne transmetim per periudhen 2002-2015					
Viti	Humbjet ne pik (MW)	Humbjet ne pik (%)	Humbjet vjetore (GWh)	Humbjet vjetore (%)	Ngarkesa (ne ore)
2002	91	7.4	206	4.2	2264
2005	47	3.4	142	2.4	3021
2010	51	2.9	164	2.1	3216
2015	52	2.4	186	2.0	3577

Masterplani i zhvillimit te rrjetit transmetues eshte pergatitur ne menyre qe te mbuloje nevojat me nje kosto minimale, ndikim minimal ne mjedis dhe me nje sherbim cilesor te mjaftueshem dhe ne perputhje me kriteret e planifikimit. Masterplani i transmetimit eshte ndertuar ne menyre te tille qe mosfurnizimi te reduktohet vit pas viti dhe pas vitit 2009 te kemi nje furnizim te vazhdueshem. Masterplani i Pare eshte hartuar ne Strategjine Kombetare te Energjise dhe perditesuar nga OST-ja me asistencen e BE ne Qershor 2009 (figura 6). Mbeshtetur ne kushtin e mesiperm jane marre ne konsiderate te gjithe perforcimet e rrjetit qe rezultojne me perfitime ekonomike dhe qe plotesojne kerkesat teknike, per nje operim te sigurt te sistemit transmetues te integruar me sistemin e UCTE-se.




Figura 6.: Gjendja Aktuale e Sistemit te Transmetimit

Situata aktuale tregon ne menyre te qarte ne harte se e gjithë Riviera Shqiptare eshte e pa mbuluar me linja te tensionit te larte dhe kjo eshte arsyeja kryesore e pengeses se zhvillimit te shpejte turistik te kesaj zone pasi rruga tashme eshte perfunduar. Per pasoje zbatimi i Projektit te siperpermenduar (110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe nderhyrjeve minimale te domosdoshme ne nenstacionet ekzistuese te Zemlakut, Korces, Permetit dhe Memaliaj) jane nje domosdoshmeri dhe prioritetet themelor per zhvillimin e Qarqeve te Gjirokastrës dhe te Korces.

Sic u tregua ne analizen e mesiperme, zbatimi i Projektit te Juglindjes (figura 7), qe parashikohet te filloje ndertimin ne vitin 2012 (se bashku me projektin e Jugut bejne te mundur mbylljen e unazes 110 kV te Jugut), eshte i nje rendesie te vecante per sistemin elektroenergjetik pasi do te beje te mundur zgjerimin e sistemit te transmetimit ne drejtim te juglindjes.




Figura 7.: Nderhyrjet ne Rrjetin Transmetues te Vendit perfshire dy projektet: Jugut dhe Juglindjes

1.3.3 Strategjia e Zhvillimit te Masterplanit te Shperndarjes te Energjise Elektrike ne vend

Bazuar ne strategjine e reduktimit te humbjeve teknike, te dhene ne Strategjine Kombetare te Energjise, masterplani i sistemit te shperndarjes synon ne identifikimin dhe vleresimin e strategjise me te mire, per shtrirjen e rrjetit ne menyre qe ai te arrije te plotesoje nevojat ne rritje, per te gjithë kategorite e konsumatoreve me kosto minimale dhe ndikim minimal ne mjedis. Rrjetat jane te projektuara per cdo rreth dhe masterplani i shperndarjes eshte projektuar gjithashtu per secilin rajon.

Strategjia e zhvillimit te Rrjetit te Shperndarjes konsiston ne planifikimin e perparësive, kapaciteteve dhe kerkesave te investimeve ne rrjetin e Shperndarjes per periudhen 2003-2015. Ne perputhje me Studimin e Bankes Boterore, strategjia e zhvillimit te investimeve ne rrjetin e Shperndarjes do te kaloje ne dy faza:

Faza e Pare: Ka te beje me rehabilitimin e plote te ketij rrjeti me qellim reduktimin e humbjeve teknike te shperndarjes nga 15.8% deri ne 6%.

Faza e dyte: ka te beje me zgjerimin dhe fuqizimin e metejshem te ketij rrjeti, ne perputhje te plote me kerkesat e zhvillimit ekonomiko-shoqeror. Kjo do te coje ne reduktim te humbjeve nga 15.8% ne 6%.

Tabela 2.: Investimet ne sistemin e shperndarjes sipas Masterplanit perkates si dhe reduktimi i humbjeve vjetore ne shkalle kombetare			
Plani i veprimeve	Investime totale	Reduktimi i humbjeve	
	Milion US\$	Milion US\$	GWh
2002 – 2005	60.93	11.06	221
2006 – 2010	290.14	47.50	950
- Rajoni Shperndares 1	59.95	15.21	
- Rajoni Shperndares 2	108.64	14.08	
- Rajoni Shperndares 3	53.90	8.30	
- Rajoni Shperndares 4	67.65	9.91	
2011 – 2015	51.95	3.96	79
- Rajoni Shperndares 1	5.21	-	
- Rajoni Shperndares 2	17.18	2.41	
- Rajoni Shperndares 3	21.99	1.55	
- Rajoni Shperndares 4	7.57	-	
Totali	403.02	62.52	1250

Ne Masterplanin e Shperndarjes jane parashikuar te ndertohen 20 nenstacione te reja 110/20 kV, ne te cilen parashikohen te ndertohen/zgjerohen edhe nenstacionet e Projektit i Juglindjes: Zemlakut, Korces, Permetit dhe Memaliaj .

2. RENDESIA E PROJEKTIT TE JUGLINDJES: 110 kV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET-ERSEKE-KORCE-ZEMLAK DHE NDERHYRJEVE MINIMALE TE DOMOSDOSHME NE NENSTACIONET EKZISTUESE TE ZEMLAKUT, KORCES, PERMETIT DHE MEMALIAJ

Objektivat kryesore te ketij projekti jane: furnizimi ne menyre te qendrueshme me energji elektrike i rajonit Juglindor me nje popullsi rreth 350000 banore (Qarqet e Gjirokastrës dhe Korces) dhe me shume biznese sidomos ne sektorin e bujqesise, blektorise, industries dhe me potencial te zhvillimit te turizmit malor. Gjithashtu ndertimi i ketyre linjave do te beje te mundur reduktimin e humbjeve teknike ne transmetim per rajonin me te ngarkuar; permiresimi i cilesise se furnizimit me energji elektrike ne drejtim te niveleve te tensionit per te gjithë kategorite e konsumatoreve. Ky projekt do te permiresoje ne menyre te ndjeshme furnizimin me energji elektrike per Qarkut te Gjirokastrës (qe perfshin rrethet e Tepelenes dhe te Permetit) dhe te Korces (qe perfshin rrethet e Korces dhe te Ersekës) ne pergjithesi dhe ne vecanti si ne aspektin industrial, ate te turizmit dhe popullates.

Ne figurat 8&9 eshte dhene niveli i voltazhit per linjat kryesore 400 kV, 220 kV dhe 110 kV te sistemit tone elektroenergjetik. Per pasoje, qellimi baze i ketij projekti do te coje ne nje nivel tensioni normal (dominimi i ngjyres se gjelber ne te gjithë sistemin) (shiko figuren 8) duke bere te mundur ne kete menyre edhe renien e humbjeve teknike ne transmetim dhe shperndarje ne nivele te lejuara.




Figura 8.: Paraqitja e nivelit te voltazhit ne sistemin 400 kV, 220 kV dhe 110 kV (pa TEC-in e ri te Vlores dhe pa linjen 110 kV Memaliaj-Kelecyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe 110 kV Nst. Babices-Orikum-Himare-Sarande).




Figura 9.: Paraqitja e nivelit te voltazhit ne sistemin 400 kV, 220 kV dhe 110 kV (me TEC-in e ri te Vlores dhe pa linjen 110 kV Memaliaj-Kelecyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe 110 kV Nst. Babices-Orikum-Himare-Sarande).

3. TË DHËNAT PËR MJEDISIN E ZONËS KU DO TE NDERTOHEJ PROJEKTI ME TE GJITHE KOMPONETET PERBERES TE TIJ

3.1 Te dhena te pergjithshme

Ky projekt do te financohet nga investimi i Bankes Gjermane per Zhvillim KfW dhe Operatori i Sistemit te Transmetit te Shqiperise (OST) me vlere rreth 100 Milion Euro se bashku me linjen 110 kV te Jugut.

Ky projekt do te permiresoje ne menyre te ndjeshme furnizimin me energji elektrike ne Qarqet e Gjirokastrës dhe te Korces si ne aspektin industrial, sektorit te sherbimeve, turizmit dhe ate te popullates.

Sesionet ne vijim paraqesin te dhena baze lidhur me zonen ku do te zhvillohet projekti duke u fokusuar ne temat e mbrojtjes se ambjentit, burimeve njerezore, floren dhe faunen, token, ujin, klimen ajrin, peisazhin, te dhenat kulturore dhe historike te zones.

Linja e tensionit te larte 110kV e tipit me qark te dyfishte. Linja do te kete gjatesi totale, sipas variantit te trete, (i propozuar si varianti me i mire) 130.746 km nga nenstacioni i Memaliajt deri ne nenstacionin ekzistues te Korces.

Njekohesisht do te behet edhe fuqizimi/zgjerimi i nenstacioneve te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Ersekës dhe atij te Korces.

Projekti do te shtrihet ne pjesen perendimore te bregdetit Juglindore te vendit tone dhe ben pjese ne dy Qaret me te medha te Juglindjes: Gjirokaster dhe Korce. Linja ecen paralel me rrugen ekzistuese nacionale sidomos per segmentin Permet-Erseke, por eshte shmangur toka pergjate luginave ne te cilen perfshihen: rruge, kopshte, shtepi banimie qendra pushimi, ekonomi bujqesore dhe disa gurore. Si pasoje terreni ku do te kaloje linja ka karakter malor, me shkembinj, dhëra normale, me vegjetacion te rralle dhe pak bujqesi.

Pergjate rruges ka rruge hyrese ekzistuese te cilat mund te shfrytezohen per ndertimin e linjes. Pikat kendore jane propozuar ne vendet ku jane vendosur antenat e telefonise celulare, ne faqen e kodrave. Vlen te theksohet se te gjitha keto pika fundore jane vendosur pothuajse ne te gjitha rastet kur ka qene e mundeshme mbrapa kodrave me qellim qe te shmanget impakti vizual ne maksimum.

Pengesat si shtepi, antena ushtarake apo peme te ndryshme, jane perpjekur te shmangen ne maksimum gjate gjithe korridorit te linjes.

Kalimi pas kodrave eshte i domosdoshem per te shmangur parkun kombetar te Hotoves. Ne vazhdimesi te Ersekës linja kalon neper terren malor me vegjetacion te varfer. Ketu ekziston nje rruge pergjate linjes e cila do te shfrytezohet per transportin e materialeve.

Kushtet klimatike

Ne projektimin e kesaj linje jane marre parasysh temperaturat e ambjentit te cilat levizin nga -25^{0c} ne 40^{0c}. Percjellesat jane projektuar per rezistence ne temperaturat -25^{0c} dhe 85⁰ C. Temperatura me eren max. 35^{0c}, temperatura me akull (-25^{0c}). Trashesia e akullit 15 mm. Klima ne zonen e projektit karakterizohet si mesdhetare-kontinentale ku ndikimi i Mesdheut me vere te thate dhe dimer me shira te bute, ndihet pergjate bregdetit perendimor.

3.2 Popullsia dhe situata social ekonomike


Objektivat kryesore te ketij projekti jane: furnizimi ne menyre te qendrueshme me energji elektrike te i Qytezave te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Ersekës, Korces dhe Zemlakut dhe gjithe zones Juglindore me nje popullsi rreth 300000 banore dhe me shume biznese. Gjithashtu ndertimi i ketyre nenstacioneve dhe rrjetit perkates shperndares do te beje te mundur reduktimin e humbjeve teknike ne per rajonin me te ngarkuar; permiresimi i cilesise se furnizimit me energji elektrike ne drejtim te niveleve te tensionit per te gjithe kategorite e konsumatoreve.

Linja kalon neper dy qarqene ate te Korces (qe perfshin Erseken, Korcen dhe Zemlakun) dhe ate te Gjirokastrës (qe perfshin Tepelene, Memaliajn, Kelcyren dhe Permetin). Ne tabelen 3 dhe figuren 10 jepet numri i popullsise se te seciles Qarqeve duke perfshire ate te Gjirokastrës dhe te Korces.

Tabela 3.: Popullsia e Qarqeve/Prefektures se Gjirokastrës dhe Korces¹ me 1 Janar 2010

Prefektura	TOTAL			QYTET - URBAN			FSHAT - RURAL		
	Meshkuj-F	Meshkuj	Femra	Meshkuj-F	Meshkuj	Femra	Meshkuj-F	Meshkuj	Femra
Gjirokastrër	102549	51767	50782	43536	19931	23605	59013	31836	27177
Korçë	257576	128797	128779	105770	47369	58401	151806	81428	70378
Total	360125	180564	179561	149306	67300	82006	210819	113264	97555

Figura 10.: Popullsia e secilit/es qark/prefektore dhe ato te Gjirokastrës dhe Korces² perkundrejt gjithë vendit me 1 Janar 2010



3.2.1 Popullsia, zhvillimi ekonomik, historia, monumentet e kultures dhe monumentet natyrore ne zonen e Tepelenes (qe perfshin edhe Memaliajn)

Tepelena është qytet dhe kryeqendër e rrethit me të njëjtin emër në jug të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 817 km². **Tepelena** ka një popullsi rreth 55 mijë banorë (2005) e cila jeton në dy qytetet Tepelene e Memaliaj dhe në fshat, në tetë komuna me 35 mijë banorë. Rrethi përfshin pjesë nga krahinat etnografike të Kurveleshit, Lopesit, Rrezes, Dervenit, Buzit e Krahesit, ku secila shquhet për larminë e traditave, kengeve, valleve e kostumeve. Në këtë rreth, falë pozicionit gjeografik, ka pasur shumë qendra të banuara, si vende banimi të hapura në rajonet Dragoti, Beçishti, Damësi, ashtu dhe vendbanime të fortifikuara me mure masive.

Qyteti Memaliaj është krijuar më 1946 si qendër industriale për prodhimin dhe shfrytëzimin e mineralit qymyrguri, por vëmendja për këtë zonë të pasur kishte lindur në vitet '30 me ekspeditat e ndryshme të specialistve italian. Gjatë periudhës së monizmit Memaliaj ishte një nga qendrat prodhuese më kryesore të vendit. Në vitin 1990 ajo arriti kapacitetin 500.000 ton në vit. Me ndërrimin e sistemeve rëndësia e minierës u ul

¹ Botimi i Institutit të Statistikave (INSTAT) – Mars 2010

² Botimi i Institutit të Statistikave (INSTAT) – Mars 2010

ndjeshëm. Kriza ekonomike dhe veshitë e një ekonomie tregu bën që miniera të shkojë drejt mbylljes. Qyeti i Memaliaj është i vendosur rreth 7 km në veri të Tepelenës.

Ne Tepelene ka ndodhur një shndërrim normal i popullsisë, ku disa banorë janë shpërngulur në qytete të mëdha, dhe banorët e fshatrave janë shpërngulur (me dëshirë) në qytet, kryesisht Memaliaj dhe Tepelene. Po ashtu Tepelena, si gjithë vendi është prekur dhe nga ikja e banorëve në emigrim duke rralluar popullsinë vendase. Por duhet theksuar se Tepelena është pasur me një mori lende të pare me prespektive afatgjate në sektorin e industrisë dhe blegtorisë. Tepelena duhet të dominojë tregun vendas për materiale të para për industrinë e ndërtimit. Tepelena ka një burim uji të papare dhe akoma mbetet i pashfrytëzuar me efikasitet. Tepelena ka një bagazh të madh të turizmit malor.

Ndërtimi Kalasë nga Ali Pashë Tepelena i përkasin fundit të shekullit të XVIII dhe fillimit të shekullit të XIX. Ishte fillimi i i shekullit të XIX kur Pashai i Janinës apo Ali Pashë Tepelena nis të ndërtojë rrënojat e Kalasë paraturke, sarajet e tija, të vizituar në vitin 1809 nga Lord Bajroni. Në më pak se një dekadë Ali Pasha, i rrethon sarajet e tij, me një kala të re, e cila sipas një mbishkrimi në turqisht, të murosur në portalin e hyrjes lindore, përfundon së ndërtuari në vitin 1819. Kjo kala është quajtur kalaja e Ali Pashë Tepelenës, dhe ka një formë shumëkëndëshi të strëgjatur nga veriu. Muri rrethues ndjek bazën e shpatëve të kodrës. Me përjashtim të anës perëndimore ku terreni zbutet për të bërë rafsh me sipërfaqen e Kalasë. Lartësia e mureve të faqeve të dypa deri në 10 metra lartësi dhe pajisja e tyre me bedena, frëngji për armët e zjarrit dhe me vende të posaçme "Hund- hedhje" për derdhjen e lëngjeve të nxehta, shtonin fuqinë mbrojtëse të Kalasë. Të tri kullat mbulojnë krahët e të tri hyrjeve në anën perëndimore, jugore dhe lindore. Nga hyrjet më shumë kujdes i është kushtuar hyrjes lindore e ashtuquajtur "Porta e Vezirit" ku ruhet edhe mbishkrimi që daton ndërtimin e kalasë.

Kalaja e Tepelenës, në mesjetë shquhej për pozitën e saj strategjike, duke vënë në kontroll lëvizjet nëpër rrugët, që vijnë njëra nga Gjiroksatra përgjatë luginës së Drinos dhe tjetra nga Përmeti, gjatë luginës së Vjosës. Periudhës para pushtimit turk, i përkasin gjurmët më të lashta, të një vendbanimi të fotifikuar të kohës, para pushtimit turk. Këto gjurmë përfaqsohen nga trakte të shkëputur të murit rrethues, të cilët qarkojnë shpatin lindor të kodrës. Muratura e këtyre konstruksioneve është ngritur me gurë të rëndomtë të endosur në shtresë të trashë llaçi e gëlqere. Periudha e dytë e ndërtimit ka të bëjë pikërisht me ndërtimin e kështjellës së vogël drejtkëndëshe e përforcuar me dy kulla rrethore në anën perëndimore të saj. Muri rrethues i ruajtur në lartësinë 2-4 metra dhe gjerësi 1.5 metra është ngritur me muraturë ku dallohet qartë dy teknika ndërtimi: teknika "Klausonazh" kryesisht pjesën e poshtme të murit verior, kurse pjesët e tjera muri rrethues është ngritur me muraturë guri të vendosur në shtresë të bollshme llaçi gëleqeror. Ndërsa pranë hyrjes veriore së kështjellës janë zbuluar gjurmë murature me klausonazhtë të një minareje dhe një xhamije, të përfshirë në murin rrethues.

3.2.2 Historia, monumentet e kultures dhe monumentet natyrore ne zonen e Permetit (qe perfshin edhe Kelcyren)

Këlcyra është qytet në Shqipërinë jugore dhe pjesë e rrethit Përmet. Këlcyra shtrihet mes maleve Trebeshinë dhe Nemerckë dhe laget nga lumi Vjosë dhe Dëshnicë. Udhë për në Këlcyrë, pasi shkëputet nga rruga Tepelenë-Gjirokastrë, lë në të djathtë rrënojat e qytetit

të lashtë të Antigonesë, hyn në grykën madhështore e të mirënjohur të Këlcyrës – në kohët e moçme Fauces Antigonenses, çan mes honesh të thepisura dhe mbërrin në pikën më të lartë të pllajës që shtrihet mes Malit të Trebeshinës e Nemërçkës në qytetin e Këlcyrës, i vendosur në të djathtë të Vjosës, aty ku lumi i Dëshnicës së bashku me degët e veta nis bashkërrjedhjen me Vjosën.

Popullsia e Këlcyrës është e përbërë kryesisht nga vendas dhe të ardhur nga fshatrat përreth. Bie ne sy migrimi i madh drejt qëndres së shqiperise dhe kryesisht drejt Tiranës. Tjetër emigrim është në Greqi kryesisht për arsye ekonomike. Në ditët e sotme vërehet një tendencë në rritje e fshatrave përreth për të banuar ne Kelcyre duke e parë ate si pikën ku mund të kenë edhe bujqësi por edhe të jetojnë në një qytet me histori dhe traditë. Këlcyra është dalluar gjithmonë per cilësinë e lartë e frutave dhe rrushit, si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Një tjetër mundësi punësimi për banorët e Këlcyrës jane bizneset e vogla private dhe fabrika e tullave.

Këlcyra njihet edhe për prodhimin bujqësor të fshatrave përreth. Merloti i famshëm i Permetit dhe vetitë e këtij varieteti, e bëjnë verën e prodhuar të Merlotit nga më të degustuarat e më të preferuarat në të gjithë vendin dhe konkurrese dinjitoze me verërat e importit. Ekonomia e Këlcyrës bazohet kryesisht edhe në një numër të madh lokalesh dhe dyqanesh ushqimorë dhe dyqane rrobash. Mbështetës i madh i ekonomise janë te ardhurat nga emigracioni.

Permeti shtrihet ne juglindje te Shqiperise. Rrethi i Permetit perbehet nga dy bashki, e Permetit dhe Kelcyres, dhe nga 7 komuna, Suke, Ballaban, Petran, Carshove, Piskove, Frasher e Deshnice. Perbehet nga 13.000 banore dhe ka 3000 familje. Emigrimi eshte nje nga proceset qe ka prekur Permetin, dhe sot ka rreth 2500 emigrante te cilet ane kryesisht ne Greqi. Permeti eshte nje qytet malor, per vete faktin se rrethohet nga nje varg malor, vargu Trebeshine-Dhembel-Nemercke. Permes qytetit kalon lumi i Vjoses, qe eshte bere pjese e pandashme e emrit te ketij qyteti. Nje karakteristike tjeter e Permetit kane qene lulet, me sakte trendafilat qe gjendeshin kudo neper qytet, sidomos neper lulishte, por gjithashtu neper shtepite me origjine te vjeter permetare, shtepi private te mbajtura aq paster nga zonjat e shtepive, qe vec nikoqirllekut shquhen gjithashtu per mikpritje. Ishin keto lule qe e bene te quhej me perkedheli si "Qyteti i trendafilave". Qyteti i Permetit ka vetem dy shkolla 8-vjecare, Nonda Bulka" e "Meleq Gosnoshti", si dhe gjimnazin,"Sami Frasheri". Dallohet per tolerancen fetare, dhe ne gjirin e tij kane bere strehe besimet ortodokse e myslimane, dhe kohet e fundit edhe disa besime te reja, te huaja si pershembullai Evangjelist.

3.2.3 Historia, monumentet e kultures dhe monumentet natyrore ne zonen e Ersekës

I themeluar në fillim te shekullit te 18-te dhe i shtrirë në rrëzë të malit të Gramozit, qyteti i Ersekës është një qytet i vogël alpin dhe qyteti kryesor i zones se Kolonjës. Si qyteti më i madh në Kolonjë luan një rol të rëndësishëm për të gjitha aktivitetet e rajonit duke përfshirë zonat që lidhen me turizmin, kulturën dhe arsimin.

Popullsia e ketij rajoni është krenare për traditat atdhetare, liridashëse e arsimdashëse. Kolonjaret janë njerëz punëtorë dhe me kulturë. Ata kanë një histori të gjatë për ruajtjen e traditave dhe vlerave të tyre, veçanërisht në fushën e arsimit. Treva e Kolonjës ka qënë

banuar nga fiset ilire të Desaretëve. Nga kjo trevë e kane origjinën e kanë dalë mjaft ideologë të shquar, publicistë të zot, mesues të talentuar e të perkushtuar ndaj shkollës e arsimit shqip, si dhe luftetarë dhe kapedanë trima që kanë bërë emër dhe kanë zënë vend nderi në panteonin e kujtësës sonë kombëtare, si: Fan Noli, Jani Vreto, Shahin Kolonja, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Gjerasim, Gjergj, Parashqevi e Sevasti Qiriazi, Themistokli Gërmenji e Spiro Bellkameni, Sali e Gani Butka, Mersin e Zalo Prodan, Naum Cere e shumë të tjerë që iu perkushtuan me mish e me shpirt çështjes kombëtare shqiptare.

Bazuar në zbulimet arkeologjike, gjurmët më të hershme të banimit në këtë trevë i perkasin epokës së Neolitit (6000-3000 vjet p.er.re) të përfaqësuara nga kultura materiale e zbuluar në vendbanimin e GURIT TË NINËS në Luaras dhe asaj të zbuluar në Kamnik. Epoka e Bakrit (3000-2100 vjet p.er.re), përfaqësohet nga një daltë bakri dhe një enë e importuar nga Dimini i Thesalisë zbuluar në Kamnik.

Epoka e Bronzit (2100-1100 vjet p.er.re) përfaqësohet nga kultura materiale e zbuluar në vendbanimin e GURIT TË NINËS E SHKËMBIT TË MADH në Luaras, e sidomos asaj të zbuluar në vorrezat tumulare të Prodanit, Rehovës, Psarrit, Shtikës, Borovës etj.

Epoka e Hekurit (Mijëvjecari i parë p.er.re) përfaqësohet nëpërmjet një sërë fortifikimesh të hapura në Prodan, Pradellë, Borovë e sidomos kalave Ilire të Hollmit të Qinamit, Gradecit (Bejkovë), Çuka e Borovës, Kala e Gradecit (Vrëpckë), Bejkovës, Boshanjit, Qesarakës etj. Aktualisht asnjë nga këto vende arkeologjike nuk është e hapur për vizitorët. Megjithatë në muzeun historik të qytetit të Ersekës janë ekspozuar e ruhen shumë objekte arkeologjike dhe etnografike. Perroi i Psarrit, që shtrihet pas një udhëtimiti 15 minuta në perëndim të Ersekës, të jep mundësi të hysh në disa pamje grykash përmes mureve të kanionit të lartë të Virkes.

3.2.4 Historia, monumentet e kultures dhe monumentet natyrore ne zonen e Korces (qe perfshin edhe Zemlakun)

Popullsia e qytetit të Korçës numëron rreth 86176 banorë (sipas të dhënave statistikore të vitit 2007). Në një analizë të vitit 2009, vihet re që numri i popullsisë “hyrëse” në qytet është më i madh se ai i popullsisë “dalëse”. Kjo tregon për një tendencë shtimi të qytetit, me gjithë rënien e menjëhershme që pësoi pas vitit 1990 prej migrimit brenda vendit dhe emigrimit jashtë shtetit të një numri të konsiderueshëm banorësh të qytetit. Përveç kombësisë shqiptare që perben 95% të popullsisë, në qytet dhe rreth tij jetojnë edhe disa fshatra me vllahë dhe rumune.

Korça karakterizohet nga një klimë pjesërisht mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 10.6°C. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 104 milimetra ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 720 milimetra. Karakterizohet nga disa erëra lokale si Voskopojarja, erë jug-perëndimore, Morava, Devollka etj. Në stinën e dimrit përgatituni të visheni trashë pasi dimri në Korçë është i ftohtë me erë dhe me rreshje bore që e bën qytetin ideal për sporte dimërore.

Pozita gjeografike: Qyteti i Korçës shtrihet ne pjesën juglindore te Shqipërisë dhe është qëndra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300 km². Korça ka një pozite te favorshme gjeografike pasi ndodhet ne rrugët tregtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë (35km).

Për të ndriçuar plotësisht lashtësinë dhe zanafillën e Korçës dëshmitë arkeologjike dhe dokumentet historike bazohen tek gjetjet e rastit, të zbuluara në kodrat Partizani dhe në dalje të qytetit në anën juglindore, që si kohë i perkasin antikitetit të vonë dhe dëshmojnë për ekzistencën e një qendre të banuar. Njoftimi më i hershëm i shkruar mbi ekzistencën e qytetit të Korçës vjen nga kronika mbi historinë dhe gjenealogjinë e familjes së madhe feudale shqiptare të Muzakajve, shkruar nga Gjon Muzaka me 1510. Shkruesi kur numëron zotërimet e Andre Muzakës I, i cili arriti titullin Sebastokrator më 1280-1281 dhe u bë zot i një krahine të gjerë që shtrihej në të gjithë Shqipërinë Qendrore deri në lumin Vjosë në jug, me kryeqendër Beratit dhe që përfshinte ndërmjet të tjerave Myzeqenë, Tomoricën, Oparin, Devollin, Kosturin, përmend dhe Korçën, të cilën e cilëson qytet.

Ekonomia e Korçës mbështet kryesisht në industrinë lehtë, ndërtim, tregti dhe shërbime, sektorë të cilët janë dhe punësuesit më të mëdhenj vendorë. Turizmi ka filluar të konsolidohet, kryesisht duke shfrytëzuar ambientet dhe objektet kulturore, si dhe bukuritë natyrore te zonave përreth. Rehabilitimi i rrugëve që lidhin pikat e afërta kufitare me Greqinë dhe Maqedoninë ka lehtësuar lidhjen e Korçës me hapësirat ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare përgjatë Korridorit VIII. Biznesi i Korçës ka një mundësi të vërtetë t'u bërë aktiv në tregun kombëtar dhe atë ndër-rajonat ballkanik. Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me vendet e tjera Ballkanit do t'i përmirësojnë klimën ekonomike pasi bizneset po përgatiten të përmbushin nevojat që të konkurrojnë me vendet fqinje.

Ndërtimi: Në Korçë operojnë aktualisht 34 kompani ndërtimi disa prej të cilave kanë ngritur struktura të mirëorganizuarra e që po zhvillojnë marrëdhënie biznesi me kompanitë ndërkombëtare. Kjo industri është mjaft dinamike dhe ka një potencial të madh për rritje të mëtejshme duke marrë parasysh edhe nevojën në rritje për ambiente biznesi dhe strehimi, lëvizjet demografike nga fshati në qytet, emigrantët që përbëjnë një treg potencial për këtë sektor si dhe ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës publike.

Konfeksionet: Ky sektor përbën rreth 33% të ekonomisë së rajonit te Korces. Tradicionalisht industria është dominuar nga trikotazhi dhe prodhimi i qilimave dhe tani ka numrin më të madh të ndërmarrjeve dhe të punësuarve (midis 4500-5000, kryesisht gra). Ndërmarrjet më të shumta janë me sipërmarrje të përbashkëta me biznese greke. Aktualisht lënda e parë për prodhimin e artikujve kryesisht importohet. Në tregun vendor ka një potencial shumë të madh për zgjerimin e këtij sektori prodhimi.

Agrobiznesi: Korça është aktualisht epiqendër e industrisë përpunuese të prodhimeve bujqësore që ofrohen nga zona përreth qytetit dhe ka aktualisht një nga grupet më të mëdha të bizneseve të përpunimit ushqimor në vend për prodhimin e miellit, sheqerit, mishit, sallameve, prodhimeve të bulmetit dhe pijeve, si edhe përpunimit të kërmijve.

Perspektivat e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla të agrobiznesit janë të mëdha si rrjedhojë e madhësisë dhe rëndësisë së sektorit bujqësor në Rrethin e Korçës. Korça zë vendin e dytë në vend për sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore, që e bën kështu aktualisht bujqësinë sektorin më të rëndësishëm të ekonomisë së vet, e cila zë 32 për qind të ardhurave të përgjithshme. Pllaja mbi të cilën qëndron qyteti është shumë pjellore dhe është një nga zonat kryesore në Shqipëri për rritjen e grurit. Një avantazh i madh i zonës është përqindja e lartë e produkte të rritura në mënyrë organike.

Turizmi: Potencialet për zhvillimin e turizmit në Korçë dhe rrethinat e saj janë shumë të mëdha për shkak të pasurive historike, kulturore dhe natyrore. Mijëvjeçarët e historisë dhe kulturës kanë krijuar një vend tërheqës dhe interesant për t'u vizituar. Korça përmendet si një kështjellë që në vitin 1280 dhe në vitin 1431 ajo përmendet në dokumente si një kala e banuar. Mbas vitit 1484 qyteti i Korçës filloi të zgjerohej dhe zhvillohej me tiparet e një qendre urbane dhe qendër e zonës. Në perëndim të Korçës ndodhet Voskopoja, një vend tërheqës për turistët, sepse është streha e shumë kishave dhe manastireve bizantine. Në fshatin e Mborjes (3 km larg Korçës) ndodhet një nga kishat më të vjetra në vend që daton vitin 1390, por që është ngritur mbi rrënojat e një kisha akoma më të vjetër që daton në shekullin IV. Dy fshatra të tjerë të afërt, Kamenica dhe Barçi strehojnë gjetje të ndryshme arkeologjike që përfshijnë edhe tumuli (kodërvarret) që datojnë në Epokën e Bronzit.

Së fundmi Korça po shihet si një destinacion turistik gjatë fundjavave. Organizimi i aktiviteteve të shumta artistiko-kulturore, festat e larmishme që synojnë dhe rigjallërimin e traditave të vjetra korçare, panairët, lokalet me muzikë live etj po e përforcojnë akoma më tepër idenë se në Korçë mund të kalosh një fundjavë të këndshme. Për më tepër sasia dhe cilësia e ambienteve dhe kapaciteteve akomoduese në Korçë është përmirësuar dukshëm vitet e fundit. .

3.3 Përdorimi i tokës

Pjesa Juglindore e Shqipërisë ka qene dhe eshte nje zone kompakte dhe e strukturuar ne menyre te tille per plotsimin ne maksimum te nevojave te veta me te gjitha produktet bujqesore dhe blektorale. Kjo i dedikohet sidomos fushes se Korces e cila eshte edhe fusha e dyte me e madhe e vendit tone. Zonat urbane kane qene te strukturuar dhe rezervuara per agrikulture dhe prodhimin e drithrave, perimeve dhe zona kondrinore per prodhimin molleve, dardheve, kumbullave dhe vreshtarise qe jane prodhimi baze i kesaj zone per nevojat e veta dhe per tu tregetuar ne pjeset e tjera te vendit. Territori shqiptar eshte kryesisht bujqesor (75 % - 2008), ndersa 47% e popullsisë jeton ne zonat urbane (figura 10-11) dhe ne zonat jo urbane popullsia eshte shume e vogel. Zona ku do te zhvillohet projekti eshte kodrinore-malore, e dominuar persa lidhet me bujqesine dhe pemtarine nga fushat me grure, miser, patate, plantacionet me molle, dardha, kumbulla dhe vreshtari brezaret dhe peme te tjera, pyjet, shkurre dhe me aktivitetet te gjere blektoral sidomos ne popullsinë fshatare te kesaj zone³.

³ www.grida.no/enrin/htmls/albania/albania.htm




Figura 11.: Perdorimi i tokes ne Shqiperi




Figure 12: Perdorimi i tokes ne Shqiperi⁴.




Figure 13: Perdorimi i tokes ne prefekturen e Gjirokastes dhe te Korces (zona ku kalon linja)⁵.

⁴ Instituti i Tokave

⁵ Instituti i Tokave

Perdorimi i tokes mesatarisht per zonen ne te cilen kalon korridori i linjes perbehet nga: 1) tokat livadhore malore' 2) tokat e murrme pyjore; 3) tokat e hirta kafe dhe 4) tokat e tokat mocalishte (fusha e Korces ish-keneta e Maliqit).

1) tokat livadhore malore

Si rezultat nga vrojtimi ne vend kjo zone eshte e mbuluar me nje strese te holle humusi deri ne 40 cm jep mundesi per pasjen e kullotave te rendesishme per blektorine e kesaj zone. Permbajtja e humusit ne tokat livadhore malore ne nje pjese te konsiderueshme te korridorit sidomos ne disa zonat te Memalajt, Kelcyres, Permetit, Ersekës ne te cilin do te kaloje korridori i linjes 110 kV eshte krijuar si rezultat i nje vere te gjate qe e karakterizon kete zone dhe me pak reshje. Ne keto zona shtresa humusore ka ngjyre te erret kafe deri ne te zeze, eshte e shkrifet e ajrosur dhe me strukture kokrrizore te shprehur mire. Eshte shume e rendesishme te theksohet qe per te permiresuar pjellorine e tyre duhet ne radhe te pare te mbrohen nga gerruerjet dhe per kete duhet pasur kujdes gjate ndertimit te bazamenteve te shtyllave te linjes. Keto toka sic edhe u shprehem me siper shfrytëzohen per kullota gjate gjithë periudhes meqenese ne zonen ku ndertohet linja.

2) tokat e murrme pyjore;

Keto toka cfaqen ne nje pjese te vogel te korridorit te linjes sidomos ne nje pjese te Permetit dhe te Ersekës dhe jane formuar mbi eluvin e sedimenteve, magmetikeve e metamorfikeve. Keto toka ne shumicen e rasteve kane pjellori te ulet dhe ne shumicen e rasteve ose jane me pyje te vogla te prera ose jane braktisur.

3) tokat e hirta kafe,

Keto lloj tokash jane karakteristika ne shumicen segmenteve te Kelcyres.

4) tokat tokat mocalishte (fusha e Korces ish-keneta e Maliqit)

Ish-Zona Mocalore e Maliqit qe ne vitin 1948 eshte kthyer ne nje nga tokat me pjellore te Shqiperise. Teprica e lageshtires i ka dhene procesit te formimit te tokes me karakter specifik. Per kete pasoje ne keto rrethana zhvillohet nje bimesi e pasur higrofile, qe jep nje mase te madhe organike qe depozitohet. Nepermjet sistemimeve, kullimeve qe behen kohe pas kohe keto toka jane permiresuar dhe tani nga to po merren rendimente me te larta se mestarja e e vendit.

3.4 Fauna

Fauna shqiptare, megjithese ben pjese ne rajonin e Mesdheut, ka fizionomine e saj te vecante. Ne Shqiperi gjenden:760 lloje rruazoresh, nga te cilet 85 lloje u perkasin gjitareve, qe perbejne 42% te gjithë gjitareve te Evropes. Prej tyre 79 jetojne ne toke, ndersa 6 ne mjediset ujore. E pasur eshte bota e shpendeve, e cila numeron 340 lloje. Sipas mjedisëve ku jeton bota shtazore, ndahet ne faunen tokesore e ujore.

Pozita gjeografike e vendit ne kryqezimin e rrugeve te migracionit te shpendeve, lakuriqëve te nates dhe insekteve; larmia e mjedisëve gjeografike: detare dhe bregdetare, laguna dhe ligatina, liqene,lumenj, shkurre mesdhetare dhe pyje gjethegjere, halore e te perzire, livadhe e kullota alpine etj; relieve i copetuar me plot skuta te fshehta, kane krijuar kushte per larmine e theksuar te botes shtazore, ne te cilen mbizoterojne elementet euroaziatike, mesdhetare dhe ballkanike.

Nder 67 speciet e peshqëve te pranishme ne Shqiperi, 43 specie jane endogjene ne veri te zones mesdhetare dhe 13 kane hyre dhe jane shumuar. Edhe pese specie te tjera kane hyre, por nuk jane riprodhuar. Ne tabelen 4 jepen te dhena lidhur me faunen ne Shqiperi, ne zonen e projektit (korridorit te linjes) dhe behet krahasimi me vlerat e europiane.

Tabela 4.: Te dhena lidhur me faunen ne Shqiperi dhe behet krahasimi me vlerat e Evropes⁶

⁶ [www//korca.com](http://www.korca.com); www.gjirokastra.com

Grupi Kafsheve	Numri total i specieve			Numri i specieve endemike			Numri i specieve te rrezikuara		
	Shqiperia	Zona linjes	Europa	Shqiperia	Zona linjes	Europa	Shqiperia		Europa
Gjitaret	69	60	219	4	2	59	5	2	35
Zogjte riprodhues	193	150					6	3	
Zvarranikët	34	31	151	4	3	73	1	0	27
Peshqit	109	23	X	3	X	X	33	X	X

Zonat me sensible nga ana ambientale te zones ne te cilen kalon korridori i linjes, persa i perket funksionit habitat jane lumenjte, malet dhe pyjet. Por vlen te theksohet qe ne fillim qe korridori i linjes eshte zgjedhur ne menyre te tille qe te shmangi ne maksimum ndikimin ne to.

3.5 Flora

Terreni i tokes ne zonen e korridorit te linjes eshte nje sistem dinamik i hapur, i cili shkemben energji dhe materie me ekosisteme te tjere natyrore; ne zonen e studimit, morfologjia dhe klima kane patur nje rol kryesor ne evolucionin e territorit. Bimesia natyrore ne kete fushegropë ruhet vetem ne areale te vogla (ne afersi te Sheqerasit) dhe perbehet nga disa drure te larte higrofile (plepi, shelgu, vidhi etj) dhe bimesi barishtore higrofile.

Ne zonen e dushqeve gjejme derrin e eger, megjithate jo shume te perhapur. Per kete arsye gjuetia e tij eshte e kufizuar. Gjejme edhe kaprollin qe eshte nje kafshe e rrallë, gjuetia e te cilit eshte gjithahtu e ndaluar. Lepuri dhe dhelpra jane te perhapur ne gjithe zonen e dushqeve dhe vecanerisht prane zonave te banuara. Ne zonen e pishave jetojne ujku, ketri, dhelpra dhe lepuri. Nga zogjte, me te perhapurit jane gjeli dhe pula e eger, bilbili, qukapiku, etj. Kafshet i gjejme ne gjithe shtrirjen e bimesise, qe nga shkurret mesdhetare deri ne kullotat alpine. Dhelpra eshte e perhapur prane qendrave te banuara te zonave kodrinore dhe gjuhet mbi te gjitha per lekuren e saj.

3.6 Bimësia Reale dhe Flora në zonën e projektit

Bimesia ne zonat e Permetit, Ersekës, Korces (perfshire dhe Zemlakun) eshte e pasur per shkak te formave te ndryshme te relievit, te klimes dhe te mikroklimes. Gama e gjere e bimesise duket edhe nga fakti qe nga 208 lloje druresh ne te gjithe vendin, me teper se 141 i gjejme ne kete zone. Pyjet zene reth 29 % te siperfaqes se pergjithshme te rrethit. Hidrografia e fushegropes eshte e pasur, sidomos me ujera nentokesore te tipit artezian. Pjesen veriore te fushegropes se Korces e pershkron lumi i Devollit, ndersa ate jugore i Dunavecit. Takat i takojne brezit te tokave te kafenjta, por ndryshojne gjate shtrirjes se saj. Ne te dallohen disa nentipa: tokat e kafenjta livadhore mbizoteruese, qe shtrihen kryesisht ne brendesi dhe dallohen per profil te trashe, reaksion neutral e pjellori te mire; tokat livadhore aluvionale ne te dy anet e lumit te Devollit dhe te Dunavecit, qe jane te shtresezuara dhe me perberje mekanike subargjilore dhe pjellori te mire; tokat livadhore torfike me pjellori te larte ne veri.

3.7 Vegjetacioni real dhe potencial

Pyjet dhe kullotat perbejne nje trashegimi me vlera jo vetem per Shqiperine, por edhe per rajonin e me gjere. Ajo duhet te mbrohet dhe qeveriset ne menyre te tille qe te mundesoje nje zhvillim me te madh ekonomik ne te ardhmen, duke kontribuar ne uljen e nivelit te varferise, pa prishur ekuilibret biologjike natyrore.

Ne te kaluaren perfshire dhe vitet e tranzicionit, sidomos pyjet jane vleresuar per rendesine ekonomike, duke nenvleftesuar aspektin shumefunksional te tyre. Veçse shfrytëzimi i tyre nuk çon vetem ne fitime por edhe ne humbje (kur nuk shfrytëzohet drejt) si rezultat i humbjes se mundesive per zhvillim ne te ardhmen, rrjedhoje e degradimit e desertifikimit te mjedisit pyjor e kullosor.

Menaxhimi i qendrueshem i resurseve natyrore te pyjeve dhe kullotave nenkupton mireqeverisjen dhe perdorimin e resurseve ne nje menyre dhe me nje ritem qe ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarine, aftesine ripërteritese, vitalitetin dhe potencialin e tyre per te permbushur, per sot dhe te ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale ne nivel lokal, kombetar dhe global, pa shkaktuar deme ne ekosisteme te tjera. Koncepti i menaxhimit te qendrueshem te burimeve natyrore ne pyje dhe kullota eshte ne thelb i njejte me konceptin e pergjithesem te te qenurit i qendrueshem. Zhvillimi i qendrueshem eshte ai zhvillim, i cili:

- integron procesin e planifikimit te vlerat ekonomike, mjedisore dhe shoqerore;
- shperndan ne menyre te njejte dhe te barabarte perfitimet qe rrjedhin prej ketij zhvillimi sipas shtresave social-ekonomike dhe gjinise;
- siguron te pakten te njejtat mundesi per nje zhvillim te vazhdueshem edhe per brezat e ardheshem.

Termi "te qenurit i qendrueshem" eshte produkt i iniciativave nderkombetare qe lidhen me Samitin e Tokes (Rio, Qershor1992) dhe Zhvillimin e Qendrueshem ne vijim te tij. Ky term eshte percaktuar dhe shtjelluar me tej nga nje varg procesesh rajonale dhe nderkombetare ne te cilat jane perpunuar kriteret dhe indikatoret te nje zhvillimi dhe menaxhimi te qendrueshem.

Siç del nga studimet e kryera prane Institutit te Kerkimeve Pyjore dhe Kullotave te Fakultetit te Shkencave Pyjore te Universitetit Bujqesor ne Tirane, rajoni ku kalon linja 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak, eshte i pasur jo vetem me shumellojshmeri te specifikuar por edhe me shumellojshmeri biologjike. Pyjet dhe shkurrja mesdhetare jane te perhapura. Pyjet mesdhetare pergjate korridorit te linjes, ne fillimet e periudhes Neolitike, perbejne nje ambient natyral te trazuar prej perdorimeve te shumta. Ky vegjetacion, i tipit xerofila me nje nivel te ulet te mbuleses vegjetale, eshte e pasur me specie ornamentale te cilat lulezojne pas shirave vjeshtore. Nga analiza florale rezulton se grupi kryesor eshte *Brachypodium ramosi*, me mikrogrupe te ndryshem te cilet perfaqesojne vijimet e metejshme. Kushtet ambientale te veshtira dhe mbi te gjitha mungesa e lageshtires kane shkaktuar nje zhvillim me te vogel te bimeve dhe nje reduktim te produktivitetit. Fleksibiliteti ekologjik, aftesia e madhe e akumulimit te substancave ushqyese, prodhimi i farave te pagreneshme per kafshet i lejojne ketyre specieve te zhvillohen ne terrene te varfera, te degraduara dhe shkembore. Ky mikro grupim perfshin seri te ndryshme.

Rrethi i Tepelenës është i pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve, që shtrihet deri në lartësi 600-800 metra, brezi i dushkut 800-1200 metra, pyjet fletëgjere, halore e të perzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi mbi 1000m. Zona e Memaliajt dhe Permetit radhiten në vendet me llojshmeri bimore me të madhe, që lidhet me ndryshimet e klimes, të tokave, të relievit etj. Në rajonet jug-lindore dhe bregdetare mbizoterojnë llojet mesdhetare të bimesisë (mareja, shqopa, ilqja etj.), kurse në brendësi të tyre, bimët e Evropës Lindore dhe Qendrore (dushku, ahu, bredhi, pisha e zeze etj.). Gjithashtu janë të shumta bimët endemike, pra bimët që rriten vetëm në trevat shqiptare. Për shkak të mbizotërimit të relievit kryesisht kodrinoro-malor, që kushtëzon ndryshime të dukshme të klimes dhe të faktoreve të tjera, bimesia është e shkallezuar në drejtim vertikal në katër breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare; brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave alpine. Pjesën e poshtme të tij e zënë shkurret me gjelberim të perhershëm (makiet) si: mareja, shqopa, xina, gjineshtra, dafina etj. Në bashkë me këto shkurre rriten edhe disa druro të lartë, si: selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger etj. që, në disa raste, formojnë pyje të vogla. Pjesën e sipërme të brezit të shkurreve mesdhetare e zënë shkurret që i rrezojnë gjethet gjatë stinës së dimrit, si: shkoza e bardhe dhe e zeze etj.

Brezi i dushqeve shtrihet mbi brezin e shkurreve mesdhetare deri në rreth 1000 m lartësi. Ka përhapje më të madhe se brezat e tjera bimore, sidomos në brendësi të trevave shqiptare. Bimët me karakteristika të këtij brezi bimor janë: disa lloje dushqesh, bliri, frashri, malleza, panja, geshtenja etj.

Brezi i ahut dhe i haloreve shtrihet mbi brezin e dushqeve deri në rreth 1600 - 1800 m lartësi. Ahishtet, duke kerkuar më shumë lageshti, janë më të përhapura në malet e trevave veriore dhe lindore shqiptare dhe në shpatet përballë veriut dhe lindjes. Në shumë zona ahishtet janë të perziera me haloret (bimë që e kanë gjethen në formën e gjilperes), si: pisha, bredhi etj. Në këto brez ndodhen pyjet më të dendura, që përbejnë fondin kryesor të lëndës së drurit.

Brezi i kullotave alpine shtrihet mbi brezin e ahut dhe të haloreve, ku, për shkak të temperaturave shumë të ulëta, rritet vetëm bimesia banishtore dhe shumë rralle shkurre të ulëta. Zhvillimin më të mirë bimesia banishtore e ka në rajonet malore të trevave shqiptare veriore dhe lindore. Pyjet më bimesi dhe bote shtazore më interesante e më mirë të ruajtura janë shpallur parqe kombetare, në të cilat është e ndaluar me ligj dhe prerje dhe nderhyrje e njeriut. Në sektore të caktuar të tyre mund të bëhen vetëm vizita turistike për të shijuar natyrën e pastër.

3.8 Vegjetacioni i shkurreve në zone

Ky lloj vegjetacioni është i pranishëm në një pjesë të korridorit të linjes, dhe është i përfaqësuar nga grupet *Agropyretum mediterraneum* e *Sporobolium*. Rritja në lartësi e dunave shoqërohet me një ndryshim progresiv të fizionomisë së vegjetacionit të përmendur.

3.9 Zonat e Mbrojtura

Sipas Komisionit Botëror të Zonave të Mbrojtura, Shqipëria ka një numër të zonave kombëtare të mbrojtura, si dhe disa zona të tjera sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe programeve të paraqitura si në tabelën 5. Ligji shqiptar mbi zonat e mbrojtura Nr 8906 rregullon mbrojtjen e gjashtë kategorive të zonave të mbrojtura. Kategorizimin e zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes është i bazuar në kriteret e Komisionit Botëror për Zonat e Mbrojtura.

Emertimet kombetare	Nr Total	Niveli i kerkuar i mbrojtjes
Rezervat natyrore	26	Kategoria 1
Parku kombetar	15	Kategoria 2
Monumentet natyror	745	Kategoria 3
Monumentet natyror	4	Kategoria 4
Peisazhet e mbrojtura	5	Kategoria 5
Rezervat e burimeve natyrore	4	Kategoria 6
Zone e mbrojtur ne menyre strikte	4	Kategoria 1
Konventat dhe programet nderkombetare		
Lagunat me rendesi nderkombetare (Ramsar)	3	
Konventa e trashgimise boterore	2	
Konventa Barcelones	2	

Tabela 5: Zonat e Mbrojtura ne Shqiperi

Mbrojtja e biodiversitetit tashme ne vend ka edhe mbeshtje ligjore: ligji nr. 8906 date 06.06.2002 mbi zonat e mbrojtura. Ne kete ligj u adaptua sistemi i vendosur nga IUCN-ja (Unioni Nderkombetar i Mbrojtjes se Natyres), ne te cilin jepen gjashte kategori te zonave te mbrojtura. Me pjesemarrjen e specialisteve te ndryshem, te drejtuar nga Instituti i Studimeve biologjike dhe Muzeu i shkencave te natyres i UT, u krye nje studim i detajuar per gjendjen e biodiversitetit, strategjite e mbrojtjes se tij dhe u propozuan kategorite e zonave te mbrojtura. Parqet kombetare përbëjnë një sipërfaqe prej 10.000 ha në Shqipëri. Pavarësisht nga statusi i tyre të mbrojtjes monitorimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse brenda zonave të mbrojtura të Shqipërisë është i pamjaftueshëm. Figura 14 tregon vendndodhjen e zonave të mbrojtura në zonën e projektit.




Figure 14: Zonat e mbrojtura ne pjesen e projektit te Jugut dhe Juglindjes.

Në fund të 2013, Zonat e Mbrojtura do të mbulojnë rreth 17 % të territorit të vendit, është synimi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave për periudhën e 4 viteve të ardhshme. Ndër to, sipas MMPAU-së, do të spikasë krijimi i Parkut të Alpeve dhe i disa Zonave të Mbrojtura Nënujore. Ndërkohë, përmirësimi i administrimit të Zonave të Mbrojtura, nëpërmjet krijimit të Administratës të Zonave të Mbrojtura dhe përmirësimit të kapaciteteve administrative, është një tjetër drejtim i punës së këtij dikasteri në 4 vjeçarim të ardhshëm. Sipas të dhënave nga MMPAU, zonat e mbrojtura në vend zënë një sipërfaqe prej 12.6% të sipërfaqes totale të vendit, duke njohur dyfishim nga viti 2005 (5.8%), duke arritur në vitin 2009 në 12.6% të sipërfaqes së vendit. Sic tregohet në figurën e mesiperme në zonën Permet-Erseke-Korce janë 12 zona të mbrojtura të kater kategorive të ndryshme me të dhëna në mënyrë me të detajuar në tabelën e mëposhtme.

ZONAT E MBROJTURA NE QARQET E KORCES DHE TE GJIROKASTRES						
Nr	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi Nr.ZM	Sipërfaqja, Ha
REZERVAT STRIKT NATYROR/REZERVAT SHKENCOR						
1	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1,380.0
2	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	27,750.0
3	II	Gjirokastrë Korce	Përmet, Kolonje	Bredhi i Hotovës - Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	Total 34,361.1 Permet 33,165.3 Kolonje 1,195.8
PARK KOMBETAR						
4	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1,740.0
5	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1,500.0
MONUMENT NATYRE						
6	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB Nr 1, date 27.7.1977	1 250.0
7	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Urdhër MB 1970	1 253.0
8	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj- Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1 430.0
REZERVAT NATYROR I MENAXHUAR/PARK NATYROR						
9	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1 510.0
10	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	27,323.0
PEIZAZH I MBROJTUR						
11	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	5,400.0
12	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	2,200.0

Nje nga Parqet kombetare me te rendesishme eshte Bredhi i Hotovës, i cili është park kombëtar, ndodhet në jug të Shqipërisë pak kilometra nga qyteti i Përmetit, dhe mund të cilësohet si mushkria natyrore e Shqipërisë Jugore. Me një shtirje prej 1200 hektarësh dhe një masiv të mrekullueshëm të përbërë kryesisht nga Bredhi Maqedonas, ky park kombëtar është një nga perlat turistike të Shqipërisë, që ofron surpriza të këndëshme në çdo stinë të vitit, si në dimër, ku ai është i mbuluar nga dëborat por dhe në verë ku mund të shijosh freskinëe tij. Ai ndodhet në zonën e Frashërit, rreth 35 kilometra nga qyteti i Përmetit, në verilindje të tij.

Pamja madhështore e parkut të shfaqet nga hyrja e luginës së Lumicës e deri afër majës së malit të Kokojkës. Në Bredhin e Hotovës mund të shkosh me çdo lloj mjeti pavarësisht se rruga nga kthesa e Piskovës dhe në brendësi të pyllit ka një sërë burimesh natyrore më ujë të ftohtë. Bredhi i Hotovës konsiderohet një nga reliket bimore mesdhetare më të rëndësishëm në vend dhe është një nga parqet më të mëdhenj në Ballkan me Bredh Maqedonas. Aty përveç bredhit gjen disa lloje panjash, shkozë e zezë, ilqe, dëllinjë e kuqe dhe e zezë, mjedëretj.

Në lartësinë 800-1000 metra takohen livadhe e vende të sheshta të rrethuar nga drurë shekullore të përmasave të mëdha. Parku formon një kurorë të gjelbërt gjigande me kontraste të dukshme nga njëra-tjetra. Bota shtazore është e pasur. Nga gjeturit takohen ariu i murrmë, ujku, dhelpra, kunadhja, derri i egër, lepuri i egër, ketri etj. Por krenaria e këtij parku dhe përfaqësuesi tipik i tij është kaprolli, të cilin mund ta shohësh në livadhe dhe lëndina në thellësi të pyllit.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr 102, datë 15 janar të vitit 1996 masivi i "Bredhit të Hotovës", me sipërfaqe 1200 hektarë është shpallur Park Kombëtar dhe administrohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor të rrethit të Përmetit. Bredhi i Hotovës është masivi pyjor më i mbrojtur në Shqipëri duke i rezistuar deri tani çdo dëmtimi apo shpyllëzimi nga njeriu. Në vënde të caktuara mund të ndeshësh dhe dhinë e egër. Gjuetia e kafshëve dhe shpendëve të egra që lejohet me ligj fillon më 15 gusht kryesisht për turtullin. Ndërsa në fillim të shtatorit nis gjuetia për lepujt, derrin e egër, thëllëzën, etj. Sezoni i gjuetisë zgjat deri në fillim të pranverës. Ne vijim janë dhene disa foto nga ky park kombetar.



Pamje nga Parku Kombetar "Bredhi i Hotovës - Dangelli"

edhe do të përkruhet në këto VNM, projektuesit kanë pasur parasysh mos kalimin e korridorit në këto zona për të bërë e mundur mbrojtjen e tyre. **Një konkluzion i rëndësishëm duhet të theksohet që korridori i të gjithë linjes është shumë larg të zonave të mbrojtura të sipërpermendura dhe për këto varianti i tretë merr një rëndësi më të madhe.**

3.10 Gjeologjia dhe strukturat gjeologjike

Zona e projektit ndodhet në zonën Jug-Lindore të Shqipërisë (figurat 13 & 14). Shqipëria është pjesë e rajonit alpin të rrudhur, me të cilën ndërtime të ndryshme gjeologjike (sedimentet, magmatike dhe metamorfike formacionet) dhe një diversitet të lartë e mineraleve nëntokësore (mbi 40 llojet e mineraleve p.sh. kromit dhe të bakrit) janë të lidhura. Zona ku do të kalojë linja është gjithashtu i pasur me depozita të qymyrit, boksideve, etj. Vetitë fiziko – mekanike të depozitimeve morenore, që përbëjnë dhe bazamentin e shumicës së kullave të linjes së tensionit të lartë 110 kV janë:

- Pësha vëllimore në gjendje natyrale $\gamma = 1.75 - 2.5 \text{ gr/cm}^3$

- Moduli i deformimit të përgjithshëm	$E_d = 360 - 420 \text{ kg/cm}^2$
- Këndi i fërkimit të brendshëm	$\Phi = 380$
- Kohezioni	$C = 0.15 - 0.25 \text{ kg/cm}^2$
- Poroziteti	$\eta = 18 - 30\%$
- Ngarkesa e lejuar	$\tau = 3.8 - 4.5 \text{ kg/cm}^2$
- Koeficienti i fërkimit beton-shkëmb	$f = 0.58$

Granulometria e përbërësve të depozitimeve morenore të bazamenteve janë ne shumicën dërmuese te rasteve:

- Fraksioni poplor e bllokor ($> 60 \text{ m/m}$)	36%
- Fraksioni copëzor ($60 - 2 \text{ m/m}$)	34%
- Fraksioni rërë ($2 - 0.06 \text{ m/m}$)	15%
- Fraksioni pluhuror ($< 0.06 \text{ m/m}$)	15%

Përbërja litologjike e depozitimeve morenore është pothuajse tërësisht karbonatike. Si blloqet e copat, ashtu dhe materiali çimentues janë karbonatik. Rrallë takohen copa të flishit. Karakteristikë është që copat janë qoshelie, ku mungon rrumbullakimi i tyre, gjë që dëshmon se rruga e tyre ka qenë e shkurtër. Nuk takohen blloqe apo copa strallesh, gjë që dëshmon se edhe ajo lëndë e ngurtë që bashkë me ujin e perrejeve, nuk do përmbajë grimca stallore. Formacionet rrënjësore përfaqësohen nga flishi argjilo – ranor i Oligocenit të Poshtëm, që ndërton krahun jugperëndimor të strukturës sinklinale të Zagorisë. Formacioni flishor bie në drejtim të Verilindjes, me kënd rënie $350 - 500$. Mbi formacionin flishor në mjaft vende takohen depozitime morenore, të shoqëruara me deluvione të shpateve dhe proluvione të përrenjeve.

Fenomene të zvarritjes së formacioneve tejkalohe me masa të thjeshta inxhinierike. Nuk evidentohen sektorë të rrëshqitur apo me rrezikshmëri rrëshqitje përgjatë aksit të korridorit te linjes. Formacioni flishor ka shtrirje Veriperëndim – Juglindje dhe rënie verilindore, me kënde të rënies 320 . Flishi është ranoro – argjilor ritmik, me ndërshtresa të ranorëve $4 - 6 \text{ cm}$ dhe argjilave alevrolitore $3 - 8 \text{ cm}$. Nuk evidentohen probleme gjeologo – inxhinierike në vendin e nënstacionit te Memaliajt dhe vetitë fiziko – mekanike të flishit në mënyrë të mesatarizuar janë:

- Pesha vëllimore në gjendje natyrale	$\gamma = 2.5 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} = 320 \text{ kg/cm}^3$
- Moduli i deformimit të përgjithshëm	$E_d = 660 \text{ kg/cm}^2$
- Këndi i fërkimit të brendshëm	$\Phi = 26 - 350$
- Fortësia	$F = 5.5 - 6.5$
- Kohezioni	$C = 1.2 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar	$\tau = 5.5 \text{ kg/cm}^2$
- Këndi i skarpatave provizore	$2,2 - 1.5$
- Këndi i skarpatave definitive	$1,2 - 1.5$

Formacionet mbi të cilat shtrihet korridori i linjes ne seksionin e fundit eshte me depozitime deluviale qe takohet perfaqesohet nga:

- a) Formacionet shkembore ofiolitiko – Jurasike $\sigma_2 - 3$
- b) Formacionet gjysem shkembore paleogjenike te oligocenit te siperm

a. Formacionet shkembore Ofiolitiko – Jurasike

Perfaqesohen nga ultrabazike, kryesisht nga Harcburgitet te serpentizuar e te fresket.

- Harcburgitet

Harcburgitet ne sipërfaqe kane nje ngjyre te verdhe me njolla e nuance ngjyre hiri, ndersa ne brendesi kane ngjyre te gjelber te erret. Mineralet perberes jane olivina e pirokseni rombik dhe

mineralet e grupit te serpentines. Si mineral dytesor takohen magnetiti, talku, amfiboli, etj. Olivina ne Harchburgitrt formon kokrriza izometrike e te crregullta, paraqitet mjaft e serpentizuar. Pirokseni rombik formon kokrriza ne trajte pllakash ose shtyllash te shkurtra gati pa ngjyre shpesh here te kataklizuara. Ne zonen e carjeve tektonike ultrabaziket jane kryesisht me serpentimim. Formacionet gjysemshkembore Paleogjenike te Oligocenit te Siper. Perfaqesohet nga Flish Argjilo – Ranore me shtresa gelqeroresh, ranore masive si dhe argjila e qymyre.

- Formacioni mbulesor

Formacioni mbulesor ne kete zone perfaqesohet nga eluvionet, deluvionet e proluvionet.

- Eluvionet e Deluvionet

Vendosen mbi formacionet shkembore ultrabazike dhe gjysem shkembore flishore. Kane trashesi 0.7 – 0.8 m. Perfaqesohen nga copa te formacioneve shkembore e gjysemshkembore te perziera me material suargjilore.

- Proluvionet

Ne shkembinjte ultrabazike mbizoteron stili i tektonikes shkeputese. Studimet e hollesishme qe jane bere ne te kaluaren kane vertetuar se ne to takohen kater sisteme kryesore me carje tektonike. Parametrat fiziko – mekanike te ketyre formacioneve te cilat do te perdoren per llogaritjet konstruktive te veprave jane si me poshte:

- a. Shkembji Ultrabazik – Harchburgite

- Pesha volumore ne gjendje natyrale $\gamma = 2,62 \text{ T/m}^3$
- Kendi i ferkimit te brendshem $\Phi = 32^\circ$
- Kohezioni $C=30 \text{ kg/cm}^2$

- b. Formacioni Flishor Gjysem Shkembor

- Pesha volumore ne gjendje natyrale $\gamma = 2,3 - 2.4 \text{ T/m}^3$
- Kendi i ferkimit te brendshem $\Phi = 29^\circ$
- Kohezioni $C=1.5 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit $E_d = 450 \text{ kg/cm}^2$




Figura 15: Harta Inxhinierike-geologjike e Shqipërisë




Figura 16: Harta skematike gjeologjike e Shqipërisë

3.11 Pedologjia dhe Perdorimi i Terrenit

Ne pergjithesi, Shqipëria ka nje situatë pedologjike shume komplekse. Pjesa Jug-Perendimore e ultesires bregdetare eshte formuar gjate periudhes se Quaternarit, nga veprimi i disa lumenjve kryesor (ne ta perfshihet edhe Lumi Lumi i Vjoses, Drinos, Velcanit, Nices dhe shume perrej te vegje te cilet ndodhen afer korridorit ne te cilin do te kaloje ky korridor) qe rrjedhin dhe derdhen ne detin Adriatik dhe Jon. Terreni i tokes eshte nje sistem dinamik i hapur i cili shkemben energji dhe materie me ekosisteme te tjere natyrore; ne zonen e studimit, morfologjia dhe klima kane patur nje rol kryesor ne evolucionin e territorit.

Ultesira e Korces eshte me e madhja dhe njekohesisht me e rendesishmja ne kete zone. Ajo shtrihet midis maleve te Moraves ne lindje, Malit te Thate ne verilindje, pragut te Cerraves ne veri, malesise se Gores, Voskopojes e Vithkuqit ne perendim dhe pragut te Qarrit ne jug. Ka gjatesi rreth 35 km dhe gjeresi nga 1 km ne rreth 16 km, ndersa siperfaqja rreth 300 km². Ajo ngushtohet ne jug dhe zgjerohet ne veri. Pjesa veriore dhe qendrore jane krejtesisht te rrafshta. Ne pergjithesi ka forme te luget, qe eshte me e shprehur ne pjesen jugore te saj. Pjesa me e madhe e saj shtrihet deri ne 900 m dhe vetem skaji jugor dhe disa kodra te vogla ne rrethinen perendimore kane lartesi me te madhe.

Shume studiues kane theksuar origjnen tektoniko-grabenore te fushegropes se Korces, qe u zhyt thelle ne kuaternar. Shpimet e koheve te fundit treguan se gelqeroret e burdigalian, qe ndertojne kreshten me te larte te maleve te Moraves (rreth 1700-1800) ndodhen ne thellesine 1000 m. Disniveli prej rreth 2000 m midis tyre ben fjale per shkallen shume te madhe te zhytjes se ketij grabeni dhe te diferencimit te tij me njesite

rrethuese. Per kete zhytje te fuqishme flet edhe trashesia e madhe e depozitimeve kuaternare (200-300 m).

Nje thyerje tektonike aktive e pershkon fushegropen e Korces ne drejtimin Voskopoje-Dishnices, duke ndare ate ne dy pjese me regjime te ndryshme te levizjeve neotektonike: pjesa veriore e perfshire nga levizje me te fuqishme ulese se pjesa jugore, ku me vone duhet te jene shfaqur edhe levizje ngritese me amplitude te vogel. Me keto shkaqe jane te lidhura edhe ndryshimet morfologjike: karakteri shume i rrafshet i pjeses veriore ne krahasim me ate jugore. Nderthurja e shtresave te zhavorreve me shtresa zhuresh, te ndara nga horizonte argjilash dhe subargjilash ne depozitimet kuaternare tregon se edhe ne fillim te kuaternarit fushegropa e Korces ka qene e mbuluar me nje liqen qe arrinte ne jug afer pragut te Qarrit. Ky liqen, per shkaqe ndoshta tektonike apo klimatike, e ka ndryshuar disa here thellesine e tij, per pasoje depozitimet jane te nderthurura, here me te trasha e here me te holla.

3.12 Ujrat Siperfaqesore

Ujrat sipërfaqesore përfaqësohen nga ato te lumit Vjosa dhe të degëve të tij (Drino-Bençe-Luftinje). Ujrat nëntokësore përfaqësohen nga burimet masive karstike si Uji i Ftohtë Tepelenë, Hormova, Lekel, Bença, Gurra në Progonat, Bambulli në Dukaj. Dhe mbi te gjitha ndotja e ujit eshte nje problem serioz ne Shqiperi. Cilesia e ujit ne pergjithesi eshte e ulet, ka lidhje te paligjshme dhe pikime te tubave te ujesjellsave ne te gjithe Shqiperine dhe ne zonen e projektit, gje qe e ben furnizimin me uje nje problem mbare kombetar⁷.

3.13 Ujrat nentokesore

Shqiperia eshte e pasur me ujera nentokesore, burime te medha karstike, burime minerale dhe burime termike. Uji eshte i pranishem ne shkembinj te ndryshem te moshave te ndryshme nga ato te llojit Paleozoic deri tek Quaternary, dhe rrjedh me drejtimin per tu derdhur ne det. Ujerat nentokesor jane shume te rendesishem sepse ato jane burimi i vetem per uje te pijshem. Por qe nuk dihet shume per kapacitetin e nxjerrjes nga ujerat nentokesore.

Ujrat nentokesore kane rendesi te madhe ekologjike, sepse ruajne specie nga rreziku i zhdukjes dhe u japin mundesi atyre te perhapen ne rajonet e tjera. Ato kane edhe rendesi te vecante ekonomike, sepse prej tyre, nepermjet gjahut e peshkimit, mund te sigurohen shume prodhime te larmishme. Kjo con ne disa vende ne problem serioze per te bere te mundur nje furnizim te rregullt. Gjate muajve te veres ashtu si sasia e ujera siperfaqesore edhe sasia e ujerave nentokesore zvogelohet. Meqenese zona ku do te zhvillohet projekti eshte ne lartesi te ndryshme, niveli i burimeve ujore nentokesore ndryshon ndjeshem. Gjate pergatitjes se VNM nuk jane vene re ndikime te rendesishme ne ujrat nentokesore ne korridorin ku kalon linja pergjate .

Puset e ujit te ndodhura ne bregdetin Adriatik kane tregues te larte te kripshmerise (sidomos ne zonat kodrinore te Qarkut te Gjirokastrës), ndoshta nga mbishfrytezimi. Sipas kushteve lokale ujerat nentokesore shfrytezohen nepermjet puseve ne fusha dhe lendina dhe ne formen e burimeve ujore ne kodra dhe shkembinj. Zakonisht ne zonat karstike te cilat ndikojne ne levizjen e ujerave nentokesore, basenet e lumenjve nuk koincidojne me burimet ujore.

http://www.inweb.gr/workshops/presentations_pdf/surface/Harja.pdf

3.14 Temperaturat mesatare te rajonit

Sigurisht qe kemi te bejme me nje projekt kompleks, pasi ky projekt perbehet nga ndertimi i Linjes 110 kV Permet-Erseke-Korce dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Permet-Erseke-Korce-Zemlakut. Ne figurat 17-24 eshte dhene grafiku i variacionit te temperatures bazuar ne matjet e stacionit metereologjik te Memalij, Permtit, Ersekës, Korces (qe erfshin edhe Zemlakun) Permetit (qe perfshin edhe Kelcyren) zone ne te cilen do te perfshihen edhe kater nenprojektet e siperpermenduara.




Figura 17.: Temperatura mesatare e ajrit ne °C per zonen e Memaliajt




Figura 18.: Temperatura mesatare mujore me e larte dhe me e ulet per Memaliajin.

Sic tregohet ne figurat kemi nje variacion te temperatures nga -4 °C deri ne 24°C gjate gjithe muajve te vitit me nje mesatare vjetore 10.82 °C.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PER ZEVENDESIMIN E LINJES SE VJETER ME LINJE TE RE 110 kV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET DHE ZGJERIMI I NENSTACIONEVE ELEKTRIK TE MEMALIAJT, KELCYRES DHE PERMETIT




Figura 19.: Temperatura mesatare e ajrit ne °C per zonen e Permetit




Figura 20.: Temperatura mesatare mujore me e larte dhe me e ulet per Permetit.




Figura 21.: Temperatura mesatare e ajrit ne °C per zonen e Ersekës




Figura 22.: Temperatura mesatare mujore me e larte, me e ulet per Ersekës




Figura 23.: Temperatura mesatare e ajrit ne °C per zonen e Korces




Figura 24.: Temperatura mesatare mujore me e larte dhe me e ulet per Korces

3.15 Shpejtesia mesatare e eres ne rajon

Ne figuren 25-32 eshte dhene grafiku i variacionit te shpejtesise mesatare te eres per cdo stine te vitit dhe asaj mesatare vjetore bazuar ne matjet e stacioneve meteorologjik perkates. Sic shihet nga figura shpejtesia mesatare vjetore e eres eshte 2.24 m/s.




Figura 25.: Shpejtesia mesatare e ajrit ne m/s per zonen e Memaliajt




Figura 26.: Shperndarja vjetore e drejtimeve te eres ne % per Memaliajn.




Figura 27.: Shpejtesia mesatare e ajrit ne m/s per zonen e Permetit




Figura 28.: Shperndarja vjetore e drejtimeve te eres ne % per Permetit.




Figura 29.: Shpejtesia mesatare e ajrit ne m/s per zonen e Ersekës




Figura 30.: Shperndarja vjetore e drejtimeve te eres ne % per Ersekës.




Figura 31.: Shpejtësia mesatare e ajrit ne m/s per zonen e Korces




Figura 32.: Shpërndarja vjetore e drejtimeve te eres ne % per Korces

3.3 Rrezatimi diellor mesatar ne rajon

Ne figurat 33-36 jane dhene vlerat e intensitetit te rrezatimit diellor per zonen e Memaliajt dhe Permetit per cdo muaj dhe asaj mesatare vjetore bazuar ne matjet e stacionet metereologjike.




Figura 33.: Intensiteti i rrezatimit diellor mesatar mujor per Memaliajn ne kJ/m²,dite




Figura 34.: Intensiteti i rrezatimit diellor mesatar mujor per Permetit ne kJ/m²,dite




Figura 35.: Intensiteti i rrezatimit diellor mesatar mujor per Korcen ne kJ/m2,dite




Figura 36.: Intensiteti i rrezatimit diellor mesatar mujor per Erseken ne kJ/m2,dite

3.4 Reshjet mesatare ne rajon

Persa i perket rregjimit te shirave, eshte e nevojshme te saktesojmë se vlera vjetore mesatare e reshjeve (gati 70%) eshte e rregjistruar gjate muajve te ftohte (tetor-mars). Muaji me me shume reshje ne brendesi te territorit te ketyre zonave (Permetit, Ersekës, Korces (perfshire dhe Zemlakun)) eshte muaji Nentor, nderkohe qe muajt me me pak reshje jane Korriku dhe Gushti. Numri i diteve me reshje (me nje lartesi reshjesh me shume se 1.0 milimeter), pergjate nje viti vertitet rreth 70-75 dite/vit per keto zona. Klima eshte e karakterizuar nga nje nivel reshjesh tipike mesdhetare me te pakten gjashte muaj me diell gjate stines se nxehte. Reshjet mesatare vjetore vertiten rreth 910 mm dhe temperatura mesatare eshte 18 °C.

4. PËRSHKRIMI I TË GJITHA INSTALIMEVE QË BËJNË PJESË NE PROJEKTIN ME TE GJITHE KOMPONETET PERBERES TE TIJ

Te gjitha projektet e identifikuar te zgjerimit 110 kV dhe vecanerisht linjat 110 kV Permet-Erseke-Korce dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Permet-Erseke-Korce-Zemlakut (objekt i kesaj VNM), qe do te finacohen sipas marreveshjes nga ana e KfW do te rrisin besueshmerine e rrjetit dhe sigurine e furnizimit si dhe do te reduktojne humbjet teknike ne sistemin e transmetimit. Harta e sistemit te transmetimit per pjesen Jug-Lindore te vendit per vitin 2015 eshte paraqitur ne Figurat 37-38.




Figura 37.; Linja e re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korçe-Zemlak (pjesë e kesaj VNM-je) si dhe lidhja e saj me rrjetin ekzistues te transmetimit




Figura 38: - Linja e re 110 kV Memaliaj-Kelcyre- Permet-Erseke-Korçe-Zemlak (pjesë e kesaj VNM-je) si dhe lidhja e saj me rrjetin ekzistues te transmetimit

Kjo linje do te lidhe kater objekte shume te rendesishme sic jane Nienstacionet e Permet-Erseke-Korçe-Zemlak. Gjithashtu kjo do te beje te mundur fuqizimin dhe garantimin e

furnizimit ne menyre te vazhduar per te gjithë zonen. Te gjitha projektet e identifikuar te zgjerimit 110 kV dhe vecanerisht linjat 110 kV Babice-Orikum-Himare-Sarande (ndertimi do te filloje ne vitin 2011 deri ne 2013) qe do te finacohen sipas marreveshjes nga ana e KfW do te rrisin besueshmerine e rrjetit dhe sigurine e furnizimit si dhe do te reduktojne humbjet teknike ne sistemin e transmetimit te Tensionit te Larte. Disa parametra special te linjes dhe te kushteve te prjektimit te saj jane dhene ne vazhdim:

Percjellesat ACSR 240/40 (243-AL i/39-St 1A)

OPGW-ACS 63(66-A20SA as per EN50182)

Parametrat kryesore te projektimit:

Temperatura max 50°C

“ “ “ “ min -25°.

Temperatura e çdo dite 15°C.

Temperaturat me ere max 15°C.

Trashesia e akullit 15mm

Hapesira minimale midis percjellsave te fazes 1.15m.

Minimumi i hapesires vertikale i percjellesit (nga pika ku percjellesi i linjes ka varjen me te madhe) me token te jete:

1-Toke normale-6m.

2-Toke ne zona te banuara- 8m.

3-Rruge 7m

4-Peme te rritura 2.5m.

5-Linja OHL (poshte linjes) 1.15m

Puna per Bazamentet

- 1- Puna germuese
- 2- Punaimet plotesuese para se te hidhet betoni.
- 3- Ndertimi i bazamentit.
- 4- Punime mbushese.

Pastrimi i vendit

Shperthimet per hapjen e gropave te bazamenteve ne shkemb, do te behen me leje dhe te vezhguara nga forcat e sigurise.

Druret qe jane te rrezikuara nga shperthimet, do te mbrohen.

Siguria

1-Nese linja kalon mbi çati metalike, tubacione ose objekte te tjera qe mund te induktohen nga elektriciteti i linjes, keto objekte tokezohen

2-Nje unaze e mbyllur toke, me thellesi 0,65m ne nje distance prej 1m nga kembet e shtyllave prej çeliku, do te pastrohet plotesisht.

3-Mbi linja komunikimi, linja tensioni dhe shtepi te banuara, do te vendosen skela qe te perballojne erera te fuqishme si edhe renien e peshes se percjellesit.

4-Voltazhi minimal-110 kV

5-Max i voltazhit qe do te operohet -123 kV.

6-Frekuenca e fuqise-50Hz.

7-Projektimi i nivelit baze te izolimit-550 kV peak.

8-Rryma e qarkut te shkurter per stabilitet termik qe kerkon OPGW-6kV.

Percjellesat e fazes dhe te OPGW do te perfundojne ne strukturat e nenstacioneve.

Per te shmangur ndertimet e reja te pakontrolluara, linja eshte parashikuar te kaloje ne terren shkembor. Gjate ndertimit do te vezhgohen ujrat ekzistues, shenja te linjave elektrike afer linjes qe po ndertojme ose antena telekomunikacioni, per te siguruar ato nga qe te mos kemi demtime te

mundeshme. Pastrimi i vegjetacionit do te behet ne menyre te diferencuar sipas ekzistences poshte percjellesve te rrugeve, lumenjve, linja te telekomunikacionit, duke llogaritur kete pastrim me marrjen parasysh te kushteve me te keqia te motit. Gjate ndertimit do te zbatohen kriteret e meposhtme:

- 1-Menjanimi i zonave te populluara sa me shume te mundemi.
- 2-Menjanimi i kryqezimit me linja te tjera te tesionit te larte dhe kalimi mbi rruge kryesore.
- 3-Pikat kendore te vendosen ne menyre te tille qe te lejojne transportimin e materjaleve te linjes.
- 4-Te kete mundesi mirembajte te linjes.
- 5-Te kihet kujdes per gjithe aspektet ambientale.
- 6-Te kihet parasysh mbrojtja nga erozioni dhe rreshkitjet ne zonat malore
- 7-Perkulja(varja e percjellsave) do te pershtatet sipas zones klimatike.
- 8-Kontrolli i shtyllave do te behet me program kompjuterik, ku te dhenat nga percjellesat (si tensioni apo parametra te tjere) do te jene te dhenat per kete program.
- 9-Per gjithe pozicionet e shtyllave do te monitorohet max. i eres dhe peshes.
- 10-Distanca e shtyllave nga njera tjetra do te jete me e vogla e mundshme.
- 11-Pemet frutore dhe dritherat, nuk do te pastrohen gjate linjes duke marre parasysh gjatesine e tyre.
- 12-Aty ku linja ndeshet me linja te tjera OHL, vendosja e shtyllave do te behet paralel me ate ekzistuese sa me shume te jete e mundur.

5. PLANI I NDËRTIMIT TE LINJES 110 KV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET-ERSEKE-KORCE-ZEMLAK DHE NENSTACIONEVE PERKATESE

Investimet per ndertimin te linjes ne fjale dhe zgjerimi/ndertimi i nenstacioneve perkates do te financohen nga Banka Gjermane KfW dhe kjo hua ben pjese ne huane me shume komponente per rehabilitimin e Sektorit Elektroenergjitik Shqiptar.. Periudha e ndertimit, testimit dhe komisionimit eshte llogaritur te jete 18 muaj dhe per pasoje parashikohet qe linja te hyje perfundimisht ne operim ne mes te vitit 2012.

Specilistet e OST me ndihmen e eksperteve gjerman dhe shqiptar po punojne per te bere te mundur realizimin teknik te projektit. Aktualisht specilistet gjermane kane specifikuar te gjithe termat teknike dhe kane filluar projektimin e kesaj linje duke realizuar ne plan te pare survejimin topografik. Ne tabelen 6 eshte dhene periudha e ndertimit, testimit dhe komisionimit e objekteve kryesore te ketsaj linje perfshire ketu edhe periudhen e pergatjes se sheshit dhe kantjerit perkates.

Tabela 6.: Periudha e Ndertimit te Linjes: 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak se bashku me zgjerimin e nenstacioneve perkates

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
Elementet Kryesore te Ndertimit	1																	
Pergatitja e Kantjerit																		
Survejimi topografik ne korridorin ku do te kaloje linja Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak																		
Pergatitje e Korridorit te Linjes																		
Zevendesimi/cmontimi i linjave te vjetra																		

**VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PER ZEVENDESIMIN E LINJES SE VJETER ME LINJE TE RE 110 kV MEMALIAJ-
KELCYRE-PERMET DHE ZGJERIMI I NENSTACIONEVE ELEKTRIK TE MEMALIAJT, KELCYRES DHE PERMETIT**

Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Memaliajt																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Kelcyres																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Permetit																			
Ndertimi i Bazamenteve te kullave																			
Instalimi i kullave																			
Ndertimi i percuesve																			
Instalimi i izolatoreve																			
Dalje Linje 110 kV																			
Dalje Linje 110 kV																			
110 kV BB Coupler																			
110 kV BB Coupler																			
Zgjerimi i nenstacioneve																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Permetit																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Eresekës																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Korces																			
Punime Ndhimese per Linjen dhe zgjerimin e nenstacionit te Zmlakut																			
Vendosja e seksionuesit 110 kV te nenstacioneve																			
Vendosja e seksionuesit 20/10/6 kV te nenstacioneve																			
Vendosja e transformatoreve																			
Punime Inxhinjerike																			
Testimi																			
Komisionimi																			

6. KRAHASIMI I VARIANTEVE DHE PËRSHKRIMI I VEPRAVE INXHINIERIKE QË NDËRTOHEN PER LINJEN 110 kV DHE NENSTACIONET PERKATESE

6.1 Analiza e varianteve

Ndertimi Linjes se Re 110 kV Erseke – Permet do te mbylle unazen e rrjetit 110 kV ndermjet pjeses Jugore dhe asaj Juglindore te Sistemit Shqiptar te Transmetimit. Kjo unaze perfshin Linjat 110kV: Fier – Ballsh; Ballsh - Memaliaj; Memaliaj -Kelcyre; Kelcyre - Permet; Permet - Erseke; Erseke - Leskovik; Leskovik – Korce dhe Korce - Zemblak. Ndertimi i kesaj linje do te krijojte mundesine per nje cilesi me te larte te energjise elektrike dhe nje furnizim me te qendrushem te pjeses jugore te Shqiperise (kriteri N-1). Me ndertimin e kesaj linje, do te zvogelohen humbjet teknike dhe do te permiresohet niveli i tensionit. Nga ana tjeter, ndertimi i Linjes se Re 110 kV Erseke-Permet dhe fuqizimi i Linjes 110 kV Korce – Zemblak, krijon mundesine e lidhjes se hidrocentraleve qe do te ndertohen ne kete zone ne te ardhmen me rrjetin e transmetimit.

Krahas ndertimit te Linjes se Re 110 kV Erseke – Permet do te behet fuqizimi i Linjes egzistuese 110 kV Korce – Erseke. Linja egzistuese eshte shume e vjeter me nje seksion dhe konduktor 120 mm². Duhet te behet cmontimi i shtyllave egzistuese dhe duhet te ndertohet Linja e Re mbi linjen egzistuese me konduktore 240 mm². Projekti perfshin perfundimin e nenstacioneve egzistuese 110/10 kV te Ersekës dhe Permetit me line bays te rinj 110 kV dhe zgjerimin e seksionuesve egzistues 110 kV ne keto nenstacione. Per zgjerimin e ketyre nenstacioneve nuk kerkohet toke shtese.

Per ndertimin e kesaj linje deri me tani nga ana e projektuesve jane studjuar ne detaje tre variante. Varianti i Pare ka nje gjatesi totale te linjes 104566 m (104.57 km); variant i trete ka nje gjatesi 130746 m (130.746 km) dhe variant i dyte ka nje gjatesi 122920 m (122.920 km). Variantet jane ne te njejtin korridor ne segmentet Memaliaj-Kelcyre, Kelcyre-Permet, Erseke-Korce sic tregohet ne tabelat 7-8-9 dhe i vetmi ndryshim eshte ne segmentit Permet – Erseke ne te cilin kemi tre variante. Ashtu sic tregohet ne tabelat 7-8 dhe ne figuren 39 segmenti Permet-Erseke sipas variantit te pare eshte 29746 m, sipas variantit te trete rreth 52000 m dhe sipas variantit te dyte eshte 55926 m.

Tabela 7.: Distancat dhe kostot e linjes sipas secilit segment dhe sipas secilit variant

Segmenti i Linjes	Varianti I, distanca m	Varianti I, Kosto Euro	Varianti II, distanca m	Varianti II, Kosto Euro	Varianti III, distanca m	Varianti III, Kosto Euro
Memaliaj-Kelcyre	23,220		23,220	3,744,000	23,220	3,744,000
Kelcyre-Permet	15,762	3,744,000	15,762		15,762	
Permet- Erseke	29,746	3,689,000	52,000	6,545,000	55,926	5,548,605
Erseke - Korce	35,838	3,456,000	35,838	3,456,000	35,838	3,456,000
Total Section, m	104,566	10,889,000	126,820	3,745,000	130,746	12,748,605

Tabela 8.: Nivelet e tensionit dhe kostot nderhyrjeve ne secilin Nenstacion te sirpermendur

<i>Nenstacioni</i>	<i>Kapaciteti, 110/35/10 kV</i>	<i>Kosto Euro</i>
<i>Memaliaj</i>	<i>110/35/10 k</i>	<i>3,750,000</i>
<i>Kelcyre</i>	<i>110/35/10 k</i>	<i>1,866,875</i>
<i>Erseke</i>	<i>110/35/10 k</i>	<i>1,891,875</i>
<i>Korce</i>	<i>110/35/10 k</i>	<i>406,875</i>
<i>Zemlak</i>	<i>400/110 kV</i>	<i>4,971,300</i>
<i>Total</i>		<i>12,886,925</i>

Tabela 9.: Kostot totale, sipas secilit variant, per te gjithë projektin e Juglindjes

<i>Segmentet e linjes ne total dhe Nenstacionet ne total</i>	<i>Kosto Euro-Varianti I (linja dhe nenstacionet)</i>	<i>Kosto Euro-Varianti II (linja dhe nenstacionet)</i>	<i>Kosto Euro-Varianti III (linja dhe nenstacionet)</i>
<i>Total Kosto ne Euro</i>	<i>23,775,925</i>	<i>26,631,925</i>	<i>25,635,530</i>
<i>Total Kosto ne % kundrejt vleres me te ulet</i>	<i>100.00%</i>	<i>112.01%</i>	<i>107.82%</i>

Diskutimi i korridorit te plote i Variantit te trete (si varianti me i mire) eshte dhene ne seksionet ne vijim ndersa me poshte jepen nje analize e detajuar per te tre variantet vetem per segmentin Permet – Erseke.

6.1.1 Peshkrimi i Variantit te Pare te Segmentit Permet- Erseke

Sipas kesaj alternative gjatesia e pergjithshme e linjes eshte rreth 29.746 km (paraqitur me vije te verdhe ne hartën e dhene ne figuren 39). Ky eshte edhe varianti me i shkurter dhe me kosto financiare me te ulet ne krahasim me te gjithë variantet. Por nga ana tjeter duhet deklaruar se ky koridor linje do te kaloje ne nje pjese te konsiderueshme brenda zones se mbrojtur te Hotoves.

Duhet patur parasysh ashtu sic u tha dhe me lart qe brenda zones se mbrojtur jane dhene ose jane ne proces licensimi ndertimi i hidrocentraleve lokale. Nje nga keta eshte dhe hidrocentralet e Carcoves, Radove, Leskovik 1 dhe 2 (ekzistues) dhe Leskovik 3 (ri), Carcova e re (ri) qe aktualisht jane ne proces kryerje punimesh per ndertimin e tyre dhe zgjedhja e linjes sipas ketij varianti i ndihmon ata shume per te bere nje transmetim me kosto minimale lidhje me sistemin elektroenergjetik shqiptar.

Nga ana tjeter, shfrytezimi i kesaj linje per te lidhur keta centrale dhe te tjere qe do te ndertohen ne te ardhmen u krijon mundesi ketyre centraleve qe ata te lidhen ne menyre te grupuar dhe jo secili me nje linje me vete, gje e cila do ta ngacmonte ne menyre kumulative shume me teper mjedisin. Mbeshtetur ne keto dy argumente te rëndesishme dhe ne koston minimale qe ofron ky variant Ekspertet e OST-se se bashku me ekspertet Gjerman te Fichtnerit parashtruan kete variant ne disa diskutime shume produktive ne Ministrine Mjedisit, Pyjeve dhe Manaxhimit te Ujrave. Megjithese, ky variant paraqiste avantazhe te qarta ekonomike (por me ndikime ne Parkun e Hotoves) u ra dakord nga te gjithë pjesemarresit te analizoheshin edhe dy variante te tjera jashte zones se Parkut Kombetar te Hotoves.

6.1.2 Pershkrimi i Variantit te Dyte te Segmentit Permet- Erseke

Gjatesia e pergjithshme e linjes sipas variantit te dyte eshte 126.82, kurse gjatesia e segmentit Permet-Ereseke sipas ketij varianti eshte 52 km (paraqitur me vije te blu ne harten e dhene ne figuren 39). Nje nga aspektet negative te ketij varianti eshte se kosto njesi e ndertimit te kesaj linje eshte shume e madhe (si ne krahasim me variantin e III qe ka koston me te vogel njesi ne krahasim dy te tjeret ashtu edhe ne krahasim me variantin e pare) pasi kemi te bejme me ndertimin e saj ne zona te pashkelura nga rruget ekzistuese dhe per hapjen e ketyre rrugeve duhet te priten nje sere pyjesh dhe te demtohen nje sere habitatesh.

Ky variant eshte me i shtrenjte si nga ana ndertimore, pasi duhet te porositen me shume shtylla, me shume percjelles, duhet te behen disa zona totalisht te pashkelura dhe mirembajtje do te jete shume e veshtire sidomos ne dimer, kur behet ngjitja per ne pikat me te larta duhet qe pothuajse per cdo shtylle qofte kjo ankerore apo ndermjetese te behet rruge me vete pasi mundesia e perdorimit te se njejtës rruge per te ndertuar disa shtylla eshte praktikisht e pamundur per shkak te terrenit te thyer. Ashtu si ne variantin e trete edhe ketu evitohet kalimi ne zonen e mbrojtur, por ne dallim me te ketu do te preken shume pyje dhe kosto njesi e ndertimit te linjes eshte shume e larte.

6.1.3 Pershkrimi i Variantit te Trete te Segmentit Permet- Erseke

Ne lidhje me ndertimin e linjes se tensionit te larte 110 kV Permet Erseke, sipas variantit te trete linja kalon pergjate rruges nacionale Permet – Erseke, ne luginen e lumit Vjosa e pasi kalon fshatin Carcove, ngjitet per ne Leskovik, e pas Leskovikut vazhdon paralel me trasene e linjes 35 kV Leskovik – Erseke.

Kjo linje pothuajse ne te gjithe gjatesine e ketij segmenti, ka zgjedhur nje korridor, i cili shfrytezon rrugen nacionale, rruget dytesore ekzistuese qe lidhin fshatrat me rrugen nacionale (dhe pas perfundimit te linjes – eshte lene detyre karshi kontraktorit qe do te ndertoje kete linje qe te gjitha rruget te sillen ne gjendjen fillestare/te riparohen ne se do te kete ndonje demtim te mundshem).

Ky variant eshte me i gjate se varinatti pare, rreth 55.926 km (pra 26 km me i gjate - paraqitur me vije te kuqe ne harten e dhene ne figuren 39), me i shtrenjte nga ana ndertimore, pasi duhet te porositen me shume shtylla, me shume percjelles, duhet te behen disa kalime te lumit Vjosa, por eshte shume e rendesishme te theksohet se do te shfrytezohen rruget ekzistuese (qe do te thote ndikim kumulativ ne mjedis shume me i vogel se varianti pare dhe i dyte), mirembajtja do te jete shume me e lehte sidomos ne dimer. Ky variant e eliminon kalimin ne zonen e mbrojtur dhe ne fshatin Carcove kalimi i linjes behet mbrapa fshatit duke bere keshtu zgjatjen e saj akoma edhe me shume.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PËR ZEVENDESIMIN E LINJES SE VJETER ME LINJE TE RE 110 kV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET DHE ZGJERIMI I NENSTACIONEVE ELEKTRIK TE MEMALIAJT, KELCYRES DHE PERMETIT




Figura 39.: Tre variantet (I-verdhe, II-blu dhe III-kuq) per korridorin e linjes per segmentin Permet-Erseke

6.2 Analiza multi kriteriale per zgjedhjen e varianteve

Te gjithë kompanite e Tranmetimit te Evropes Jug Lindore duke perfshire edhe kompanine OST jane te detyruar te planifikojne sistemet e transmetimit me kosto minimale dhe njekohesisht me ndikim minimal ne mjedis. Planet e tyre duhet te perfshijne pajisje dhe objekte te reja, te planifikuar paraprakisht per te siguruar kerkesen e tyre kombetare, detyrimet dhe kriteret e ndryshme te projektimit dhe ndertimit te linjave dhe nenstacioneve elektrike. Kjo liste projektesh, e cila eshte paraqitur ne Strategjine Kombetare te Zhvillimit te Sektorit te Transmetimit dhe Shperndarjes, per vitin 2015 dhe 2020, ka perfshire parametra teknike te projekteve kandidate, duke perfshire edhe keto parametra baze.

6.2.1 Kriteret teknike-financiare-mjedisore per projektimin dhe ndertimin e linjes te reja te tensionit te larte sic eshte edhe linja 110 kV Memaliaj-Kelcyre- Permet – Erseke – Korce - Zemplak

- 1) Viti i parashikuar i ndertimit,
- 2) Niveli i tensionit,
- 3) Gjatesia e linjes,
- 4) Nyjet lidhese,
- 5) Materialet qe do te perdoren per ndertimin e saj,
- 6) Parametrat elektrik,
- 7) Rryma maksimale e lejuar,
- 8) Kostot e ndertimit te njesise se gjatesise se linjes (€/km),
- 9) Kosto fizike te buxhetit total te ndertimit me celesa ne dore te linjes (€).
- 10) Kosto e sherbimit dhe mirmbajtjes se linjes gjate operimit te saj (€/vit).
- 11) Kosto totale (€).

6.2.2 Kriteret teknike-financiare-mjedisore per projektimin dhe ndertimin e nenstacioneve e rinj sic eshte rasti i zgjerimit te nenstacioneve elektrike 110/20 kV te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Ersekës, Korces dhe Zemplakut qe do te behet prane nenstacioneve ekzistuese.

- 1) Viti i parashikuar i zgjerimit,
- 2) Niveli i tensionit,
- 3) Nyjet lidhese,
- 4) Norma e lejuar e ngarkimit te nenstacionit
- 5) Materialet qe do te perdoren per ndertimin e tij,
- 6) Parametrat elektrik,
- 7) Rryma maksimale e lejuar,
- 8) Kostot e ndertimit te njesise se MVA (€/MVA),
- 9) Kosto fizike te buxhetit total te ndertimit me celesa ne dore te Nenstacionit (€).
- 10) Kosto e sherbimit dhe mirembajtjes se nenstacionit gjate operimit te saj (€/vit).
- 11) Kosto totale (€).

Per te perzgjedhur variantin me te mire bazuar ne analizen multi-kriteriale teknike-financiare-mjedisore, per te plotesuar kerkesat sipas nje skenari te furnizimit me energjie elektrike te kesaj zone, eshte shume e rendesishme qe te gjithë variantet e ndertimit te tyre te renditen ne baze kesaj analize. Kjo metode eshte me shume komplekse ne krahasim me metoden e perdorur deri tani (e cila konsideron pjesen me te madhe te kohes vetem kriteret teknike) dhe merr ne konsiderate te gjithë aspektet: teknike, ekonomike,

financiare si dhe ato mjedisore. Kjo analize eshte bere per nje pakete kriteresh, te cilat jane percaktuar per te nxjerre ne pah rendesine e ndertimit te Linjes 110 kV, Zevendesimin e Linjes ne disa segmente, te vjeter me nje Linje te re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak si dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Ersekes, Korces dhe Zemlakut, si me poshte:

- 1) Urgjenca ne lidhje me nevojen e menjehershme per projektin per zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekes dhe Korces;
- 2) Perfitimet Teknike per rritjen e sigurise se furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve per zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekes dhe Korces;
- 3) Perfitimet Teknike per Reduktimin e Humbjeve Teknike ne Rrjetet e Transmetimit ne te gjithë sistemin e OST-se.
- 4) Ndikimi Mjedisore nga Ndertimi i disa segmenteve dhe Zevendesimi i disa segmenteve te tjera per Linjen e siperpermendur;
- 5) Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur zhvillimin rajonal ekonomik dhe turizmin per zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekes dhe Korces;
- 6) Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Zhvillimet ne Sistemin e Shperndarjes per zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekes dhe Korces;
- 7) Fizibiliteti Ekonomiko-fianciar i Projektit te Zevendesimit te Linjes se vjeter me nje Linje te re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet si dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrike te Memaliajt, Kelcyres dhe Permetit.

Metodologjia e analizes multi-kritere perdoret nga te gjitha institucionet nderkombetare perfshire dhe Banken Gjermane te Zhvillimit KfW, eshte ne perputhje me Direktivat Europiane te Zhvillimit te Qendrueshem duke vene ne plan te pare zhvillimin rajonal te qendrueshem dhe mbrojtjen e mjedisit. Cdo kriter per analizen multikriteriale eshte peshuar sipas rendesise sic eshte paraqitur ne Tabelen 9.

Tabela 9.: Analiza multikriteriale per Zevendesimi i Linjes se vjeter me nje Linje te re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet si dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres dhe Permetit

Nr	Criteria	Piket
1	Urgjenca ne lidhje me nevojen e menjehershme per realizimin e projektit	10
2	Perfitimet Teknike per rritjen e Besueshmerise se Sigurise se furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve ne kete rajon	10
3	Perfitimet Teknike per Reduktimin e Humbjeve Teknike ne Rrjetet e Transmetimit	10
4	Ndikimi Mjedisore nga Ndertimit i Projektit te Transmetimit	25
5	Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Centralet e reja te Prodhimit	10
6	Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Zhvillimet ne Sistemin e Shperndarjes	15
7	Fizibiliteti Ekonom i Projektit te Transmetimit	20
	Totali	100

Pikesimi i perdorur ne tabelen e mesiperme per kriterin mjedisor (25 pike), me shume se sa per cdo kriter tjetër) tregon edhe nje here rendesine e madhe qe i eshte kushtuar nga ana e projektuesve aspekteve mjedisore gjate Ndertimit te disa segmenteve dhe Zevendesimit te disa te tjerave per Linjen 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak si dhe

ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Erseke, Korce dhe Zemlak. Ne vazhdim do te pershkruhet cdo kriter per secilin variant.

6.2.3 Urgjenca ne lidhje me nevojen e menjehershme per Ndertimin te disa segmenteve dhe Zevendesimit te disa te tjerave per Linjen 110 kV te Juglindjes si dhe ndertimi/fuqizimi zgjerimi i nenstacioneve perkates.

Ne baze te pershkrimt te situates aktuale (te kryer per vitet 2009-2011), analiza ne vazhdim eshte kryer per variantet ne lidhje me urgjencen e ndertimit te linjes dhe fuqizimit te nenstacioneve. Mbingarkesa e secilit variant te linjave ose te nenstacioneve jane renditur sipas “kriterit te urgjences” duke i dhene atyre pike te ndryshme sipas analizese se fluksit te ngarkeses si ne Tabelen 10. Analiza e sistemit elektroenergjetik ne Jug-lindje te vendit dhe per zonat e Memaliaj-Kelcyre- Permet-Erseke-Korce tregon qe ky projekt eshte super urgjent per cilesine e ulet te furnizimit qe perjeton kjo zone sot dhe per pasoje te tre variantet kane pike te njejta (maksimale).

Tabela 10: Kriteri 1.: Urgjenca ne lidhje me ndertimin e disa segmenteve dhe zevendesimit e disa te tjerave per Linjen 110 kV si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve perkates				
Nen-Kritere	Shume urgjente	Urgjente	Normale	Jo urgjente
Piket e kriterit	100	75	50	0
Piket per Variantin e Pare	100			
Piket per Variantin e Trete	100			
Piket per Variantin e Dyte	100			

6.2.4 Perfitimet Teknike per rritjen e Sigurise se furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve

Kjo analize eshte realizuar kete duke i dhene pike varianteve te ndryshme sipas kriterit n-1 te analizese (e barabarte me sigurine e furnizimit) sic tregohet ne Tabelen 11. Analiza e fluksit te ngarkeses dhe te sigurise eshte kryer per periudhen e planifikimit duke perdorur tipologjine e rrjetit e cila nuk perfshine projektin ne fjale (sipas variantit perkates) dhe pas saj duke konsideruar projektin ne fjale te ndertuar dhe qe funksionon plotesisht. Ne baze te pershkrimt te situates aktuale (te kryer per vitet 2009, 2010, 2013, 2015), me dhe pa projektin tone ne fjale, ne kemi analizuar sipas “kriterit te besueshmerise” projektin ne fjale. Analiza sipas ketij kriteri tregon se varianti III ka piket maksimale meqense korridori i tij eshte zgjedhur qe te ndertohet prane rruges ekzistuese duke garantuar ne kete menyre riparim te shpejte, ne kohe rrekord, pra duke garantuar siguri te furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve.

Tabela 11 – Kriteri 2.: Perfitimet Teknike nga Linja dhe Nenstacionet per rritjen e Sigurise se furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve ne zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekes dhe Korces			
Nen-kritere	Shume e larte	Normale	Nuk ndihmon
Piket e kriterit	100	50	0
Piket per Variantin e Pare	50		
Piket per Variantin e Trete	100		
Piket per Variantin e Dyte	75		

6.2.5 Perfitimet Teknike per Reduktimin e Humbjeve Teknike ne Rrjetet e Transmetimit

Kjo analize eshte realizuar per nivelin e humbjeve teknike per projektin ne fjale duke u bazuar ne tipologjine e rrjetit. Ne baze te pershkrimt te situates aktuale (te kryer per vitet 2009, 2010, 2013 dhe 2015), eshte kryer analiza e humbjeve teknike per projektin ne

fjale sipas “kriterit te reduktimit te humbjeve teknike” duke i dhene atyre pike te ndryshme sipas analizes se reduktimit te humbjeve sic tregohet ne tabelen 12.

Tabela 12 – Kriteri 3.: Perfitimet Teknike per Reduktimin e Humbjeve Teknike ne Rrjetet e Transmetimit me me ndertimin e disa segmenteve dhe zevendesimit e disa te tjerave per Linjen 110 kV si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve perkates			
Nen-kriter	Shume te larta	Normale	E ulet
Piket e kriterit	100	50	0
Piket per Variantin e Pare	80		
Piket per Variantin e Trete	75		
Piket per Variantin e Dyte	70		

6.2.6 Ndikimi Mjedisore nga Ndertimit i Projektit te Transmetimit

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, eshte nje kriter shume i rendesishem i cili eshte marre parasysh gjate gjithë fazes aktuale te Ndertimit/Zevendesimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Erseke, Korce dhe Zemlak. Do te kemi dy lloje ndotjesh gjate ndertimit te linjes dhe zgjerimit te nenstacionit: ndotje gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se operimit. Projektet me me pak ndikime mjedisore dhe sociale do te kene pike minimale (0) dhe projektet me probleme te medha mjedisore dhe sociale do te marrin pike maksimale (100) sic eshte paraqitur ne Tabelen 13. Analiza sipas ketij kriteri tregon se varianti III ka piket minimale (dmth ka ndikim minimal ne mjedis) meqense korridori i tij eshte zgjedhur qe te ndertohet prane rruges ekzistuese duke garantuar ne kete menyre nderhyrje minimale ne mjedis dhe duke bere riparimin e shume rrugeve te fshtrave (per qellime te vendosjes se shtyllave), te cilat me vone do te mbeten ne sherbim te komunitetit.

Tabela 13 – Kriteri 4.: Ndikimi Mjedisore me ndertimin e disa segmenteve dhe zevendesimit e disa te tjerave per Linjen 110 kV si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve perkates			
Nen-kriter	Ndikim i larte	Ndikim normal	Shume i ulet
Piket e kriterit	100	50	0
Piket per Variantin e Pare	75		
Piket per Variantin e Trete	10		
Piket per Variantin e Dyte	20		

6.2.7 Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Centralet e reja te Prodhimit

Nje nga kriteret kryesore per perzgjedhjen e pajisjeve te te Ndertimit/Zevendesimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres, Permetit, Erseke, Korce dhe Zemlak jane mundesia per rritjen e kapacitetit per lidhjen e centraleve te reja te prodhimit te energjise. Ne kete zone sic edhe eshte permendur me siper jane te pakten 6 centrale ne prodhim ose ne ndertim e siper dhe nje numer i madh te tjeresh ne planifikim. Linjat/nenstacionet e transmetimit ne pergjithesi dhe Zevendesimi i Linjes se vjeter me nje Linje te re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet, si dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres dhe Permetit eshte pare ne kendveshttrimin edhe per t’i sherbyer ndertimit te hidrocentraleve te vegjel, centraleve te eres qe do te ndertohen ne keto zona. Ne kete konteks kea variante jane renditur sipas “Kriterit te mbeshtetjes se centralve gjeneruese/prodhuese” duke i dhene atyre pike te ndryshme sipas analizes se kryer sic paraqitet ne tabelen 14. Analiza sipas ketij kriteri tregon se varianti I ka piket maksimale meqense korridori i tij eshte after ketyre

centraleve dhe pas tij variant i III garanton lidhjen e ketyre centraleve ne nje distance me te larget se variant I I, por me te afert se variant I dhe II.

Tabela 14 – Kriteri 5. : Rritja e Kapacitetit nga Linja dhe Nenstacionet per te mbeshetur centralet e reja te Prodhimit te Energjise Elektrike ne Zone				
Nen-kriter	Shume e larte	E larte	Normal	Fare
Piket e kriterit	100	75	50	0
Piket per Variantin e Pare	90			
Piket per Variantin e Trete	70			
Piket per Variantin e Dyte	50			

6.2.8 Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshetur Zhvillimet ne Sistemin e Shperndarjes ne zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekës dhe Korces

Nje kriter tjetër kyc për perzgjedhjen e projektit të transmetimit është mundësia që ky projekt në fjalë do të asistojë lidhjen e qendrave të reja të shpërndarjes së ngarkesës. Linjat e transmetimit të cilat mbështesin qendrat e shpërndarjes së ngarkesës janë renditur sipas “kriterit të mbështetjes së shpërndarjes” duke i dhënë atyre piket maksimale sipas analizës së kryer sic paraqitet në tabelën 15. Analiza sipas këtij kriteri tregon se varianti III ka piket maksimale mëqenese korridorit i tij është zgjedhur që të ndërtohet pranë qendrave të banimit për të bërë mundur garantimin e furnizimit për të gjitha fshatrat dhe qytetet si dhe duke garantuar nivelin e tensionit për të gjithë llojet e konsumatoreve.

Tabela 15 – Kriteri 6.: Rritja e Kapacitetit te Transmetimit nga Linja dhe Nenstacionet per te mbeshetur Zhvillimet ne Sistemin e Shperndarjes ne zonat e Tepelenes, Permetit, Ersekës dhe Korces				
Nen-kriter	Shume e larte	E larte	Normal	Fare
Piket e kriterit	100	75	50	0
Piket per Variantin e Pare	80			
Piket per Variantin e Trete	100			
Piket per Variantin e Dyte	50			

6.2.9 Fizibiliteti Ekonomik i Zevendesimit te Linjes se vjeter me nje Linje te re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet si dhe zgjerimi i Nenstacioneve Elektrik te Memaliajt, Kelcyres dhe Permetit

Llojet e mëposhtme të përfitimeve nga projekti në fjalë janë vlerësuar në mënyrë çësore dhe sasiore për secilin variant duke përdorur kriteret e mëposhtme të vlerësimit ekonomik:

- Përfitimi nga reduktimi i kostove të pritshme vjetore të energjisë elektrike të mos furnizuar në se projekti në fjalë nuk do të realizohet.
- Përfitimi nga reduktimi i humbjeve vjetore,
- Përfitimi nga reduktimi i kostove vjetore të ri-shpërndarjes ,
- Përfitimi nga reduktimi i kostove vjetore të shmangjes të pengesave të furnizimit.

Përfitimi total vjetor i pritshëm i projektit në fjalë do të jetë shumatorë e përfitimeve të mesiperme. Përcaktimi i pikeve të varianteve sipas “kriterit të fizibilitetit ekonomik” realizohet në baze të analizës së tyre çësore dhe sasiore në baze të analizës sic tregohet në tabelën 16. Pengesa në furnizim ndodhin kur të gjithë transaksionet e tregut, të cilat nuk janë të mundura ose nuk lejohen të kryhen si pasoje e mbingarkimit të rrjetit si në aspektin kombëtar ashtu edhe në atë rajonal sic ndodh në disa raste në Zonat Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce. Kostot e pengesave të furnizimit llogariten në varesi të

metodes se aplikuar te trajtimit te pengesave. Investimet e transmetimit mund te ulin kostot e pengesave dhe pra duke krijuar nje treg me efficient te energjise elektrike. Analiza sipas ketij kriteri tregon se varianti III ka piket me te vogla meqenese gjatesia e tij eshte me e madhe se e dy varianteve te tjera.

Tabela 16 – kriteri 7.: Fizibiliteti Ekonomik me ndertimin e disa segmenteve dhe zevendesimit e disa te tjerave per Linjen 110 kV si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve perkates				
Nen-kriter	Shume e larte	E larte	Normal	Fare
Piket e kriterit	100	75	50	0
Piket per Variantin e Pare	100			
Piket per Variantin e Trete	85			
Piket per Variantin e Dyte	90			

6.2.11 Skanimi i Projektit me ndertimin e disa segmenteve dhe zevendesimit e disa te tjerave per Linjen 110 kV si dhe ndertimi/fuqizimi/zgjerimi i Nenstacioneve perkates

Kriteret dhe metodologjia e planifikimit te sistemit te transmetimit per prioritizimin e projektit jane bazuar ne qellimin e mbeshtjetjes se tregut elektrik te ardhshem ne Shqiperi ne pergjithesi dhe ne perspektivat e zhvillimit rajonal ne vecanti, sic eshte rasti i zonat Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce. Ne tabelen 17 jane dhene piket sipas secilit nenkriter si dhe totale per te tre variantet.

Tabela 17.: Piket sipas secilit nenkriter si dhe totale per te tre variantet

Nr	Kriteri	Piket	Varianti I (linja e verdhe ne harte)	Varianti III (linja e kuqe ne harte)	Varianti II (linja blu ne harte)
1	Urgjencia ne lidhje me nevojen e menjehershe per realizimin e projektit	10.00	10.00	10.00	10.00
2	Perfitimet Teknike per rritjen e Besueshmerise se Sigurise se furnizimit me energji per te gjithë llojet e konsumatoreve ne kete rajon	10.00	5.00	10.00	7.50
3	Perfitimet Teknike per Reduktimin e Humbjeve Teknike ne Rrjetet e Transmetimit	10.00	10.00	9.38	8.75
4	Ndikimi Mjedisore nga Ndertimit i Projektit te Transmetimit	25.00	6.25	22.50	20.00
5	Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Centralat e reja te Prodhimit	10.00	10.00	7.78	5.56
6	Rritja e Kapacitetit te Transmetimit per te mbeshtetur Zhvillimet ne Sistemin e Shperndarjes	15.00	12.00	15.00	7.50
7	Fizibiliteti Ekonomik i Projektit te Transmetimit	20.00	20.00	17.00	18.00
	Totali	100.00	73.25	91.65	77.31

6.3 Pershkrimi i korridorit te Linjes

Objektivat e projektit te propozuar jane (i) permiresimi i Standarteve te pergjithshme, qendrueshmerise, cilesise dhe eficences se sistemit te transmetimit ne pjesen juglindore te Shqiperise; (ii) reduktimi i nivelit shume te larte te humbjeve teknike ne pjesen juglindore te rrjetit te transmetimit 110 kV; (iii) reduktimi i energjise te mosfurnizuar, (iv)permiresimin e nivelit te tensionit ne rajon; dhe (iv) krjimi i mundesise per lidhje me rrjetin e transmetimit per hidrocentralat qe do te ndertohen ne te ardhmen. Ndertimi nenstacionit 400/110 kV te Zemblakut dhe Linjes 110 kV Zemblak–Korce-Erseke-Permet-Kelcyre-Memaliaj, zgjidh perfundimisht problemin e furnizimit me energji elektrike te pjeses Jug-Lindore dhe konfigurimi i ri i rrjetit krijon mundesine zhvillimit te rrjetit 110kV ne te ardhmen dhe lidhjen e tij ne nje unaze ne Shqiperine Jugore, me qellim uljen e humbjeve teknike ne rrjetin e transmetimit dhe permiresimin e furnizimit me energji elektrike. Per zgjerimin e ketyre nenstacioneve nuk kerkohej toke shtese.

Korridor i linjes do te jete ne korridorin ekzistues ne baze te kritereve te meposhtme:

- Zonat me numer te madh popullsie duhet te shmangen sa me shume te jete e mundur
- Line spans (afrimi dhe varja e telave) siper shtepive te banuara duhet te perjashtohet
- Burimet natyrore duhet te shmangen
- Kalimi i luginave duhet te vendoset ne pozicione te pershtatshme
- Vemendje e vecante duhet t'i kushtohet aspekteve kryesore mjedisore
- Te sigurohet aksesimi tek vendndodhjet e shtyllave vecanerisht ne pikat kendore me qellim qe te lejoje transportimin izolatoreve, percjellsave dhe pajisjeve shternguese te tyre.
- Akses ne te ardhmen per qellime mirembajtje gjate operimit te parashikuar
- Ndikimi ne veprimtarit ndertimore per pronat dhe duhet te konsiderohnt kostot respektive.
- Vemendje e vecante duhet t'i kushtohet gjithashtu rrezikut te erozionit dhe veprimtarive te shembjes ne zonat malore.

Gjithashtu ne figuren 40-41 eshte treguar lidhja e korridorit te linjes me infrastrukturen ekzistuese te sheshit te ndertimit me rrugen nacionale, linjat e tensionit te larte dhe veprat e tjera. Linja e re 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak kalon neper nje zone heterogjene, e cila me qellim te dokumentit ne fjale ndahet ne kater zona me karakteristika homogjene dhe pershkrimi i tyre eshte dhene ne seksionet ne vijim.

6.4 Shtrirja e linjes midis Memaliaj dhe Kelcyres

Linja egzistuese 110 kV me qark te nje fishte shtrihet pergjate lumit VJOSA. Gjeresia e lugines eshte e mjaftueshme per rrugen dhe per shtrirjen e linjes. Linja egzistuese duhet te zevendesohet nga shtylla te reja 110 kV me qark te nje fishte te projektuara per nje madhesi te rritur te percjellesit. Pikat e kendeve duhet te lihen ashtu sic jane, shtyllat pezull mund te zhvendosen pergjate shtrirjes se linjes per te optimizuar gjatesine dhe numrin e shtyllave.

6.5 Shtrirja e linjes midis Kelcyres dhe Permetit

Linja egzistuese 110 kV me qark te nje fishte shtrihet pergjate lumit VJOSA. Lugina eshte e gjere ne kete pjese dhe me terren pak kondrinor. Linja kalon pergjate rruges ne anen e lugines dhe eshte pothuajse vetem drejt. Linja egzistuese duhet te zevendesohet me shtylla te reja 110 kV me qark te nje fishte te projektuara per madhesine e rritur te percjellesit. Pikat e kendeve duhet te lihen ashtu sic jane, shtyllat pezull mund te zhvendosen pergjate shtrirjes se linjes per te optimizuar gjatesine, varjen e percjellsave dhe numrin e shtyllave.

6.6 Shtrirja e linjes midis Permetit dhe Ersekjes

Linja pasi del nga nenstacioni i Permetit, le nenstacionin ne te majte te saj dhe gati vazhdon nenstacionin e saj paralel me majen ne kuoten 285m, njekohesisht duke ecur paralel me lumin e Vjoses. Ky koridor vazhdon gjate gjithë rruges dhe lumit Vjose, duke u vendosur ne anen tjetër te lumit me qellim baze qe te mos preke asgje nga pasurite, shtepite, tokat, pemisitet e shtetasve ne fshatrat Lurse, Leshice, Badelonje.

Ne segmentin ndermjet shtyllave 36 linja do te kaloje ngjitur me rrugen kombetare dhe nepermjet shtyllave 35 dhe 34 behet i mundur kapercimi i lumit Vjose ne kuoten 430-440 metra. Me tej linja vazhdon ne te majte te lumit Vjose dhe ne cep te rruges rreth 600-1000 larg fshatit Petran vendosen shtyllat 32, 33, 34.

Me pas linja kalon ne anen tjetër te lumit Vjosa, ngjitur me rrugen kombetare dhe gjithmone ne fund te bankines se shtratit te lumit (me qellim qe te mos krijohet erozion dhe ndotje ne te). Eshte

shume e rendesishme te theksojme se gjate gjithë zones qe perfshin shtyllat 39, 31, zona eshte zharomshte dhe pothuajse pa bimesi dhe drure. Linja nga kuota 450, vazhdon te ngjitet gjithmone ne krahu e djathte te rrjedhes se lumit Vjosa, gati ngjitur me rrugen derisa arrin ne majen e kodres me kupten 504 metra shtylla 927, qe ndodhet prane ures se Vazishtes. Nga kjo kuote linja vazhdon poshte ne zallin e lumit Vjose duke e kapercyer permes nje pylli te vogel dhe ndermjet shtyllave 26 dhe 25 dhe arrin ne anen tjeter te lumit me kuote rreth 455 metra.

Perseri per te mos ngacmuar fushat, ne segmentin ndermjet shtyllave 25-24 linja kalon ne anen tjeter te lumit. Prane fshatit Dracove linja kalon ne anen e majte te lumit, dhe shtylla 23 vendoset mbi kthesen e lumit Vjosa ne fund te fshatit Dracove.

Shtylla 22 eshte vendosur ne te djathte te lumit dhe lidhet me shtyllen 21 e cila eshte vendosur ne buze te rruges kombetare ne kuoten 521m. Prane Majes Melesinit rruga kryen nje kthese te forte qe e ndjek njekohsisht dhe linja neper shtylla 20-19-18-17-16. Gjate gjithë segmenteve te siperpermendura koridori i linjes nuk prek asnje pyll derisa afrohet prane qytetit te Leskovikut duke qendruar gjithmone prapa kodrave per te minimizuar impaktin visual. Prej Leskovikut linja ngjitet drejt Bregut te Mashrave ne kuoten 1020 metra, me tej kalon perroin e Carcoves ne derdhje te lumit Vjose derisa arrin tek shtylla 11 qe gjithashtu vendoset buze rruges nacionale. Linja vazhdon te rritet ne lartesi deri ne kuoten 1282metra ne Majen e Cukes. Me tej linja zbrit drejt fshatit Germenj deri ne kuoten 1201 metra. Nga shtylla 9 deri ne shtyllen 8 linja kalon nepermjet nje pylli mesatar derisa arrin ne kuoten e Majes se Shendelliut.

Me pas linja kalon gropat e thella te fshatit dhe arrin ne shtyllen 6 prane fshatit Barmsh. Nga Barmashi linja afrohet ngjitur me rrugen kombetare deri ne kthesen e rruges te fshatit Kogjinas. Nga kjo pike linja vazhdon parallel me rrugen kombetare dhe shtylla 4 dhe 3 vendosen ne buze te rruges derisa arrin prane fshatit Borave. Me pas linja vazhdon mbrapa fshatit Taci i Poshtem, arrin ne rrugen lokale te fshatit Kodras dhe prej andej futet ne nenstacionin e Ersekës.

6.7 Shtirirja e linjes midis Ersekës dhe Korcës

Linja del nga nenstacioni i Ersekës me shtyllen 14 dhe vazhdon parallel gjate gjithë segmentit 14-13-12 duke kaluar prane vendit te quajtur Maja e Rezervuarit, Kodrat e Selenices duke arritur ne Majen e Gorricës te Qinanit.

Ne te gjithë kete korridor kemi bimesi te rralle dhe shumica e kodrave jane te zhveshura. Prane fshatit Mollas linja kalon ne nje pyll mesatar 800 metra dhe shtylla te parashikuara te vendoset ne fundin e pyllit. Me pas linja vazhdon parallel me Perroin e Konopishtit per te arritur mbrapa fshatit Kamenice dhe shtylla do te vendoset prane rruges nacionale.

Me pas linja vazhdon korridorin e saj neper kodrat e fshatit Pepellash derisa arrin ne vendin e quajtur Maja e Gurit e Dervenit. Linja takon perseri Perroin e Kanafishtit ngjitet ne majen e Shtances duke vazhduar parallel dhe ngjitur me rrugen kombetare. Erseke-Korce. Prane fshatit Mollaj ajo le rrugen kombetare duke kaluar mbrapa fshatit Qatrom duke arritur ne nenstacionin e Korcës.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PER ZEVENDESIMIN E LINJES SE VJETER ME LINJE TE RE 110 kV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET DHE ZGJERIMI I NENSTACIONEVE ELEKTRIK TE MEMALIAJT, KELCYRES DHE PERMETIT



Figura 40/1.: Planimetria e korridorit se linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PËR ZEVENDESIMIN E LINJES SE VJETER ME LINJE TE RE 110 kV MEMALIAJ-KELCYRE-PERMET DHE ZGJERIMI I NENSTACIONEVE ELEKTRIK TE MEMALIAJT, KELCYRES DHE PERMETIT




Figura 40/1.: Planimetria e korridorit se linjes 110 kV Permet-Erseke

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 40/2.: Planimetria e korridorit se linjes 110 kV Erseke-Korce

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/L.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Memaliaj-Keqyre (hartar pare)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/2.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Kelcyre - Permet (hartat e pare)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMITT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/3.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Permet-Erseke (hartarë)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/4.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Permet-Erseke (hartar dyte)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/5.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Permet-Erseke (hartat trete)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/6.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Erseke-Korce (harta pare)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/7.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Erseke-Korce (hartu dyte)

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 41/8.: Planimetria e vendosjes se linjes 110 kV Erseke-Korce (harta trete)

Nenstacioni ne Memaliaj

Perballe nenstacionit te Memaliaj gjendet nje portal egzistues dhe nje shtylle fundore me nje qark. Shtylla fundore duhet te zevendesohet nga nje shtylle e re e projektuar per madhesine e rritur te percjellesit. Portali mund te perdoret per linjen e re ne gjendjen aktuale qe eshte.

Nenstacioni i Kelcyres

Perballe nenstacionit te Kelcyres (figura 42) gjendet nje portal egzistues per dy dalje OHL dhe nje shtylle fundore per dy qarqe (nje hyres dhe nje dales). Shtylla fundore duhet te zevendesohet me nje shtylle te re te projektuar per nje madhesi te rritur te percjellesit. Portali mund te perdoret per linjen e re ne gjendjen aktuale qe eshte.




Figura 42: Zgjerimi i Nenstacionit te Memaliajt

Nenstacioni ne Permet

Nenstacioni ne Permet (figura 43) eshte nje pike fundore e linjes egzistuese 110 kV Memaliaj-Permet. Ne te gjendet nje portal egzistues per dy dalje OHL dhe nje shtylle fundore per dy qarqe, njeri hyres dhe njeri dales (te cilat nuk jane instaluar deri tani). Shtylla fundore duhet te zevendesohet me nje shtylle te re te projektuar per madhesine e rritur te percjellesit. Portali mund te perdoret per linje te re ne gjendjen aktuale qe eshte.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 43: Zgjerimi i Nenstacionit te Permetit

Nenstacioni i Permetit perbehet nga nje transformator i vetem 110/6 kV, 5.5 MVA i cili lidhet me linjen nga Kelcyra. Asnje nga lidhjet 110 kV nuk perbehet nga nje celes, por vetem nga celesa te izoluar. Nderkohe qe do te instalohet nje linje e re per ne Erseke pergjate nje distance prej rreth 32 km, linja egzistuese drejt nenstacionit te Kelcyres duhet te zevendesohet nga nje linje e re dhe duhet te instalohen fiderat per cdo linje.

Hapesira per vendosjen e celesave eshte relativisht e vogel. Eshte propozuar qe te zhvendoset gardhi egzistues ne drejtim te shtylles me fundore per rreth 3 metra ne menyre qe te perfthohet nje hapësirë e mjaftueshme per pajisjen e re HV. Ne te njejten kohe, mund te konsiderohet edhe nje vendosje vertikale e thikes se linjes dhe instalimi i nje “version kompakt” special i “pajisjeve konvencionale te jashtme” (CB/isolator/CT).

Dhoma e kontrollit nuk ka madhesine e duhur per te vendosur panelet e nevojshem te mbrojtjes, kontrollit/SCADA dhe tele-komunikacionit. Bateria egzistues nuk eshte e afte te mbuloje kerkesen e tre seksionueseve te plote dhe duhet te rritet se bashku me panelet e shperndarjes AC/DC.

Ndertesa egzistuese eshte shume e vogel per te vendosur pajisjet e reja sekondare ne menyren e duhur. Per kete arsye, eshte propozuar qe te zgjerohet ndertesa egzistuese ne drejtim te vendit te parkimit. Ne varesi te buxhetit mund te zbatohen versione te ndryshme. Si fillim, eshte propozuar te instalohen dy pajisje te reja te nevojshme OHL dhe per te zgjeruar seksionet e transformatoreve egzistues me ane te nje celesi. Percjellesi i zbares duhet te zevendesohet.

Punimet e nevojshme ne linjen e re Kerçyre-Permet do te kerkojne qe te nderpritet energjia elektrike ne linjen egzistuese, dhe te instalohet e te komisionohet linja e re sebashku me fiderat e rinj te linjes ne te dy nenstacionet e lidhura te Kelcyres dhe te Permetit. Pritet qe kjo gje do te kerkoje nje periudhe kohe te konsiderueshme, pra, duhet te sigurohet se Permeti do te furnizohet nga fundi tjetër ne te njejten kohe. Permeti eshte aktualisht nje stacion fundor, per kete arsye, kjo

gje mund te arrihet vetem pas nje lidhje te re te Permetit me Erseken, i cili eshte planifikuar ne te njejtin projekt, eshte perfunduar. Keto fakte do te kerkojne planifikim te kujdesshem te punimeve ne total.

Nenstacioni ekzistues 110/35/10 kV i Ersekës

Nenstacioni i Ersekës (figura 44) eshte me i vjeter se 25 vjet. Ai perbehet vetem nga nje trasformator 110/ 35/ 10 kV, 5.6 MVA, i cili lidhet vetem me linjen qe vjen nga Korca. Asnje nga lidhjet 110 kV nuk eshte bere me ane te celesave automatik, por vetem me ane te celesave te izoluar. Nje linje e re OHL do te instalohet per tu lidhur me Permetin ne nje distance rreth 32 km dhe per kete arsye fiderat respektive te linjes – drejt Permetit dhe drejt Korces duhet te instalohen. Hapesira ne nenstacionin ekzistues eshte e mjaftueshme per te instaluar dy fidera te plote linje. Pervet kesaj, hapesira e disponueshme do te ishte e mjaftueshme per te instaluar nje seksionues te plote te trete per fiderin e transformatorit.

Dhoma e kontrollit ka madhesine e duhet per te vendosur panelet e nevojshme te mbrojtjes, kontrollit/SCADA dhe tele-komunikacionit. Bateria egzistuese nuk eshte e afte te perballoje kerkesat e tre seksionuesve dhe duhet te rritet sebashku me te gjithë panelet e vjeter te shperndarjes AC/DC. Keto dosmosdoshmeri do te kerkojne me siguri nje rinovim dhe rimodelim te brendshem te ndertesës se nenstacionit. Ne varesi te buxhetit mund te zbatohen alternative te ndryshme.

Si fillim eshte propozuar te instalohen dy seksionues te rinj OHL dhe te zgjerohet seksionuesi egzistues i transformatorit me ane te nje celesi automatik. Per me terper, eshte e nevojshme zevendesimi i nje thike egzistuese me nje celes automatik. Themelet e gantries (seksionuesit) te nje zbare duhet te riparohen dhe struktura e celikut duhet te lyhet me boje per mbrojtje nga dryshku.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 44: Zgjerimi i Nenstacionit te Ersekës

Nenstacioni Egzistues 110/20 kV S/S i Korces

Nenstacioni 110/20 kV i Korces (figura 45) perbehet vetem nga nje zbare e vetme me tre fidera te pajisur plotesisht – ne drejtim te Ersekës, Pogradecit dhe Zemblak. Per me teper, jane instaluar dy fidera transformatori te pajisur plotesisht me dy transformator 110/20 kV, 45 MVA secili. Nenstacioni eshte rehabilituar midis periudhes kohore 2000 dhe 2002. Per lidhjen e zevendesuar te linjes drejt Ersekës nuk do te jete e nevojshme nje seksionues i ri linje. Linja drejt Zemblakut nje linje me qark te dyfishte prej te cileve vetem nje qark perdoret. Ne kete projekt qarku i dyte drejt Zemblakut duhet te lidhet gjithashtu dhe duhet te instalohet nje seksionues fideri i ri linje me SF6-CB. Pra, nje gantri (seksionues) i ri eshte i nevojshem per te lidhur nga shtylla fundore, i cili eshte i vendosur direkt jashte kufijve te nenstacionit. Per kete qellim, qarku i pare egzistues i ri i Zemblakut duhet te zhvendoset dhe te ri-lidhet me seksionuesin e ri, ndersa qarku i dyte i linjes do te lidhet me seksionuesin egzistues. Fideri i ri i linjes ze Zemblakut do te instalohet midis seksionuesit egzistues te Zemblak I dhe seksionuesit te Pogradecit.

Hapesirat ne vendosjes se celesave dhe ne ndertesën e centralit jane te mjaftueshme per te vendosur fiderin e ri 110 kV me te gjitha pajisjet e nevojshme te kontrollit, mbrojtjes dhe telekomunikacionit. Nuk eshte indentifikuar ndonje problem specifik. Ne dhomen e kontrollit, do te vendoset nje radhe e re panelesh kontrolli/mbrojtje gjate kanalit kabllor pas sistemimit egzistuese. Ne kete kontekst sygjerohet te zhvendoset paneli egzistues i telekomunikacionit (i vendosur neq) tek radha e re.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 45: Zgjerimi i Nenstacionit te Korces

Nenstacioni Egzistues 400 kV S/S i Zemblakut

Nenstacioni 110 kV i Zemblakut (figura 46) eshte sistemuar ne nje skeme me zbara te dyfishta me nje seksionues transformatori dhe ne seksionues per linjen e Korces. Lidhja e qarkut te dyte me linjen e Korces dhe transformatorin e ri 400/110 kV, 150 MVA (te instaluar me pare) do te vendoset ne anen e majte te pjeses egzistuese ne te njejtin sistemim (vendosje) si per instalimin e pare. Sistemi i ri me qark te dyfishte te OHL 110 kV ne fundin e Zemblakut ka nje shtylle fundore direkt jashte kufirit te nenstacionit. Hapesira e planifikuar per zgjerimin eshte e mjaftueshme dhe e disponueshme ne vendin e vendosjeve te celesave.

Dhoma lokale egzistuese e kontrollit duhet te zgjerohet ne drejtim te vendit ku jane vendosur transformoret shtese. Do te jete fare e lehte te zhvendosen keto dy transformatore per te mundesuar zgjerimin e kerkuar te dhomes locale te kontrollit/mbrojtjes. Per lidhjen e te dyte 400/110 kV, 150 MVA me vendin egzistues te vendosjes se celesave te 400 kV ka nje vend reserve, por mund te perdoret nje seksion i ri. Pajisjet e mbrojtjes dhe te kontrollit duhet te merren nga kompania ABB ne menyre qe te perputhen ne menyre profesionale me situaten egzistuese.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 46: Zgjerimi i Nenstacionit te Zemblakut



Foto: Zona e Permetit



Foto: Zona e Permetit



Foto: Zona e Ersekës



Foto: Zona e Ersekës

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT



Foto: Zona e Korces



Foto: Zona e Korces



Foto: Zona e Zemlakut



Foto: Zona e Korces



Foto: Zona e Zemlakut



Foto: Zona e Zemlakut

Qellimi i vizitave ne vendndodhje gjate hartimit te kesaj VNM ishte qe te gjendet nje rruge paraprake per linjen me qellimte behej nje investigim me te detajuar qe se bashku me grupin inxhinjrik te zgjidhej korridori me ndikim minimal ne mjedis, larg zonave turistike dhe njekohesisht linja te ndertohej me koston minimale te mundshme. Linja sic u theksua edhe me siper eshte shtrire ne baze te kritereve te meposhtme:

- Zonat me numer te madh popullsie duhet te shmangen sa me shume te jete e mundur
- Varja e linjes siper shtepive te banuara duhet te perjashtohen
- Rezervuaret natyrore duhet te shmangen
- Kalimi i luginave duhet te vendoset ne pozicione te pershtatshme
- Vemendje e vecante duhet ti kushtohet aspekteve kryesore mjedisore

- Te sigurohet aksesimi tek vendndodhjet e shtyllave vecanerisht ne pikat kendore me qellim qe te lejoje trasportimin e percjellseve, trosit dhe izolatoreve si komponentet kryesor te linjes.
- Akses ne te ardhmen per qellime te mirembajtjes gjate operimit te parashikuar
- Ndikimi ne veprimtarite ndertimore per pronat dhe duhet te konsiderohen kostot respektive.
- Vemendje e vecante duhet t'i kushtohet gjithashtu rrezikut te erozionit dhe veprimtarive te shembjes ne zonat malore.

Nje sere veprash inxhinjrike do te ndertohen ne funksion te linjes 110 kV te Juglindjes se bashku me fuqizimin e nenstacioneve survejimi topografik i detajuar ne korridorin ku do te kaloje linja; pergatitja e korridorit te linjes; pergatitja e kantjerit; ndertimi i bazamenteve te kullave; instalimi i kullave; instalimi i percuesve; instalimi i izolatoreve; dalje linje 110 kV; dalje transformatori 110 kV, testimi dhe komisionimi i saj. Projekti eshte realizuar ne menyre te tille qe ne te gjitha rastet e mundshme te minimizoje impaktin vizual meqenese jemi ne zonen me potencial me te larte te turizimit ne vendin tone.

7. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE NGA NDERTIMI I LINJES 110 kV DHE NENSTACIONEVE PERKATESE

Ne kete seksion eshte dhene ne fillim nje permbledhje e kushteve te mjedisit dhe masat qe do te merren per mbrojtjen e tij ne pergjithesi, ndersa ne seksionet e tjera jane trajtuar ne detaje te gjitha analizat perkatese te ndikimit ne mjedis se bashku me masat perkatese te parandalimit te tyre.

7.0 Kushtet per mjedisin

- 1-Te menjanohen demet mjedisore.
 - 2-Aty ku demet jane te pashmangshme, te paguhen.
 - 3-Gjithe mbeturinat e mbetura nga punimet, te largohen dhe vendi te lihet i paster.
 - 4-Mbetjet te trajtohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
 - 5-Mjetet te levizin vetem ne rruge qe te mosdemtohet vegjetacioni.
 - 6-Vijat dhe rrepirat qe do te prishen gjate ndertimit te linjes, demtimet ne kanale, tarraca dhe rruge ose ne tipare te tjera te tokes, do te kthehen ne pamjen fillestare.
- Gjithje shtyllat do te paisen me mbajtjes OPGW ne maj

Tabelat e rrezikut

Do te jene me simbole te kuqe ne nje sfond te bardhe . Ajo do te paraqese nje kafke me kocka te kryqezuara dhe poshte do te shkruhet me shkronja te medha: “Rrezik vdekje”

Numri i shtylles

Do te jete nje tabele e bardhe me numra te zinj. Lartesia do te jete 3m nga toka.

Mekanizmi kunder ngjitjes

Do te jete ne formen e kunjës ose te telit me gjemba

Mbrojtja e zogjve.

Elementet e shtylles qe jane mbi izolator do te paisen me shirita çeliku te vena horizontalisht pertej zones se mbrojtur per uljen e zogjve.

Analizat e tokes

- 1-Gjendja e siperfaqes dhe prirja e tokes ne zonen rreth bazamenteve.
 - 2-Prirja per plasje dhe çarje ne zonen e bazamentit dhe gjykimi mbi stabilitetin ne pergjithesi.
 - 3-Prirja per rreshkitje ne te ardhmen e tokes rreth bazamenteve te shtyllave.
 - 4-Permbytjet e mundshme ose shpelarjet gjate shirave te rrembyeshem.
 - 6- Te dhena rreth nivelit te ujrave nentokesore per çdo shtylle.
- Gropat per testet do te jene mbi 3m te thella.
Ne shkembinj shpimet do te jene ne thellesi 6m.
Ne tokat shume te buta, shpimet do te jene me shume se 12m.
-Bazamentet do te jene me pjerresi qe te pengojne pranine e ujrave afer trupit te shtylles.

Percjellesit

Percjellesit do te jene te pershtatshem per sherbim ne kushte te veçanta. Do te llogariten te jene ne kushte normale perkulje dhe tensioni ne temperature 0c⁰-60c⁰. Teli i OPGW do te jete Y^cACS(tel çeliku i veshur me alumin). Ndertimi i OPGW do te jete i pershtatshem per 48 fibra optike.OPGW do te jete ne nje tub i cili futet brenda shtresave te percjellesit. Secila fiber optike ose grup fibrash do te jene tuba mbrojtës. Secila fiber do te kete ngjyren e vet per te dalluar. Jashte do te jete i mbeshtjelle me mbulesë kunder ujit.

Kurora e linjes

Per te mbajtur nivel te ulet te efektit te kurores dhe interference te ulet tek radiot, dizenjimi i gjithe pjeseve tek percjellesit dhe izolaret do te shmange kendet e mprehta te cilat do te prodhonin intensitet te te larte te fushes elektrike. Gjithe paisjet e linjes, sipas projektit, do te kene permasa qe te perballojne difektet e fazes se vetme dhe secili izolator do te perballoje nje qark te shkurtër deri ne temperatura qe arrijne 200⁰c, pa ngjitje midis pjeseve perberese.

Percjellesat

Percjellesat do te jene aliazh alumini qe do te durojne temperatura deri ne 80⁰c.

OPGW

Grupi i OPGW do te perputhet ne montim me ndertimin e shtyllave si edhe me paisjet ne nenstacion .Teli tokesor qe do te lidhet me shtyllat do te duroje difektet e rrymes nje fazore.

Izolaret

Do te jene per OHL 1000V, qeramik ose qelq me prova per interferencen ne radio, si edhe per ndotje. Do te plotesojne standartet: IEC 60437, EC 60507.

Paisjet per shuarjen e zhurmave

Paisjet e shuarjes se zhurmave do te jene te tipit Stockbridge. Do te vendosen ne te gjithe percjellesit, varesit e OPGW dhe do te montohen ne shufrat e armuara.

Minimumi dy shuares zhurmash do te parashikohen per çdo hapësire me qellim qe niveli i zhurmave te jete disa here me i vogel se vlerat e lejuara pergjate gjithe korridorit te linjes dhe lidhjes se saje me seksionuesit e nenstacioneve perkatese.

Materialet jo metalike

Materialet e tjera jometalike qe do te perdoren do te kene nje rezistence midis 20⁰c dhe 45⁰c, pa ndryshuar karakteristikat kryesore.

Kujdes duhet patur gjate:

- Ne vendet me trafik, percjellesit do te jene ne lartesine jo me pak se 6 m.

-Gjate momentit te lidhjes se se percjellesit njerezit duhen mbajtur larg.
-100m ne te dy anet e vendit te ngritjes, skuadra pergjegjese e montimit, duhet te vendose punetore me flamuj te kuq te parandaloje apo te ndaloje transportin kur eshte e domosdoshme.

Vendet e punes do te shenohen me shenjen “Ketu punohet”

Montimi i percjellesave nuk do te behet ne kohe me mjegull, me pamje te ulet, ne mot me akull ose ere me shpejtesi me te madhe se 10m/sek.

Gjithe ndertimet per akomodimin e e punonjesve do te ngrihen me lejen e pushtetit lokal dhe me lejet perkatese per furnizimin me uje , sanitare dhe kerkesa te tjera.

Pastrimi i vegjetacionit

Do te jete 10 m nga qendra e linjes behet pastrimi i linjes kur eshte lartesia e madhe e drureve. Druret duhet te lihen ne nje lartesi jo me shume se 0,5m mbi nivelin e tokes dhe mos te hiqen me buldozer. Nese ka drure te larta jashte zones se pastruar, keto duhen shkurtuar qe te jene 2m poshte lartesis se percjellesve. Rrenjet dhe bimet e tjera nuk do te levizen per ta mbrojtur nga erozioni.

Do te levizet vetem ne rruge per te shmangur prishjen e vegjetacionit.
Eshte e ndaluar rreptesisht djegia e bimeve ne zone.

Masat kunder erozionit.

-Do te ndertohen drenaxhe atje ku ato jane te domosdoshme;
-Ne vendet e rrezikuara nga rreshqitjet, do te ngrihen mure guri pa llaç.
-Bazamenti i shtyllave duhet te kete pjerresine e duhur per te shmangur rreshqitjet.
-Aty ku jane te domosdoshme, do te ndertohen mure mbrojtese betoni.

Rrenjet e drureve dhe te bimeve, nuk do te levizen.

Ç’do demtim i bere ne vegjetacion do te demshperblehet.

Rruget ndihmese do te jene sa me afer shtyllave dhe duke patur drejtimin poshte platformave ne ate menyre qe te pakesojne erozionin.

Rruget ndihmese ne forme gishti do te jene me te preferuarat se rruget e vazhdueshme pergjate linjes.

Trajtimi i mbetjeve

Kamionet me mallra qe transportohen, do te mbulohen per te shmangur shkarkimet e pavullnetshme dhe do te pastrohet çdo mbeturine e derdhur.

Do te ndalohet transportimi i mallrave me kamione me te vjeter se 15 vjet.

Masa te tjera te domosdoshme per tu marre gjate ndertimit te linjes per mbrojtjen e ambjentit.

Gjithe materialet qe do te perdoren per ndertimin e linjes do te jene te reja dhe te cilesive qe do tu pershtaten ndryshimit te temperaturave, presionit.

Materialet e perdorura do te jene te sigurta nga gerryerjet.

Nuk do te perdoret asbesti ose materiale qe permbajne asbest, i cili shkakton probleme te renda shendetesore.

Nuk lejohet perdorimi i zhives ose vajrave qe permbajne PCB ne te gjithe operacionet e ndertimit te linjes dhe te fuqizimit te nenstacioneve.

Kujdes ne ndertimin e linjes.

- 1-Jane shmangur zonat e populluara sa me shume ka qene e mundur.
- 2-Jane perjashtuar shtepite poshte linjes.
- 3-Rezervuaret natyrore jane shmangur.
- 4-Eshte menjanuar vendosja e shtyllave ne lartesi me te madhe se 1200m.
- 5-Do te tregohet kujdes per çdo aspekt ambjental.
- 6-Do te merret parasysh aktiviteti i ndertimit ne pronat dhe kostot qe do te kene.
- 7-Do te tregohet kujdes dhe do te paguhet per çdo dem qe mund te shkaktohet nga erozioni dhe deme te tjera te shkaktuara nga punimet per ndertimin e linjes.
Ne procesin e ndertimit do te shmanget prishja e shtepive.
- 8-Do te merret leje nga pronaret e tokes per çdo aktivitet qe eshte i domosdoshem.
- 9-Pas punimeve te levizin gjithë mbeturinat nga materjalet dhe nga punimet dhe te lihet vendi i paster.

7.1 Biodiversiteti, plani i zhvillimit të zones dhe projekti ne raport me to

Edhe pse një vend i vogël, vendi yne ne pergjithesi dhe sidomos zona e projektit ne vecanti shquhet për një diversitet biologjik e pejsazhtë pasur. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Relievi i thyer dhe vertikaliteti i theksuar kanë krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri llojesh relikte, endemikë e subendemikë; 27 llojet endemike dhe 160 subendemike të bimëve të larta që rriten në vendin tonë paraqesin një rëndësi të veçantë ruajtjeje.

Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve te zones ne te cilen do te ndertohet linja, ofron një larmi të pasur llojesh bimore e shtazore. Zhvillimi ekonomik i këtyre 50 viteve të fundit, bazuar në zhvillimin e bujqësisë, industrisë, pylltarisë, peshkimit, urbanizmit, transportit e turizmit malor ka patur efekte të forta në diversitetin biologjik e pejsazhor në zonen ku do te ndertohet projekti. Pasojat dhe dëmet kryesore të këtij aktiviteti do të përmblihdeshin si më poshtë:

- ◆ humbje dhe copëzim të habitateve;
- ◆ dëmtim, varfërim dhe degradim të ekosistemeve dhe habitateve;
- ◆ shqetësim, persekutim i kafshëve të egra në natyrë;
- ◆ zhdukje llojesh apo kërcënim për zhdukje;
- ◆ prishje dhe erozion gjenetik;

Qarku i Gjirokastrës i cili perfshin Memalijn, Tepelenen, Kelcyren dhe Permetin (dmth pjesen e pare te korridorit te Linjes) është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 2.884 km². Qarku i Gjirokastrës i përfshin rrethin e Gjirokastrës, rrethin e Përmetit dhe rrethin e Tepelenës. Kodi i Gjirokastrës eshte Code-ISO 3166-2 është AL-05. Qarku i Gjirokastrës kufizohet në veri me Qarkun e Beratit, në veriperëndim me Qarkun e Fierit, në jug deri në perëndim me Qarkun e Vlorës, në juglindje me Greqinë dhe në lindje me Qarkun e Korçës. Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi prej 103.690 banorë. Në Qarkun e Gjirokastrës rrjedh lumi Vjosa dhe në jug te ketij Qarku lumi tjetër Drino i cili me pas derdhet ne Vjose prane Memaliajt.

Qarku i Korçës i cili perfshin Erseken, Korcen dhe Zemlakun (dmth pjesen e dyte te korridorit te Linjes) është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 3.711 km². Qarku i Korçës i përfshin rrethin e Devollit, rrethin e Kolonjës, rrethin e Korçës dhe rrethin e Pogradecit. Qarku i

Korçës kufizohet në verilindje dhe në lindje me Maqedoninë, në jug me Greqinë, në jugperëndim me qarkun e Gjirokastrës, në perëndim me Qarkun e Beratit dhe në veriperëndim me Qarkun e Elbasanit. Qarku i Korçës ka një popullsi prej 2581008 banorë.

Nje studim shume i rendesishem per zhvillin e kesaj zones Juglindore per Qarqet e Gjirokastrës dhe te Korces eshte realizuar nga UNDP (Programi Zhvillimor i Kombeve te Bashkuara). Ky studim perfshin nen-projekte te financuar pjesërisht nga qeveria shqiptare dhe donatore te ndryshem për të zhvilluar infrastrukturën dhe për t'i hapur rrugën turizmit malor në keto zona me bukuri te medha. Plani synon të ngrëjë infrastrukturën rrugore të këtyre zonave, të përmirësojë rrugët dytësore dhe rurale që lidhin qendrat qytetare ne nje kohe shume te shkurter, por edhe të rehabilitojë rrjetin e kanalizimeve **dhe atë energjetik të mbarë Juglindjes dhe ne kete konteks perfshihet edhe projekti 110 kV i linjes dhe dhe ndertimin/fuqizimin e nenstacioneve perkates**. Këto projekte do te jene në infrastrukturën rrugore, energjetike, në sistemin e mbetjeve të ngurta apo të furnizimit me ujë të kësaj zone. Për një pjesë të mirë të investimeve, paratë do të dalin nga arka e shtetit, ndërsa një pjesë janë financime të përbashkëta me donatorë të ndryshëm, sic eshte edhe rasti i projektit ne fjale, qe do te financohet nga ana e KfW, te analizuar ne kete VNM.

Ndërtimi i linjës të transmetimit dhe nënstacioneve eshte pjese e “Planit te zhvillimit të Qarqeve te Gjirokastrës dhe Korces”, do të jetë një burim i përkohshëm i drejt per drejte i punësimit dhe me vone do te kete ndikim te terthorte si pasoje e hapjes se bizneseve te ndryshme dhe sidomos atyre turistike gjatë gjithë periudhës së ndërtimit si për fuqi punëtore të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Ky ndikim do të jetë pozitiv për komunitetin lokal, të cilët do të përfitojnë kryesisht në dy mënyra nga ndërtimi i linjës:

- Krijimin e drejtpërdrejtë të vendeve të punës, sidomos të punëtorëve të pakualifikuar që do të përfaqësojnë pjesën më të madhe të fuqisë punëtore të projektit dhe të cilët do të jenë nga komunat lokale.
- Përfitime indirekte për biznesin vendas, pasi kontraktuesit do të shpenzojnë para për materialet e ndërtimit dhe të shërbimeve hotelierie te turizmit malor, hapje te bizneseve te reja nga komuniteti vendor, etj.

Në mënyrë që të kryhet zbatimi i Projektit, do të nevojiten punëtorë dhe specialistë. Numri i punëtorëve do të variojë nga 150-200 për ndërtimin e linjës dhe të nënstacioneve. Nga ky numër, 5-10% do të jenë specialistë të huaj.

Si përfundim do të arrihet një shkallë punësimi e mirë në zonë.

Ndikimi mbi situatën socialo-ekonomike gjatë fazës së ndërtimit është

pozitiv

Kontraktuesi duhet të përpiqet të punësojë sa më shumë punëtori nga komunitetet lokale për të rritur më tej ndikimet pozitive të projektit.

⁸ http://sq.wikipedia.org/wiki/Qarku_i_Korces

7.2 Ndikimi mbi shtëpitë, pasuritë dhe përdorimin e tokës

Gjirokastra (qe perfshin Tepelene dhe Memalian) është një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike në Jugun e Shqipërisë. Pika e Doganore e Kakavijes, është pika kufitare me fluksin më të madh udhëtarësh dhe mallrash për në Greqi. Gjirokastra përveç te qenit qendër Administrative e rajonit, këtu kane prezencën e tyre kompanitë me te njohura prodhuese dhe tregtare te vendit si: Glina, Fresh Compani, Elka, Uji i Ftohte Tepelene, Harri Lena Grup, Ferruni, përben edhe qendrën me te madhe bankare ne jug te Shqipërisë ku kane selinë e tyre: Banka e Shqipërisë, Banka Kombetare Tregtare, Raiffaisen Bank, Pro Credit, Intesa SanPaolo Bank, Alpha Bank, Tirana Bank, NBG Bank, Emporiki Bank, UNION BANK, Banka Popullore.

Aktivitet kryesore ekonomike ne rajonin e Gjirokastres (qe perfshin Tepelene dhe Memalijan) jane Tregtia, Industria e amballazhimit te ujit dhe pijeve freskuese si Glina, Uji i Ftohte Tepelene, Uji Trebeshina, Uji Cajupi, Fresh Compani etj. Fabrikat e perpunimit te qumeshtit dhe prodhimit te djathrave dhe nenprodukteve te qumeshtit si Gjirofarma dhe Libohova. Industria e tregtimit dhe perpunimit te Drurit. Industria e prodhimit te Inerteve dhe Ndertimit. Repartet e shumta te prodhimit te veshjeve dhe kepuceve per tregjet e huaja. Industria e nxjertes dhe perpunimit te gurit per ndertim dhe atij dekorativ. Baza e ekonomisë është bujqësia, por në rajon po rritet dhe industria e përpunimit të ushqimit, duke shfrytëzuar mundësinë që jep prodhimi i frutave, perimeve dhe nenprodukteve blegtorale.

Ekonomia e qytetit të Korçës i ka themelet e saj ne zhvillimin bujqësor, por nuk mund të lihen pa përmendur bizneset e mëdha të qytetit të cilat përfshijnë kryesisht sektorin e ndërtimit civil dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, sektorin ushqimor dhe atë të shërbimeve. Edhe pse Korça ofron mundësi të mira për zhvillimin e turizmit, ngelet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim. Niveli ekonomik i qytetit aktualisht ndodhet në një rritje kostante edhe pse duhet të sigurohet akoma stabiliteti ekonomik sipas standarteve të BE-së. Turizmi ne kete qytet ka dy pika te rëndësishme e te frekuentuara shpesh nga turistet, fshatrat Voskopoje e Dardhe.

Korça është një nyje e rëndësishme për transportin shqiptar. Qyteti ndodhet 181 km larg kryeqytetit. Aksi rrugor Korçë-Tiranë është pothuajse tërësisht i rindërtuar dhe largësia kohore është rreth 3 orë. Aksi rrugor Korçë-Kapshticë (Doganë) është nga të paktat rrugë në Shqipëri që plotësojnë standartet ndërkombëtare dhe mund të përshkohet në rreth 30 min. Korça shërben edhe si pikë-lidhje me zonën Juglindore të Shqipërisë. Linjat e planifikuara të transmetimit, nënstacionet dhe infrastruktura e nevojshme kryesisht ndikojnë në zonat rurale. Për këtë arsye ne disa raste lindin konflikte me përdorimin aktual të tokës për qëllime bujqësore (fushat, livadhet, kullotat, kopshtet). Shumica e tokës të nevojshme për ndërtimin e linjave të transmetimit dhe nënstacioneve do të merret ne perdorim te perkohshem. Do të ketë ndryshime të përkohshme të tokës përgjatë korridoreve të linjës gjatë fazës së ndërtimit mundësisht duke përfshirë edhe heqjen e disa drureve. Këto zona do të përdoren për punimet e ndërtimit, magazinimin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve të ndërtimit. Pas ndërtimit ky korridor do të shndërrohet në gjendjen e tij fillestare në mënyrë që të mund të përdoret përsëri për përdorim bujqësor. Kjo nuk përfshin zonat e mbrojtjes nga fushat elektrike.

Gjatë ndërtimit do të ketë vetëm ndikime të vogla në rrugët ekzistuese (p.sh. ndryshimet e përkohshme të trafikut), por ndërprerje të trafikut nuk do të ketë. Ndërtimi/përmirësimi i rrugëve do të shkaktojë një çrregullim në punën e sistemit të kullimit i cili në fakt nuk punon si duhet për shkak të mungesës së një mirëmbajtje të rregullt. Si rezultat, komplet sistemi i drenazhimit do të përmirësohet në mënyrë që të mundësojë një punë joproblematike.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

Si përfundim mund të themi që është vlerësuar me ndjeshmëri të lartë përdorimi aktual i tokës. Madhësia e ndikimit është e ulët përderisa shumica e zonës do të kthehet në gjendjen e mëparshme përsëri. Kështu që ndikimi mbi përdorimin e tokës është vlerësuar të jetë i ulët.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmërinë e njerëzve në lidhje me përdorimin e tokës			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	vogel	vogel
I mesem	Neglizhueshem	vogel	Moderuar	Moderuar
I larte	vogel	Moderuar	madh	madh

Në mënyrë për të parandaluar shkatërrimin e tokës së punueshme linja ndjek vijën e rrugëve ekzistuese sa më shumë që të jetë e mundur. Dimensionet e tokës që do të përdoret për kalimin e linjës do të minimizohet sa më shumë të jetë e mundur. Njerëzit do të dëmshpërblehen në para për humbjen e tyre të përkohshme të të mbjellave dhe në rast të një prerje të nevojshme të pemëve frutore private. Shpronësimi i tokave ose blerja e disa tokave private për vendosjen e shtyllave, si dhe lidhjen e linjave me nënstacionet dhe rrjetin e transmetimit duhet të kryhet në përputhje me Ligjin Shqiptar No.8561, datë 22/12/1999 dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave No.127, datë 23/03/03 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 31/3/00.

7.3 Ndikimi mbi shëndetin

7.3.1 Materiale të rrezikshme dhe rreziqe të tjerë të sigurisë

Ndërtimi i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve përkatëse do të sjellin automatikisht rreziqe të sigurisë prej përdorimit jo normal të disa substancave. Këto përfshijnë kryesisht dëmtime të punonjësve, të cilëve u kërkohet të punojnë në një lartësi të caktuar mbi shtyllat e tensionit dhe shpesh në mjedise me tension të lartë. Prandaj ata mund të jenë subjekt i rënieve të rënda dhe shokut elektrik. Një ambulance do të jetë gjithmonë pranë vendit të punës për t'u shërbyer punonjësve të ne raste të aksidenteve në punë.

Nuk parashikohet të përdoren materiale të rrezikshme gjatë fazës së ndërtimit. Materiale të rrezikshme mund të jenë vajrat e ndotur me PCB në pajisje elektrike, por nga inventarizimi i tyre rezulton se në Shqipëri është mjaft i ulët probabiliteti i prezencës së PCB-ve në vajrat e transformatoreve (referuar Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotesve Organike të Qendrueshme, Dhjetor 2006), pra përdorimi i materialeve të rrezikshme në këtë projekt vlerësohet i ulët.

Zakonisht, njerëzit kanë ndjeshmëri normale (të mesme) për zonat nga kalon linja për sa lidhet me shëndetin e tyre. Madhësia e ndikimit edhe pse është dhënë mesatare, masat mbrojtëse zbatohen zakonisht nga kontraktorët e ndërtimit. Prandaj madhësia e ndikimit është paraparë të jetë e moderuar.

Madhesia e impaktit	Ndjeshmërinë e punëtorëve në lidhje me materialet e rrezikshme dhe rreziqet e tjera të sigurisë
---------------------	---

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

	Neglizhueshe	Vogel	Mesem	Larte
Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	vogel	vogel
I Mesem	Neglizhueshem	vogel	Moderuar	Moderuar
I larte	vogel	Moderuar	madh	madh

Në mënyrë që të reduktohen rreziqe të tilla të shëndetit të cilat janë të pandashme në vende të tilla pune, kontraktuesi duhet të vendosë një plan OHS, si një nevojë minimale për të qenë në linjë me rregullat kombëtare. Plus kësaj, kontraktori duhet të ketë përgjegjësinë që të sigurojë të gjitha pajisjet e sigurisë, të nevojshme për stafin e tij, si mund të jenë në raste të tilla (helmetë, doreza, çizme, etj.) dhe të realizojë trajnimet e duhura.

7.3.2 Zhurma

Për shkak të transportimit të materialeve me kamion, zhurma do të rritet në zonën e Projektit. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë emetimet e zhurmave të makinerive të përdorura gjatë ndërtimit. Në rast të një linje ajrore, ndërtimi i saj do të gjenerojë zhurma plus për shkak të përdorimit të makinave të rënda. Për sa u përket linjave ajrore, kjo nuk ka për të patur një ndikim domethënës për shkak të pajisjeve të vogla që mund të përdoren, hapësirës së limituar e nevojshme për të bërë punën në çdo shtyllë të tensionit të lartë, dhe për shkak të karakterit të shpejtë të punës për ngritjen e shtyllave të tensionit të lartë. Megjithatë, për shkak të afërsisë me rrugën kombëtare në një anë të linjës së transmetimit, dhe për shkak të mungesës së vendbanimeve të mëdha për pjesën kryesore të linjës, ndjeshmëria prej banorëve lokalë ndaj zhurmës së rritur nga ndërtimi dhe transporti i materialeve vlerësohet të jetë teper e ulët.

Niveli i zhurmave duhet të jete i tille qe te plotesoje standartet shqiptare dhe ato te Bashkimit Europian dhe ne rastin e Linjes 110 kV Nst. Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak duhet te plotesohen edhe standartet BE-se (meqenese donatori kryesor i ketij investimi eshte Banka Shtetore Gjermane e Zhvillimit KfW). Gjithashtu edhe gjate fazes se operimit zhurma brenda niveleve te lejuara emetohen nga transformatoret dhe celesat e ndryshem qe jane pjese e kesaj linje. Te gjithë celsat do te zgjidhen ne menyre te tille qe te plotesojne normat ne lidhje me nivelin e lejuar te zhurmave. Mbeshtetur ne standartet nderkombetare te celsave 110 kV kemi nje nivel zhurmash te rendit 8-9 decibel me te vogla se niveli i lejuar.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmëria e banorëve lokalë në lidhje me zhurmat gjatë ndërtimit			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

7.3.3 Pluhuri dhe gazet e shkarkimit

Volumi i konsiderueshëm i materialeve të ndërtimit do të transportohet në vendet e punimeve me kamion të medhenj, të mesëm dhe të vegjël sipas vendit dhe situatës, duke shkaktuar një sasi gazesh djegjese. Ekzistojnë standarde të përqendrimit të emetimeve për emetimet kryesore në ajër (CO, NO_x, tymi, dhe HC), dhe automjetet ligjërisht duhet t'i respektojnë ato.

Përveç rritjes së emetimeve të zhurmave (shiko me sipër) rritja e përkohshme e trafikut gjatë fazës së ndërtimit mund të krijojë pasoja të tjera të ndryshme. Si krijimi i pluhurit dhe emetimeve të shkarkimeve të gazeve mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve duke qenë se shkaktojnë probleme respiratore.

Emetimet e pluhurit dhe të gazeve të shkarkimeve janë një pasojë e pashmagshme që vjen nga përdorimi i automjeteve. Megjithatë, për shkak të afërsisë së kalimit të linjës së transmetimit me rrugën nacionale dhe shmangies së vendbanimeve kryesore në pjesën tjetër të linjës së transmetimit, ndjeshmëria e banorëve lokalë ndaj emetimeve të rritura të pluhurave dhe gazeve të shkarkimit vlerësohet të jetë teper e ulët. Prandaj edhe ndikimi tek banorët lokalë është vlerësuar të jetë i neglizhueshëm.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmëria e banorëve lokalë në lidhje me pluhurin dhe gazrat e djegjes			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Madh
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Këto limite janë vendosur nga Ministria e Transportit së bashku me Ministrinë e Mjedisit, duke marrë në konsideratë moshën e automjeteve dhe tipet e tyre. Limitet e vendosura në Shqipëri janë të ngjashme me ato të vendeve Evropiane para dhjetë vjetësh (një përditësim i këtyre normave pritet të bëhet rreth vitit 2013-2015).

7.4 Sasia e emetimeve të pluhurit

Sasia e pluhurit gjatë transportimit të materialeve mund të minimizohet me mbulimin e kamionëve që transportojnë materialet inerte dhe duke i lagur materialet gjatë transportimit. Në pikëpamje të punëtorëve në vendin e ndërtimit një prodhim i pashmangshëm pluhuri do të ndodhë gjatë aktiviteteve të gërmimit. Kjo mund të minimizohet duke spërkatur tokën e gërmuar në rastet e kushteve të motit të thatë. Gjithashtu, emetimi i gazeve të djegjës nga makinat e ndërtimit është i pashmangshëm.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmëria e punëtorëve në lidhje me pluhurin dhe gazrat e djegjes			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Madh	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Marrja e masave të përshtatshme mbrojtëse (p.sh. maska pluhuri) për punëtorët mund të jetë e nevojshme. Duke i zbatuar këto masa, ndikimi i pluhurit dhe gazeve të djegies tek punëtorët do të jetë vetëm i një rëndësie të vogël kështu që edhe shkalla e ndikimit do të jetë vetëm e ulët.

7.5 Ndikimi mbi Florën dhe Faunën

7.5.1 Pastrimi i vëndit ku kalon linja

Kursi paraprak i linjës kalon kryesisht në tokë shkembore pothuajse në 65-70% të korridorit, 15-20% në zona me shkurre dhe vetëm fare pak në toka bujqësore, të cilat nga ana e tyre janë me vlerë të ulët për speciet bimore e shtazore. Duke qenë se prania e bimëve dhe disa llojeve të kafshëve nuk mund të përjashtohet nga korridori i linjës, ndikimi i pastrimit të vendit është i një rëndësie të madhe (kur merret në konsideratë rasti më i keq).

Për përgatitjen e korridorit të linjës është e nevojshme prerja e drureve, pastrimi i shkurreve dhe heqja e llojeve të bimësive të tjera. Që në fillim duhet theksuar se korridori është zgjedhur i tillë që të kalojë në zona të zhveshura në shumicën dërmuese të gjatësisë së linjës dhe për zonat që e ka të pamundur të minimizojë prerjen e molleve, kumbullave, drureve dhe pastrimin e shkurreve.

Heqja e bimësisë në përgjithësi do të çojë në shkatërrimin e perkohshëm të habitateve me vlera të ndryshme si për florën dhe faunën (p.sh. gjitarët, zogjtë, zvarranikët, insektet) që jetojnë në zonën e parashikuar për ndërtim. Ajo mund të çojë gjithashtu në migrimin e kafshëve që jetojnë atje dhe krijimin e habitateve të reja për speciet më të tjera preferencë habitati. Si pasojë e këtyre ndërhyrjeve mundet pjesërisht të degradohet mbulesa bimore duke pakesuar edhe komunitetin faunistik.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmërinë e florës dhe faunës në lidhje me pastrimin e faqes			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Madh	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Për të minimizuar shpyllëzimet, do të jetë e nevojshme të përcaktohet siç duhet sasia e pyjeve që do të priten (afersisht 3.5-4% e të gjithë korridorit të linjës). Më tej, aktivitetet e ndërtimit duhet të kufizohen në korridorin e përcaktuar të ndërtimit. Zona e punës duhet të jetë e kufizuar në hapësirën e lirë të nevojshme në mënyrë rigorozë për aktivitetet e ndërtimit (rrugët, thememlet e shtyllave të tensionit). Lëvizjet e automjeteve dhe ruajtja e materialeve të ndërtimit dhe hedhja jashtë korridorit e mbeturinave të ndërtimit duhet të parandalohet. Masa adekuate për ripyllëzim

mund të mitigojë ndikimet në florë dhe faunë nga pastrimi i vendit ku kalon linja. Me këto masa ndikimi në florën dhe faunën mund të zbutet në mënyrë të konsiderueshme apo edhe të shmangët, sic edhe do të tregohen në planin e mitigimit të ndotjeve të mjedisit nga ndertimi i kësaj linje.

7.6 Ndikimi në tokë

Studimi i tokave në zonen ku do të kalojë korridori i linjes ndihmon në njohjen e veçori ve të peizazhit gjeografik dhe në intensifikimin e bujqësisë, që kërkon njohjen e hollësishme të llojeve të bimeve që mund të rriten në to. Analiza tregon se në zonen ku do të kalojë korridori i linjes kushtet dhe faktorët pedogjenetikë janë të larmishëm, që, dallohen për larminë e theksuar: ndryshon përbërja kimike e mineralogjike e formacioneve amnore; ndryshojnë veçoritë morfologjike të relievit, kushtet klimatike, hidrografike dhe sidomos gjallesat (bimët e larta, vertebrorët, mikrogjallesat, e fauna e tokës). Këto ndryshime shprehen në drejtimin horizontal dhe sidomos në atë vertikal.

Toka aluvionale mikse janë me shume në zonen ku do të kalojë korridori i linjes sidomos në luginat e Vjosës. Ato formohen edhe në depozitimet detare e liqenore, mbi të cilat vendoset rëra, zhavorri dhe rallë popla të vogla guresh. Në tokat aluvionale, për shkak të depozitimeve të përsëritura të aluvioneve, bimësia është e rrallë dhe jo shumë e zhvilluar.

Në përgjithësi në një pjesë tjetër të zones ku do të kalojë korridori i linjes janë toka me përbërje mekanike subargjilore e argjilore në grykëderdhje ose edhe në rrjedhjet e poshtme dhe subranore e ranore në drejtim të rrjedhës së mesme e të sipërme. Janë të përbëra nga shtresa që zëvendësojnë horizontet gjenetike të tyre, që lidhet me mbulimin e përsëritur me aluvione të reja.

Nëse nuk tregohet kujdes toka ndotet. Prej saj ndotet edhe prodhimet bujqesore e blektorale duke rrezikuar kështu rëndë shëndetin e konsumuesve të këtyre prodhimeve. Burimet e ndotjes janë të shumta por duhet theksuar që në fillim ndertimi i kësaj linje ka ndikim minimal në tokë.

Toka do të përpunohet në vendin e ndërtimit. Në vendet ku do të vendosen shtyllat e tensionit të lartë, punimet e gërmimit dhe nivelimi mund të jenë të nevojshme. Më pas, këto vende do të mbushen pjesërisht me zhavorr. Por, madhësia e një ndikimi të tillë pritet të jetë e ulët, pasi zona në fjalë është me madhësi relative të ulët përse lidhet me pjesën humusale dhe pothuajse sic u shprehem edhe sipër në shumicën dërmuese të rasteve ajo kalon neper zona shkembore. Për këtë arsye, ndikimi do të jetë i një rëndësisë të vogël.

Madhësia e Impaktit	Ndjeshmërinë e tokës në lidhje me perzierjen e saj me elemente të demshem			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Një hetim i tokës/ekspertizë e terrenit duhet të kryhet gjatë fazës së projektimit të detajuar të piketimit të shtyllave në mënyrë që të jenë në gjendje të përcaktojnë ndikimin real në tokë.

7.7 Erozioni i dheut

Shume ha toke vazhdojne te shkaterrohen ne Shqiperi nga erozioni i tokes. Ky fenomen, i cili ka marre permasa te medha vitet e fundit, si pasoje e levizjes se pakontrolluar te popullsise dhe investimeve te pakta, po synohet te minimizohet nepermjet zbatimit disa projekteve, bejne te ditur burime nga Insituti i Tokave ne Tirane. Humbjet nga erozioni i tokes ne vend, kohet e fundit kane arritur ne rreth 75 tone/hektare ne vit, nderkohe vlere normale llogaritet 5-10 tone/hektare. Per te bere nje krahasim te zones ku do te kaloje korridori i linjes kemi nje errozion me te ulet se vlerat mesatare prej 2-4 tone/hektare sipas raportit te Insitutit te Tokave.

Ndërtimi i themeleve te shtyllave mund të përkeqësojë situatën, veçanërisht në terrenet kodrinore me shtresa dheu te holla duke qenë se linja kalon përmes maleve, ku ndjeshmëria e tokës mund të vlerësohet si mesatare. Prandaj ndikimi është negativ, por përkohësisht - i kufizuar vetëm për periudhën e ndërtimit. Për më tepër, duke qenë se gjurmët e themeleve të shtyllave janë të vogla, shkalla e ndikimit është e ulët. Në përgjithësi ekziston një rrezik i vogël i erozionit të tokës i lidhur me ndërtimin e themeleve të shtyllave.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmëria e tokës në lidhje me erozioni			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Minor	Moderuar	Madh	Madh

Në mënyrë që të parandalohet erozioni i mëtejshëm i tokës linja vijon rrugëve ekzistuese dhe ne disa segmente ne korridorin e linjes ekzistuese sa më shumë që të jetë e mundur. Masa të tjera të mundshme për zbutje të errozionit të mëtejshëm të tokës përfshijnë mënjanimin e shpateve me pjerrësi të lartë në kodra dhe marrjen e masave për të kontrolluar erozionin e tokave.

7.8 Kontaminimi i Tokës

Burimet e ndotjes/kontaminimit te tokes jane te shumta:

- Kontaminimi i tokës gjatë ndërtimit mund të lindë nga magazinimi jo i duhur i mbeturinave dhe rrjedhjet aksidentale nga tanket e lubrifikantëve, tretësve, bojës, vajit naftës/dieselit, etj. Duke qenë se linjaaktuale e transmetimit eshte e re përkatësisht, mbeturina si beton, profile çeliku, qeramika dhe vaj i vjetër transformatori ndoshta do të mbeten ne rast se nuk behet kujdes per to, por duhet theksuar se do te mbetet shume me pak se sa per rastet e riparimit te linjave ekzistuese. Përveç kësaj, do të gjenerohen edhe mbetjet rezidencilae nga punëtorët.
- Mbetjet industriale te ngurta dhe te lengeta me permbajtje te rrezikshme per shendetin e njeriut dhe ne kete zone eshte shume e rendesishme te permendim se nuk ekziston ndonje zone e kontaminuar ne nivel te larte.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

Toka në korridoret e linjës së transmetimit është gjykuar në përgjithësi të jetë me ndjeshmëri të mesme për këtë lloj ndikimi (duke marrë në konsideratë rastin më të keq). Në varësi të llojit të kontaminimit, toka do të ndotet afat shkurtër apo afat-gjatë. Por, madhësia e një ndikim të tillë pritet të jetë e ulët kur punohet në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe kjo na çon drejt një ndikimi me rëndësi të ulët.

Madhësia e Impaktit	Ndjeshmërinë e tokës në lidhje me ndotjen			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Larte	Larte

Depozitat e lubrifikantëve dhe tretësve që janë përdorur gjatë ndërtimit të linjës do të kenë një mbulesë të dyfishtë. Veçanërisht gjatë ndërtimit të bazamenteve të shtyllave të tensionit të lartë, ndërtuesi duhet të shmange humbjen aksidentale të betonit dhe/ose të substancave të tjera të huaja në terren. Duhet të parandalohet ruajtja e materialeve të ndërtimit, dheut të gërmuar dhe të të gjitha llojeve të mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara. Është e ndaluar hedhja e mbeturinave direkt në vende të hapura. Në përgjithësi, duhet të ndiqen principet e mëposhtme sipas udhëzimeve të BE-së 2008/98/EC: E para parandalimi (shmangia e mbeturinave), E dyta përgatitja për ripërdorim, E treta riciklim sa më shumë që të jetë e mundur (p.sh. pjesët e pajisjeve të vjetra, metalet, bateri), E katërta rekuperimi, E pesta largimi në vendin e duhur të mbeturinave të mbetura (p.sh. mbeturinat e prishjes, mbeturinat shtëpiake, asbesti, vaji i transformatorit). Ndotësit potencialë duhet të trajtohen siç duhet. Punëtorët duhet të trajnohen lidhur me mënyrën se si duhet të sillen me mbeturina të ndryshme.

7.9 Ndikimi në ujë

7.9.1 Ujerat sipërfaqësore

Lumejte me kryesore që janë pranë zones ku do të ndërtohet korridori i linjes 110 kV janë Lumi i Vjoses, Drinos, Belnces, Langarices, Carcoves, Velcanit, Nices dhe një sere perrejtsh të tjere. Te gjithë keta lumej kane nje pellg ujembledhës me sipërfaqe 1342 km² dhe ushqehen kryesisht nga reshjet burimet e maleve të Pindit, Gramozit, Vallarërit dhe Zogorise.

Një ndikim potencial është ndotja e ujërave sipërfaqësore nga mbeturinat, balta e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, tretësve, bojrave, vajrave, naftës etj., gjatë periudhës së ndërtimit. Mjedisi i ujit është supozuar të jetë me ndjeshmëri të lartë ndaj këtij lloj ndikimi (p.sh. lumejte e Vjoses, Drinos, Belnces, Langarices, Carcoves, Velcanit, Nices dhe te gjithë lumejte e tjere afer korridorit te linjes jane nje habitat i çmuar për shume gjallesa ujore), dhe madhësia e këtij ndikimi, gjykuar nga volumi relativisht i vogël i substancave të tilla të pritshme, pritet të jetë e ulët. Kjo rezulton në një ndikim negativ të një rëndësie të ulët.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmërinë e ujërave sipërfaqësore në lidhje me ndotjen			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Një strategji efektive mitiguese për të parandaluar ndotjen e ujërave sipërfaqësorë gjatë ndërtimit është zbatimi i një skeme të menaxhimit të mbeturinave dhe të monitorimit të aktiviteteve të ndërtimit. Duhet të mënjanohet magazinimi i materialeve të ndërtimit dhe i të gjitha llojeve të mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara. Ndotësit potencialë duhet të trajtohen siç duhet. Facilitetet sanitare duhet të instalohen në vendin e ndërtimit në mënyrë që ujërat e zeza të gjeneruara nga punonjësit të mos shkarkohen si ujëra sipërfaqësorë.

7.9.2 Ujërat nëntokësorë

Ujrat nëntokësorë në zonën ku do të kalojë koridori i linjes janë ujëra karsitike dhe janë të lidhura në shumicën e dermuesve të rasteve me zonat karstike. Burimet e Kelcyres, Viroit, Zagorise, Ujit të Ftohte të Tepelene janë burime nëntokësorë të rëndësishme për vendin tonë. Kontaminimi i drejtpërdrejtë i ujërave nëntokësorë mund të jetë i mundur gjatë ndërtimit të themeleve të shtyllave të tensionit në varësi të nivelit të ujërave nëntokësorë në tokë. Për më tepër, kontaminimi i tokës mund të çojë indirekt në ndotjen e ujërave nëntokësorë. Uji nëntokësor në zonën e Projektit gjykohet të jetë në përgjithësi me ndjeshmëri të mesme ndaj këtij ndikimi. Duke qenë gjykuar nga volumi relativisht i vogël i substancave të tilla të prishme, pritet që ndikimi negativ të jetë tepër i ulët. Kjo rezulton në një ndikim negativ të një rëndësie të ulët.

Madhesia e Impaktit	Ndjeshmërisë së ujërave nëntokësore në lidhje me ndotjen			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Mesem	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Mesem	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Një strategji mitigimi efektive për të parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësorë në vendin e ndërtimit është zbatimi i një skeme menaxhimi të mbeturinave dhe monitorimi e aktiviteteve të ndërtimit. Duhet të parandalohet depozitimi i materialeve të ndërtimit dhe i të gjitha llojeve të mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara. Në përgjithësi duhet të ndiqen principet e minimizimit të mbeturinave. Ndotësit potencialë duhet të trajtohen siç duhet.

7.10 Ndikimet në klimë dhe ajër

7.10.1 Emetimet e ndotësve të ajrit

Traktati i mëpasshëm që hartoi Komuniteti i Energjisë 9 në Evropën Juglindore përfshin një numër elementesh të projektimit të tregut për energjinë elektrike. Komisioni Evropian vë në dukje që ky projekt i tregut Evropian “nuk bazohet në një koncept të vetëm, por ka evoluar nga projekte të ndryshme rajonale” të harmonizuara nëpërmjet procesit të Firences duke përfshirë Shtetet ekzistuese Anëtare të BE (Komisioni Evropian, 2005). Nepermjet këtij traktati Bashkimi Europian i ka dhene nje rendesi te dores se pare zhvillimit te sektorit te transmetimit per te plotesuar nevojat, por nga ana tjetere i ka terhequr vemendjen te gjitha vendeve nenshkruese te rajonit qe te bejne te mundur ndertimin e linjave te reja me ndikim minimal ne klime dhe ne mjedis.

Ne kete kuader gjate fazës së ndërtimit sasi e vogël pluhuri si dhe e gazeve të djegies do të emetohet në atmosferë. Ashtu siç edhe dihet, në qoftë se në nënstacionet ekzistuese ka transformatorë me izolues gazin SF6, nuk mund të përjashtohet rreziku i rrjedhjes së SF6. Por meqenëse per linjen tone nuk kemi te bejme me nënstacione eksiztuese por vetem me ndertimin e nje linje te re potenciali i ndotjes nga ky ndotes eshte teper i ulet.

Për shkak të potencialit të lartë në ngrohjen globale SF6 mund të kontribuojë në efektin serë, në qoftë se ky gaz lëshohet në mënyrë të vazhdueshme në atmosferë. Sidoqoftë në çelësat elektrikë gazi SF6 është përdorur gjithmonë në pjesëza pa rrjedhje gazi, duke minimizuar në mënyrë të ndjeshme rrjedhjen. Kontributi mbarëbotëror në ngrohjen globale i SF6 është nën 0,1% në lidhje me gazet e tjera të efektit serë të shkaktuara nga njeriu (për Komunitetin Evropian mendohet të jetë rreth 0.05%). Në bazë të të dhënave të dhëna më sipër, klima dhe ajri në zonën e Projektit presupozohet të jenë mesatarisht të ndjeshme ndaj këtij lloji ndikimi. Madhësia e një ndikimi të tillë pritet të jetë teper e ulët. Kjo çon në një ndikim të një rëndësie të ulët.

Madhësia e Impaktit	Ndjeshmërinë e klimës dhe të ajrit në lidhje me emetimet e SF6			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Në mënyrë që të shmangen ndikimet mbi klimën dhe ajrin, është i nevojshëm një trajtim i kujdesshëm i transformatorëve të vjetër dhe i celesave me gaz SF6. Punëtorët duhet të trajtohen në mënyrë adekuate. Disa udhëzime për trajtimin e duhur të SF6-ës jepen më poshtë:

- IEC (DIN EN)* 60376 ‘Specifikimi dhe pranimi i hexafloridit të squfurit të ri’
- IEC (DIN EN) 60480 ‘Udhëzues për kontrollin e hexafloridit të squfurit (SF6) të marrë nga pajisjet elektrike’

⁹ Memorandumi i Athinës i vitit 2005 ka të bëjë me krjimin e Traktatit te Energjise

IEC 61634 ‘Kutia e çelësave dhe e kontrollit të tensionit të lartë - Përdorimi dhe trajtimi e hexafloridit të squfurit (SF6) në kutitë e çelësave dhe të kontrollit të tensionit të lartë’

7.11 Ndikimi në peisazh

7.11.1 Ndikimi vizual

Me interes të veçantë për aspektin vizual në zonën ku do të kalojë korridori i linjes është gryka e Zëmbllakut (Cangonjit), me gjatësi afërsisht 3 km dhe rreth 100-200 m e gjerë (pjesa më e ngushtë e saj). Tarracat në të dy anët e kësaj gryke tregojnë se lumi ka rrjedhur vazhdimisht nëpër të dhe se liqeni i Korçës lidhet me atë të Devollit. Formimi i kësaj gryke lidhet me çarjet tektonike, kurse ngritja e malit të Moravës nga fundi i miocenit e detyroi atë (Devollin) që të shfrytëzojë shkëputjet tektonike.

Gjatë gjithë luginës janë zhvilluar tarracat lumore, nivelet e ulëta të cilave në drejtim të veriut (fushës së Bilishtit), për shkak të lëvizjeve ulëse, shprehen më pak deri sa zhduken nën depozitimet e reja. Lumorja merr formën e saj të plotë në zgjerimin e Mirasit, por zhvillimin më të madh e arrin në fushën e Kurilës dhe në fushën e Bilishtit, ku shkrihet në tarracën e parë.

Zona ku do të ndërtohet projekti është gjeografikisht shumë e pasur dhe peizazhi i mesiperm nuk do të ngacmohet nga ndërtimi i linjes meqenese korridori i linjes do të jete larg saj. Për pasojë është shumë e rëndësishme të theksohet se ndikimi vizual në zonën ky do të kalojë projekti është për kushtet aktuale gati minimal.

Ndërtimi i shtyllave dhe i nënstacioneve mund të çojë në ndërprerje vizuale të përkohshme e perceptuar kryesisht nga banorët lokalë. Kjo mund të shkaktohet nga prania e dukshme e makinerive dhe e materialeve të ndërtimit në një peizazh të bukur, nga shkarkimet e pluhurit, nga mbeturinat dhe mbetjet e perkoheshme të lëna nga ekipet e punës dhe nga dëmtimi i bimësisë ose tokës së kultivuar nga mjetet e rënda. Peisazhi ka të ngjarë të jetë mesatarisht i ndjeshëm (meqenese korridori është zgjedhur të kalojë në pjesën më të madhe në një terren shkëmbor) ndaj këtij lloji ndikimi duke qenë se korridori i linjës së tensionit do të kalojë përmes tokave të ulëta të kultivuara nga njëra anë dhe do të ndjekë rrugët ekzistuese sa më shumë që të jetë e mundur por nga ana tjetër do të kalojë larg peisazheve piktoreske si lugina e Drinit dhe zonat kodrinore dhe malore. Grupet relativisht të vogla të punës nuk duhet të rezultojnë në hedhje të pakontrolluara të mbetjeve ose mbeturinave. Si rezultat madhësia e ndikimit është mesatare si pasojë e së cilës domethënia vlerësohet të jetë e moderuar.

Madhësia e Impaktit	Ndjeshmëria e peizazhit në lidhje me ndikimet vizuale			
	Neglizhueshem	Vogel	Mesem	Larte
I Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Neglizhueshem
I Vogel	Neglizhueshem	Neglizhueshem	Vogel	Vogel
I Mesem	Neglizhueshem	Vogel	Moderuar	Moderuar
I Larte	Vogel	Moderuar	Madh	Madh

Në mënyrë që të reduktohet ndikimi vizual linja ndjek rrugët ekzistuese sa më shumë që të jetë e mundur. Një strategji efektive mitigimi për parandalimin e ndotjes vizuale të sheshit të ndërtimit është monitorimi i aktiviteteve të ndërtimit. Masa adekuate rimbjellje mund të minimizojë ndikimet vizuale pas fazës së ndërtimit.

1 <http://geography.about.com/library/cia/blcalbania.htm>

2 <http://www.archaeology.org/online/features/albania/>

3 <http://archaeology.about.com/od/albania/ig/Albania-Archaeology-in-Photos/>

4 <http://air-climate.eionet.europa.eu/docs/meetings/>

051017_10th_EIONET_AQ_WS/14_AL_AgronDelieu_AQ_WS051017.pdf

7.12 Ndikimet e mundshme ne mjedis gjate fazes se operimit te Linjes dhe zgjerimi apo ndertimi i nenstacioneve perkatese

Gjate aktivitetit te saj jetesor dhe prodhues shoqeria vazhdimisht ka demtuar boten e gjalle (bimesine dhe faunen). Ne keto aktivitete ne shumicen e rasteve theksojme praktikat e gabuara te zhvillimit intensiv te bujqesise, shpyllezimet masive dhe kthimin e tyre ne toka bujqesore, perdorimi i kimikateve, perdorimi i lendeve djegese, mbishfrytezimi i ujrave siperfaqesore te lumejve dhe liqeneve, levizja e pakontrolluar e popullsise drejt qyteteve, etj.

Nga te gjitha keto aktivitete te permendura me siper apo edhe te tjera te papermendura po demtohet biodiversiteti ne vecanti dhe mjedisi ne pergjithesi dhe eshte e domosdoshme qe te marrim masa per zbutjen e tyre.

Nje nga efektet me te diskutueshme te nje linje, nenstacioneve elektrike apo nje grup linjash te tensioneve te ndryshme jane efektet e fushave elektrike dhe magnetike ne qeniet njerezore dhe mjedisin ne pergjithesi. Per pasoje ne vazhdim do te ndalemi ne detaje per efektet e mundshme qe mund te sjelle ne qeniet njerezore dhe mjedis ndertimi i Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe nenstacioneve perkates.

7.12.1 Rrymat Endogjene dhe Risku i Tyre

Fushat elektrike dhe magnetike, gjithnje cojne ne krijimin dhe induktimin e rrymave elektrike endogjene dhe me keto lidhen te gjitha mekanizmat e veprimit biologjik, te njohura dhe te panjohura. Prej shume kohesh jane bere perpjekje per te percaktuar marredhenie te qarta ndermjet tyre dhe rrisqeve dhe pasojave qe ato mund te japin ne mjedis dhe shendetin e njerezve. Edhe sot problemi ka mbetur i hapur. I pare ne kete kendveshtrim reduktohet ne percaktimin e limiteve te rrymave endogjene, pra dhe te fushave elektrike (E) dhe atyre magnetike (B) te lejura per ekspozimin e njeriut. Ne kete kuptim gjate viteve jane bere perpjekje per te vendosur kufijte e lejuar te ekspozimit, nisur nga deshira e shume vendeve te perparuara qe normat te vijne duke u ulur per ta bere riskun dhe ndikimin ne mjedis sa me te vogel qe te jete i mundshem.

Historikisht, para vitit 1985, ka patur iniciativa me karakter rekomandues dhe vetem rralle here ato kane sherbyer si normativa te verteta edhe ne vendet me te perparuara te botes. Keshtu per shembull ne Gjermanine Federale (para vitit 1989) quhej e pranueshme nje ekspozim i vazhdueshem i publikut, ndaj fushave elektrike dhe magnetike, ku gradienti i fushes ishte 20 kV/v, ndersa ai fushes magnetike ishte 5 mT. Ndersa Belgjika kishte fiksuar nje limit prej 25 kV/m te fushes elektrike dhe 8 mT te fushes magnetike.

7.12.2 Studimi Nderkombetar ne Lidhje me Ndikimin e Fushes Elektrike dhe Magnetike (1999)

Studimi Nderkombetar ne Lidhje me Ndikimin e Fushes Elektrike dhe Magnetike (realizuar ne vitin 1999 nga nje panel i shkencareve me ne ze) me perfundimet e veta eshte realizuar nga nje grup shkencetaresh te sektorit elektrik, mjedisor dhe mjeke dhe ka treguar limitet e rekomanduara ne baze te dhenave shendetesore imediate, te pritshme dhe te parashiuara, qe mund te prodhohen nen efektin e ekspozimit ne keto fusha.

Kriteri baze i analizes i perdorur nga ky grup shkencetaresh eshte mekanizmi kryesor i bashkeveprimit me organizmin duke patur parasysh se dukurite biollogjike jane attribute te rrymave endogjene. Ne kete kuptim ne funksion te dendesise se rrymes, te trajtuar ne disa diapazone te gjera, vihen ne dukje dukurite biollogjike te renditura si vijon:

Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte $\delta = (1-10) \frac{mA}{m^2}$, nuk kemi te bejme me probleme shendetesore, dendesite e rrymave jane ne pragun e perceptimit te tyre.

Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte $\delta = (10-100) \frac{mA}{m^2}$, vihen ne dukje dukuri te qarta qe kane te bejme me sistemin viziv dhe sistemin nervor qendror.

Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte ne kufijte $\delta = (100-1000) \frac{mA}{m^2}$, vihen ne dukje dukuri te qarta te stimulimit te indeve te eksitueshme dhe jane te mundeshme pasoja shendetesore.

Kur dendesia e rrymes ne organizem eshte me e madhe se kufiri $\delta = (1000) \frac{mA}{m^2}$, mund te vihen re ekstrasistola dhe fibrilacione ventrikulare.

Duke marre nje faktor sigurie 10 here, norma te vendeve te ndryshme kane marre si norme

kufizimin e densitetit te rrymes ne kufijte $\delta = 10 \frac{mA}{m^2}$ per rrymat e induktura.

7.12.3 Efektet biologjike te fushave elektromagnetike

Efektet potenciale mbi shendetin e njeriut te fushave elektromagnetike kane terhequr vemendjen e shume studjuesve qe nga vitet 1980 deri ne ditet e sotme. Ne vitin 1987 nje studjues i njohur amerikan, realizoi studimin per montatoret qe punonin ne linjat e TL (110, 220 dhe 400 kV) dhe verejti se ekspozimi nuk sillte ndonje problem te vecante. Ekspozimi i perseritur i punetoreve

karshi fushave elektromagnetike nuk krijonte asnje shqetesim klinik dhe as modifikim te kriterave paraklinike dhe biologjike.

Po keshtu edhe studjuesit ruse kane vene ne dukje se punetoret e ekspozuar ne fushat elektromagnetike te krijuara ne nenstacionet 400/220/110 kV te fuqive te konsiderueshme (mbi 200 MVA) nuk kane pasur shrrregullime kronike te shendetit. Ne vitin 1999 studjuesit rus dhe amerikan publikuan rezultatet perfundimtare te ndjekjes se rregullt te specialisteve (montatoreve te ndryshem dhe atyre qe punojne per shfrytezimin e linjave dhe nenstacioneve te tensionit te larte mbi 110 kV) te ekspozuar gjate punes se tyre ndaj nje fushe elektrike intensive.

Gjate nje vezhgimi 9-vjecar (1990-1999), ekzaminimet klinike, te pergjithshme dhe te specializuara, vune ne dukje se konstantet hematologjike e biokimike, EKG dhe EEG, testet biologjike te funksionimit te veshkave, te tiroideve, te melcise, te organeve gjenetale etj, nuk paten ndryshime sinjifikative per tu shqetesuar.

Kurora eshte nje dukuri e shpeshte e linjave te tensionit te larte si atij te vazhduar ashtu edhe atij alternativ. Dukuria e kurores lidhet me shkarkimet ne ajer te fushes elektromagnetike. Ky shkarkim shoqerohet me nje aureole perqark percjellesit. Aureola psh ne linjat e tensionit te larte 400 kV, me nje largesi ndermjet percjellsave prej 6-7 m ka nje rreze prej 30-40 cm. Dukuria e kurores rritet ne pranine e shiut, ose te pikave te ujit ne gjendje suspense ne ajer prane percjellesit. Shume shkencare mendojne se problemi eshte shqetesues, per shkak te efekteve potenciale mbi organizmin e njeriut te joneve qe prodhohen. Vleresohen se 10-20% e joneve te prodhuara per shkak te efektit te kurores mund te zhvendosen prej eres dhe shiut edhe ne nje largesi prej 500 m qe mund te jete prane zonave te banuara ne afersi te linjes ne disa raste. Dihet se jonet kane efekte shqetesuese per shendetin e njeriut. Jonet jane nje oksidant shume aktiv qe mund te jene toksike per qeniet e gjalla. Ndermjet tyre mund te permendim dhimbjen e kokes, migrena, shqetesime nga stomku dhe te vjella, probleme te frymemarrjes dhe shqetesime ne syte dhe ne veshet. Analiza e linjes Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak tregon se ajo eshte ne cdo rast minimalisht 1000 m larg qendrave te banuara, per pasoje nuk do te ndjehet efekti i kurores.

7.12.4 Disa veshtrime kronologjike dhe referime institucionale

Ne vitin 1978, Komiteti Shendetesor i Shtetit te New York-ut, terhoqi vemendjen per linjat e tensionit te larte per te percaktuar tensionin maksimal te ekspozuar te autorizuar dhe largesite e sigurise, apo korridoret perqark linjes. U vendos tensioni 160 kV/m. Eshte e para here qe nje Komision publik cakton rregulla qe lidhen me ekspozimin ne nje fushe elektrike.

Ne vitin 1990 ne USA Agjensia Amerikane e Mbrojtjes se Mjedisit (Environmental Protection Agency), porositi nje raport per vleresimin e literatures shkencore, te perbere nga disa qindra studime shkencore te realizuara deri ne ate vit ne fushen e ndikimeve te fushes elektromagnetike. Ne raport ndermjet te tjerave thuhet se: "si perfundim shume studime te analizuara kane treguar se kemi nje rrisht shume te ulet te leucemise, te kancerit per punonjesit qe jane te ekspozuar karshi fushes elektrike".

Ne vitin 1994 Parlamenti European, voton nje rezolute ku rekomandon qe te studjohen normat aktuale, normat e vendosjes se korridoreve te linjave te tensionit te larte per secilin tension (110, 220, 400 kV) dhe per te pasur siguri te larte ne linjat e reja perjashtohet ndertimi i tyre prane qendrave te banimit dhe aktiviteteve te ndryshme te sherbimit.

Ne vitin 1996 ne Akademine Amerikane, nga eksperte te vecante u paraqit nje raport i ri qe vleresonte literaturen epidemologjike te koheve te fundit, ne te cilen terheq vemendjen perfundimi: “Nuk ka asnje evidence perfundimtare qe te tregojne se ekspozimi rezidencial ne nje fushe elektromagnetike, te con ne nje kancer, ne efekte te demshme neurologjike, ose te sistemit riprodhues”. Viti 2000 do te kujtohet ne historine e hartimit te normave kunder ndotjes elektromagnetike. Ai filloi me mjaft buje me nje ligj te ri zvicerian. Zvicra vendos nje norme te saj prej 10 mG. Ndersa ne vitin 2003, nje Komitet i pavarur, i drejtuar nga Prof. Dr. Richard Doll, nje personalitet me ze i epidemiologjise, profesor ne Universitetin e Mjekesise ne Oksford, i pyetur nga nje gazetar australian per efektet negative te fushes elektromagnetike deklaroi se do te jetonte pa hezitim nen nje linje te tensionit te larte.

7.12.5 Vleresime te Organizates Boterore te Shendetesise

Me poshte do te jepen mendimet kryesore te Organizates Boterore te Shendetesore te cilat jne bere publike, sidomos vitet e fundit, per burimet jonizuese si linjat e tensionit te larte dhe nenstacionet elektrike te fuqishme te tensionit te larte. Nje nga problemet kryesore, i cili po studjohet nga Organizata Boterore e Shendetesise eshte percaktimi i normave te pranueshme nderkombetare. Gjithashtu OBSH po punon per te dhene informacione te rregullta mbi percaptimin, komunikimin dhe manaxhimin e riskut. OBSH ne nje studim te kryer ne vitin 1992 kishte marre ne analize dy popollata (njera qe punonte dhe jetonte afer nje linje te tensioni te larte dhe tjetra ne nje vend te pakspozuar). Analiza nuk konstatoi asnje diference statistikore ne lidhje me shume semundje te tilla si kanceri, leucemia, dhimbje koke dhe te tjera.

Nje studim tjetër i bere ne vitin 2002 nga Akademia e Shkencave te Shendetesise te Amerikes analizoi 1552 banore te nje periferie ne New York qe jetonin 150 metra larg nje linje te tensionit te larte 220 kV dhe 150 m larg nje nenstacioni 220/110 kV, pra nen nje fushe magnetike 0.1-1.1 mikrotesla. Analiza 10-vjecare tregoi se vdekshmeria nga kanceri nuk dallonte ne menyre sinjifikative nga nje popullate tjetër reference dhe e pakspozuar. Ne Angli, nje grup konsultativ, me nje studim te tyre ne vitin 2003 ne raport nenvizojne se studimet e bera deri me tani dhe veshtrimet statistikore jane te pamjaftueshme per te arritur ne perfundime te sigurta, qe fushat elektromagnetike nuk shkakton leucemi tek femijet sidomos kur jane te ekspozuara prane fushave me nivel te larte prej 2.5-3.5 mikrotesla. Megjithate duhet bere kujdes qe femijet te mos ekspozohen ndaj fushave elektromagnetike intensive per te shmangur rriskun e mundshem ndaj kesaj semundje. Per te qene te sigurte linjat duhet te ndertohen ne korridore 30-50 m larg zonave te banuara dhe nenstacionet e tensionit te larte duhet te ndertohen 70-100 larg zonave te banuara.

7.12.6 Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare

Duhet te theksojme se perderisa shkancerisht ende nuk njihet varesia direkte e intensiteteve te fushes elektrike dhe magnetike me patologjite potencialisht te mundshme te organizmit te njeriut, evantualisht rrjedhoje e rrezatimeve jojonizuese, standartet e rekomanduara te te gjitha niveleve jane relative, orientuese e kufizuese per te menjanuar efektet e demshme qe ato mund te

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

shkaktojne. Ne themel te hartimit te standarteve eshte pasur parasysh nje studim i rendesishem i kryer nga Organizata Boterore e Shendetesise per mbrojtjen nga rrezatimet dhe i rekomanduar te perdoret per mbrojtjen nga fushat elektromagnetike, ne vitin 2000 dhe perfundimet e tij po shfrytezohen nga mjaft institute kerkimore shteterore te pavaruara te shume vendeve te botes. Disa nga keto standarte dhe rekomandime jane:

- Duke patur parasysh problemin e rrymave endogjene pike referimi e ndertimit te normes eshte marre dendesia e rrymes se induktuar prej 10 mA/m², pra kjo eshte norma baze referuese.
- Kjo rryme ka ne korrespondence ekspozimin e njeriut ne fushe elektrike me gradient 25 kV/m dhe fushen magnetike me induksion 5 mT, te frekuences 50 Hz.

Perfundimi i arritur per normat e mesiperm eshte se nen driten e treguesve te sjelle me siper, fushat elektromagnetike te linjave te tensionit te larte (110, 220, 400 kV si dhe nenstacionet (400/220/110 kV) te rrjetit transmetues jane shume larg (dhe poshte) limiteve te rekomanduara me siper, pra nuk kemi te bejme me shqetesime shendetesore. Ne tabelen 18 jane dhene vlerat e standarteve te rekomanduara nga Organizata Boterore e Shendetesise ne lidhje me fushat elektromagnetike.

Tabela 18.: Vlerat e standarteve te rekomanduara nga OBSH ne lidhje me fushat elektromagnetike		
Subjekti i ekspozuar	Fusha Elektrike [kV/m]	Induksioni magnetik [mT]
Punonjes		
a. Dita e Punes	10	0.5 (*)
b. Periudha te Shkurtra	30 (*)	5
Popullsia		
a. 24 ore ne dite	5	0.1
b. Pak ore ne dite	10	1
(*) kohezgjatja e lejuar e ekspozimit ne fushat ndermjet 10-30 kV/m, mund te llogaritet me afersi nga shprehja: $t \leq \frac{80}{E}$ ku E eshte intensiteti i fushes elektrike ne kV ndersa t rezulton ne ore.		

Nga analiza e tabelës 6 mund te nxjerrim keto konkluzione:

- Sic shihet koha e ekspozimit eshte ne perpjestim te zhdrejte me intensitetin e fushes elektrike, pra ne perputhje me perfundimet intuitive;
- Ne rekomandimin per 0.5 mT mbahet parasysh kohezgjatja maksimale e ekspozimit prej 3 ore per cdo dite pune;
- Rekomandimi (a) per popullesine eshte per hapësira te hapura ku qytetaret te kalojne nje pjese te mire te dites.
- Rekomandimi (b) ka parasysh ekspozime per kohe te shkurtra.

7.12.7 Standartet dhe Rekomandimet e disa Shteteve

Ne vijim jepen standartet dhe rekomandimet kombetare te disa vendeve me te zhvilluara ne lidhje me fushat elektromagnetike.

7.12.7.1 Standarti Italian

Ne Standartin Italian te aprovuar ne vitin 2002 i perligjur me nje dekret te Parlamentit Italian dhe Vendimin perkates te Qeverise Italiane eshte ne thelb standarti nderkombetar, i cili u pershkrua me siper. Ne Itali ne mbeshtetje te ketyre normativave, me ligj jane sanksionuar keto limite maksimale:

5 kV/m dhe 0.1 mT per ata qe kalojne nje pjese te konsiderueshme te dites nen ndikimin e ketyre fushave (rasti (a) i popullsise ne tabelen 5).

10 kV/m dhe 1 mT per ata qe kalojne pak ore te dites nen ndikimin e ketyre fushave (rasti (b) i popullsise ne tabelen 5).

Ne nje shqyrtim te hollesishem veme ne dukje se linjat standarte te tensioneve te larta se bashku me nenstacionet elektrike te tensionit te larte kane keto vlera reale fushes elektrike dhe te induksionit magnetik:

Per linjat 400 kV dhe nenstacione 400/220/110 kV vlerat reale te fushes elektrike jane $E=4.5$ kV/m dhe $B=20$ μ T=0.02 mT.

Per linjat 220 kV dhe nenstacione 220/110 kV vlerat reale te fushes elektrike jane $E=2.3$ kV/m dhe $B=7$ μ T=0.007 mT.

Per linjat 110 kV dhe nenstacione 110/35/20/10/6 kV vlerat reale te fushes elektrike jane $E=2.1$ kV/m dhe induksioni magnetik $B=6$ μ T=0.006 mT.

Te krahasuara me limitet ne tebele dhe vlerat e standartit italian, keto vlera jane poshte tyre. Ndersa largesia e ndertimeve nga linjat duhet te jete sipas standarteve te meposhteme per te respektuar normat e mesiperme te fushes elektrike dhe induksioni magnetik:

Per linjat 400 kV dhe nenstacione 400/220/110 kV largesia e ndertimeve duhet te jete me e madhe se 28 m.

Per linjat 220 kV dhe nenstacione 220/110 kV largesia e ndertimeve duhet te jete me e madhe se 18 m.

Per linjat 110 kV dhe nenstacione 110/35/20/10/6 kV largesia e ndertimeve duhet te jete me e madhe se 10 m.

7.12.8 Identifikimi i fushes elektromagnetike te linjes dhe zgjerimi apo ndertimi i nenstacioneve perkates

Mbeshtetur ne metodiken e llogaritjes (sipas literatures teknike universitare) per llogaritjen e intensitetit te fushes elektrike dhe magnetike perdoren formulat e meposhtme:

Komponentja vertikale e fushes elektrike e krijuar nga linja e tensionit te larte ne toke percaktohet nga shprehja:

$$E_y = k_1 \cdot U \cdot \left[A - \frac{1}{2}(B + C) + j \frac{\sqrt{3}}{2}(B - C) \right] \left(\frac{kV}{m} \right) \quad (1)$$

Komponentja horizontale e fushes magnetike e krijuar nga linja e tensionit te larte ne, (ose prane) siperfaqes se tokes percaktohet nga shprehja:

$$B_x = k_2 \cdot I \cdot \left[A - \frac{1}{2}(B + C) + j \frac{\sqrt{3}}{2}(B - C) \right] (T) \quad (2)$$

Ne shprehjet e mesiperme kemi keto parametra qe llogariten me formulat e meposhtme:

$$A = \frac{h_1}{(x - d_1)^2 + h_1^2} \quad B = \frac{h_2}{(x - d_2)^2 + h_2^2} \quad C = \frac{h_3}{(x - d_3)^2 + h_3^2}$$

h, d, x – madhesite ne metra (m)

U – tensioni faze-faze ne kV

I – rryma ne Amper

k1, k2 – konstante perkatese te zgjedhura ne literaturen teknike.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

Formula llogaritese e E eshte teresisht duale me ate te B, kemi te ndryshem vetem koeficientet para kllapave qe e kalojne problemin nga fusha elektrike E ne fushen magnetike B.

Ne figurat 47-48 jane paraqitur shperndarjet perkatese te fushes elektrike ne nivelin e tokes dhe konkretisht komponentja vertikale. Largesia x e shprehur ne m i referohet mesit te trasese se linjes. Duke shqyrtuar keto shperndarje veme re se per linjat dhe tensionet e marra ne shfrytezim, gradientet maksimale jane 3, 5, 8 dhe 12 kV/m perkatesisht ne largesite rreth 8 m, 18 m, dhe 20 m nga aksi linjes, ndersa gjeresia e korridorit te linjes ne fushat te konsiderueshme ndryshon sipas tensionit: psh per tensionin 1000 kV edhe ne largesine 40 m kemi fusha 5 kV/m prane siperfaqes se tokes.




Figura 47.: Shperndarja e fushes elektrike per linja dhe nenstacione me voltazh te ndryshem

Formulat e mesiperme perdoren nga te gjithë Institutet Shkencore Teknike dhe ato te Shendetit Publik per te kontrolluan ndikimin e fushave elektrike dhe magnetike. Keto formula jane mjaft te thjeshta dhe japin mundesine qe te shqyrtohen varesite $E_y(x)$ dhe $B_x(x)$ poshte linjes. Ne se ato kerkohen ne lartesine e njeriut ato korrigjohen nepermjet h_1, h_2, h_3 , ne kete lartesi.

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT




Figura 48.: Profile shtyllash te tensionit te larte me permasat gjeometrike perkatese

Ne figuren 49 jane paraqitur tre profile shtyllash te tensionit te larte me permasat gjeometrike perkatese. Ndersa ne figuren 34 jane paraqitur shperndarjet perkatese te fushes elektrike nen secilen linje; ne secilin rast x eshte largesia nga aksi i linjes.




Figura 49.: Shperndarjet perkatese te fushes elektrike nen secilen linje dhe nenstacion te tensionit te larte.

Komentet perkatese per vlerat e gradienteve maksimale dhe per korridoret e linjave me gradient p.sh. mbi 2 kV lexohen lirshem nga grafiku. Duke analizuar grafikun e figures 25 arrijme ne konkluzionet e meposhtme:

Per linja 400 kV kemi fushe elektrike me te madhe se 2 kV/m per x brenda zones ± 22 m (pra nuk lejohen ndertimet brenda ketij korridori);

Per linja 220 kV kemi fushe elektrike me te madhe se 2 kV/m per x brenda zones ± 16 m (pra nuk lejohen ndertimet brenda ketij korridori);

Per linja 110 kV kemi fushe elektrike me te madhe se 2 kV/m per x brenda zones ± 10 m (pra nuk lejohen ndertimet brenda ketij korridori);

Te tre konkluzionet e mesiperme perputhen plotesisht me normat italiane te dhena ne seksionin 7.2.7.1&2 (standarte ne vende te ndryshme).

7.12.9 Shperndarja e fushes magnetike nen linjat e tensionit te larte.

Per te plotesuar analizen perkatese duhet te shqyrtohet edhe shperndarja e fushes magnetike, dmth densitetin e saj ne hapesiren e linjes; ne kete kendveshtrim flitet per shperndarje te vektorit B ne funksion te largesise x nga mesi i linjes. Sic edhe eshte shprehur me siper formulat llogaritese jane duale me ato te fushes elektrike. Analiza cilesore ndihmon duke patur parasysh se induksioni B eshte ne perpjestim te drejte me rrymen i dhe invers propocional me largesine $r(x)$. Duke mbajtur parasysh se ne nje percjelles te vetmuar kemi:

$$B = \mu \cdot H = \mu \frac{i}{2 \cdot \pi \cdot r}$$

Ky fakt na con ne perfundimin se vektori B , intensiteti i saj, ndryshon ne lidhje me rregjimin e punes se linjes (ne funksion te ngarkeses i).

7.12.9.1 Metodika e llogaritjes se fushes elektrike mban parasysh:

Formulat llogaritese te trajtuara me poshte per intensitetin e fushes elektrike dhe intensitetin e fushes magnetike.

- Komponentja vertikale e fushes elektrike e krijuar nga linja e tensionit te larte ne toke percaktohet nga shprehja:

$$E_y = k_1 \cdot U \cdot \left[A - \frac{1}{2}(B + C) + j \frac{\sqrt{3}}{2}(B - C) \right] \quad \left(\frac{kV}{m} \right) \quad (1)$$

- Komponentja horizontale e fushes magnetike e krijuar nga linja e tensionit te larte ne, (ose prane) siperfaqes se tokes percaktohet nga shprehja:

$$B_x = k_2 \cdot I \cdot \left[A - \frac{1}{2}(B + C) + j \frac{\sqrt{3}}{2}(B - C) \right] \quad (T) \quad (2)$$

Ne shprehjet (1) & (2) kemi keto parametra qe llogariten me formulat e meposhtme:

$$A = \frac{h_1}{(x - d_1)^2 + h_1^2} \quad B = \frac{h_2}{(x - d_2)^2 + h_2^2} \quad C = \frac{h_3}{(x - d_3)^2 + h_3^2}$$

h, d, x – madhesite ne metra (m)

U – tensioni faze-faze ne kV

I – rryma ne Amper

k_1, k_2 – konstante perkatese te zgjedhura ne literaturen universitare teknike.

Formula llogaritese e E eshte teresisht duale me ate te B , sepse sic tregohet ne formule kemi te ndryshem vetem koeficientet para kllapave qe e kalojne problemin nga fusha elektrike E ne fushen magnetike B .

7.12.10 Objekti i llogaritjes: Ndertimi/Zevendesimi i Linjes 110 kV dhe ndertimi/zgjerimi/fuqizimi i nenstacioneve perkates

Linja 110 kV (Projekti Juglindoror) eshte 130.747 km fillon ne Memaliaj dhe perfundon ne Korce (Zemlak). Ne vijim jane dhene segmentet e kesaj linje:

Memaliaj-Kelcyre	23,220 m
Kelcyre-Permet	15,762 m
Permet- Erseke	55,926 m
Erseke - Korce	35,838 m
Sesioni total, m	130,746 m




Figura 50.: Shperndarja e Fushes Elektrike per linjat e tensionit te larte 110 kV Nst. Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak (ne aksin e x- eshte distanca nga aksi i linjes dhe ate y- eshte fusha elektrike e shprehur ne kV/m).




Figura 51.: Shperndarja e Fushes Magnetike per linjat e tensionit te larte 110 kV Nst. Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak (ne aksin e x- eshte distanca nga aksi i linjes dhe ate y- eshte fusha magnetike e shprehur ne nanoT).

Rezultatet e llogaritjeve jane dhene ne figurat 50-51.

Perfundimi i Llogaritjeve:

Po te krahasohen vlerat e llogaritura prej 0.46 kV/m ne aksin e shtylles dhe 0.23 kV/m (17 metra nga aksi i shtylles) persa lidhet me fushen elektrostатike dhe respektivisht 0.60 nanoT ne aksin e shtylles dhe 0.15 nanoT (17 metra nga aksi i shtylles) persa lidhet me fushen magnetike me standartet perkatese te ekspozimeve te lejuara te zgjatura ne fushe elektromagnetike: 5kV/m dhe 0.1mT, ato jane mjaft te vogla dhe po te kemi parasysh qe njerezit atje kalojne shume rralle rezulton se linja 110 kV te marre ne shqyrtim, nuk paraqet asnje problem persa lidhet me ndotjen nga fushat elektrostатike te linjes dhe nenstacioneve perkatese.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PER LINJEN 110 kV DHE NENSTACIONET PERKATESE

Rrjeti i shpërndarjes tashmë paraqet vulnerabilitet të qartë klimatik dhe ka nivel të lartë të humbjeve teknike dhe komerciale (32% në 2009). Ndonëse rrjetet e qyteteve të Gjirokastrës, Korces janë përgjithësisht në gjendje të mirë, ka pjesë të rëndësishme të rrjetit të shpërndarjes të cilat duhen përmirësuar sidomos në Memaliaj, Permet, sidomos ato që u shërbejnë komuniteteve rurale dhe malore, të cilat tashmë nuk kanë furnizimin të sigurtë me energji për shkak të përkeqësimit të rrjetit. Siç është paraqitur në seksionet e mesiperme, sistemi i transmetimit të energjisë është përmirësuar kohët e fundit, duke e përafuar atë me standardet e BE, dhe investimet në vazhdim janë përqëndruar në përmirësimin e interkoneksionit rajonal. Humbjet teknike në rrjetin e transmetimit në vitin 2009 ishin 272 GWh (3.4%) (Bilanci elektrik i OST 2010). Për shkak të përmirësimeve të fundit teknike të sistemit të transmetimit, performanca e tij nuk pritet të preket ndjeshëm nga ndryshimet e parashikuara në temperatura dhe reshje. Megjithatë, ia vlen të përmendet se për momentin, standardet e BE-së nuk marrin parasysh ndryshimet klimatike dhe specifikimet teknike mund të kërkojnë rishikim në vitet që vijnë. Në të vërtetë, Dokumenti White Paper mbi Adaptimin i BE-së i referohet nevojës për të shqyrtuar dhe përditësuar rregulloret e BE-së në dritën e parashikimeve të ndryshimit të klimës. (Komisioni Europian, 2009).

Erërat e forta mund të shkaktojnë edhe dëmtime në linjat e tensionit të lartë. Kapaciteti i komuniteteve për të përballuar ndërprerjet e furnizimit me energji (dhe shërbime të tjera) është shumë e varur nga niveli i zhvillimit ekonomik. Për shembull, bizneset e vogla mund të mos kenë gjeneratorë edhe pasja e tyre shkakton rritje të konsiderueshme të kostos së hoteleve në këto zone me potencial të lartë të turizmit dhe ndotje mjedisore shumë të lartë. Edhe në qoftë se efekti i energjisë së ndërprerë mund të menaxhohet me përdorimin e gjeneratorëve, mbajtja e tyre ka kosto shtesë kapitali dhe operative.

Temperaturat në rritje për shkak të ndryshimeve klimatike do të dëmtojnë fare pak gradualisht efikasitetin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes, duke zvogëluar aftësinë e linjave të transmetimit të humbin nxehësinë në mjedisin e tyre. Në qoftë se ndryshimi i klimës çon në rritjen e reshjeve të dimrit, ngjarjet e dëmshme mund të ndodhin më shpesh nëse rrjeti i shpërndarjes nuk modernizohet, me pasojë përkeqësimin e ndikimeve sociale. Për shkak se parashikimet e ndryshimeve të ardhshme në erë janë shumë të pasigurta, nuk është e mundur të thuhet me siguri nëse dëmtimi i linjave të energjisë nga këto ngjarje do të ndodhë më shpesh. Megjithatë, rritja e intensitetit të reshjeve mund të çojë në ndodhi më të shpeshta të rrëshqitjeve të dheut, të cilat ndikojnë në linjen e re të transmetimit në terrene kodrinore.

Potencialet negative që përshkruam më sipër mund të minimizohen duke marrë një sërë masash. Ky seksion diskuton potencialin negativ dhe masat që duhen marrë për të përmirësuar dhe reduktuar ndikimin në mjedis. Një analizë fillestare është bërë për të përcaktuar përafërsisht kostot në këto seksione.

8.1 Potencialet Ndotese te Mjedisit dhe masat e mitigimit se bashku me kostot perkatese gjate ndertimit dhe operimit te Linjes 110 kV te Juglindjes dhe apo ndertimi/zgjerimi/fuqizimi i nenstacioneve perkates

Efektet potenciale ndotese te mjedisit dhe masat e mitigimit gjate fazes se ndertimit dhe ne fazen e operimit jane prmbledhur ne tabelen 19. Ne keto tabela identifikohen masat mitiguese (zbutese) per te minimizuar cdo lloj aktiviteti. Per te bere te mundur reduktimin e potencialeve te mundeshme ndotese te mjedisit ne kete plan te zbutjes se ndikimeve ne mjedis jane perfshire edhe planet inxhinjerike dhe praktikatat me te mira menaxhuese.

Tabela 19.: Efektet potenciale ndotese te mjedisit, masat mbrojtese dhe kostot e peraferta si gjate fazes se ndertimit ashtu edhe gjate fazes se operimit te linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe zgjerimet apo ndertimet e nenstacioneve perkatese				
Aktivitetet	Efektet Potenciale	Plani i Mitigimit	Pergjegjsia	Kosto e Perafert
Pastrimi dhe pergatitja e sheshit	Humbje e Drureve	Sic u permend me siper do te priten disa molle, kumbulla dhe drure te tjere frutore. Asnje dru nuk do te pritet qe eshte jashte vendit te ndertimit te linjes apo zgjerimit te nenstacioneve. Nga i gjithë korridori qe perben linjen vetem 3-5% mund te kaloje prane zonave me ullij, agrume dhe drure frutore.	Kontraktori qe do te zgjidhet per ndertimin e linjes dhe zgjerimin e nenstacioneve	70000 EURO
Pastrimi dhe pergatitja e sheshit	Zhurma te makinerive gjate pergatitjes se sheshit	Makinerite e punes duhet te plotesojne Standartet e Bashkimit Europian 2000/14/EC te Majit 2000 si dhe standartet shqiptare per te bere te mundur mbajtjen e nivelit te zhurmave brenda te kufijve te lejuar. Perpare fillimit te punes do kerkohet dokumenti i kontrollit teknik per nivelin e zhurmave.	Kontraktori EPC dhe OST	Shume te vogla
Marrja ne perdorim te perkohshem e tokes	Konflikt me perdorimin aktual te tokes, shqetesime te ndryshme qe mund ti shkaktohen komunitetit lokal.	Do te merret toke ne perdorim te perkohshem per te vendosur makineri gjate procesit te punes rreth shtyllave te tensionit. Do kryhet demshperblim konform legjislacionit ne fuqi.	Kontraktori EPC dhe OST	55000 EURO
Hedhja e materialeve (dheut) te nxjerre nga pergatitja e	Nderhyrje ne sistemin e drenazhimit	Hedhja e materialeve (dheut) duhet te behet ne vende te miratuara nga autoritetet lokale dhe nuk do te shkaktohen probleme te	Kontraktori EPC dhe OST	58000 EURO

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

sheshit dhe hapja e korridoreve		ndotjes se mjedisit ne keto zona, pra as ne sistemin e drenazhimit, ne se ka.		
Hedhja e materialeve (dheut) te nxjerre nga pergatitja e sheshit dhe hapja e korridoreve	Nderhyrje ne toke dhe qe do te sjelli shqetesime te ndryshme	Autoritet lokale duhet te aprovojne vendin ku do te behet hedhja e materialeve (dheut), dhe gjithashtu do te monitorohet ky aktivitet prej tyre, ne menyre qe te mos krijoje shqetesime.	Kontraktori EPC dhe OST	65000 Euro
Lidhja linjes dhe nenstacioneve perkatese me rrjetat e transmetimit 110 kV	Nderhyrje ne toke dhe qe mund te sjelli shqetesime te ndryshme	Madhesia e tokes qe duhet te perdorur per korridorin e linjes 110 kV do te jete dhe brenda normave te lejuara per te mos pasur ndikim nga fushat elektrike dhe fushat magnetike. Administrimi i tokes per korridoret e linjave duhet te behet bazuar ne Ligjin Shqiptar Nr. 8561, dt. 22/12/1999 dhe bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave No. 126, dt. 23/3/00; Vendimin e Keshillit te Ministrave No. 147, dt 31/3/00.	Kontraktori EPC dhe OST	45000 EURO
Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme	Kane potencial te larte per deme ne shendet dhe ekosisteme, kontaminojne token dhe ujin nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme	Te gjitha punetoret qe do te punojne per ndertimin e linjes duhet te trajtohen per sigurine ne pune dhe trajtimin e materialeve te rrezikshme. Ne ndertimin e linjes nuk do te perdoren materiale te rrezikshme (lubrifikante apo solvente e ndryshem) por ne cdo rast te mundshem ato do te paketohen, etiketohen dhe ruhen sipas legjislacionit dhe rregullave ne fuqi.	Kontraktori EPC dhe OST	49000 EURO
Forca puntore	Fluksi i punetoreve per ndertimin e nst. do te krijoje presion per shtepi dhe burime te tjera ne komunitet.	Fluksi i punonjesve do te jete 150-200 puntore ne ndertimin e linjes. Gjersa Tepelena, Erseka, Korca jane vetem rreth 10 km larg linjes, punetoret do te jene banore te zonave perreth dhe nuk do krijojne probleme strehimi.	Kontraktori EPC dhe OST	38000 EURO
Dergimi i materialeve dhe pajisjeve ne shesh	Kjo do te rrisi trafikun dhe emetimin e pluhurit ne atmosfere.	Permiresimi i rrugeve ndihmese do te sjelli dhe shmangien e trafikut te renduar. Nga ana tjetere sperkatja me uje dhe mbulimi i	Kontraktori EPC dhe OST	38000 EURO

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

		makinave te transportit te dheut kur dalin nga sheshi do te beje te mundur reduktimin e pluhurit ne atmosfere.		
Hedhja e mbeturimave te ngurta	Probleme shqetesuese me shendetin dhe ndotje te mjedisit	Mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te linjes do te duhen te hidhen ne vendet e percaktuara nga komuniteti vendor ne baze te nje ndermarrje te licencuar per kete qellim per te mos shkaktuar probleme me shendetin dhe ndotjen e mjedisit.	Kontraktori EPC dhe OST	28000 EURO
Hedhja e mbeturinave te lengeta	Probleme shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit	Mbetjet e lengta qe mund te gjenerohen gjate ndertimit dhe operimit te linjes do te duhen te trajtohen nga ndermarrje te licencuara per kete qellim. Nuk lejohet hedhja e drejteperdrejte e mbetjeve te lengeta ne mjedis te hapur e ne vijat ujore.	Kontraktori EPC dhe OST	32000 EURO
Operimi i pajisjeve dhe makinerive	Zhurma te ndryshme qe mund te vijne nga pajisjet dhe makinerite	Zhurma brenda niveleve te lejuara emetohen nga transformoret dhe celesat e ndryshem qe jane pjese e kesaj Linje 110 kV Nst. Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak brenda nivelit 20 decibel.	Kontraktori EPC dhe OST	38000 EURO

8.2 Programi i monitorimit te mjedisit gjate ndertimit dhe operimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe ndertimet/fuqizimet/zgjerimet e nenstacioneve perkates

Secili nga paramtrat e identifikuar gjate fazes se ndertimit dhe gjithashtu percaktuar ne planin e mitigimit do te duhet te monitorohet gjate fazes se ndertimit. Ne tabelen 20 jane dhene paramtrat qe do te duhen te monitorohen gjate fazes se ndertimit.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundeshme qe do t'i vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i Linjes dhe zgjerimit te nenstacioneve jane marre parasysh. Kjo do te lejoje ndjekien e programit dhe marrjen e masave korrigjuese perpara se ndonje dem potencial te behet realitet. Programi i monitorimit per secilen ndotje potenciale qe mund t'i shkaktohet mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikqyret nga specialistet e Agjensive Rajonale te Mjedisit te Gjirokastrës dhe Korces. .

Tabela 20.: Plani i Monitorimit gjate Ndertimit				
Pastrimi dhe pergatitja sheshit	dhe	Praktika e prerjes se drureve per pergatitjen e sheshit duhet te realizohet ne prani te specialisteve te sherbimit pyjor dhe komunitetit.	Kontraktori EPC dhe OST	
Pastrimi dhe		Minimizimi i errozionit duhet te jete detyre primare	Kontraktori EPC	

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

pergatitja sheshit	e	gjate pergatitjes se sheshit te nenstacionit.	dhe OST
Pastrimi dhe pergatitja sheshit	dhe e	Permiresimi dhe funksionimi i plote i sistemit te dranzahimit duhet gjithashtu te monitorohet nga komuniteti.	Kontraktori dhe OST EPC
Hedhja e materialeve (dheut) te nxjerre nga pergatitja e sheshit dhe hapja e korridorit	e	Monitorimi i largimit te materialeve te perdorura si dherat, per ne vendin e percaktuar nga autoritetet lokale, do te behet edhe nga komuniteti vendor. Gjithashtu do kryhet mbajtja e nje procesverbali te rregullt per materialet (dheun) e nxjerre dhe vendin e sistemit te tij nga pergatitja e sheshit dhe hapja e korridorit.	Kontraktori dhe OST EPC
Lidhja e linjes me rrjetin e transmetimit 110 kV	e	Dokumentimi i tokes se perdorur vetem per kalimin e korridorit te linjes dhe te ngacmohet sa me pak te jete e mundur toka bujqesore. Lidhja e linjes me rrjetin e transmetimit 110 kV do kerkoje nderprerje te perkoheshme te energjise elektrike, qe gjithashtu kerkon monitorim te te gjitha parametrave teknike.	Kontraktori dhe OST EPC
Perdorimin e ujit te pijshem ne nst. perkatese	e	Monitorim i furnizimit me uje, do te perdoret vetem ajo sasi qe eshte kontraktuar dhe nuk do perdoret per qellime te tjera vecse per uje te pijshem.	Kontraktori dhe OST EPC
Hedhja e mbeturimave te ngurta	e	Dokumentimi dhe monitorimi i mbeturinave te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara.	Kontraktori dhe OST EPC
Forca punetore		Forca punetore do te jete nga zonat perreth dhe do te trajnohen para fillimit te punes. Nje ambulance me mjetet me te nevojshme te ndihmes se shpejte do te vendoset ne sheshin e ndertimit.	Kontraktori dhe OST EPC
Dergimi i materialeve dhe pajisjeve shesh	i dhe ne	Inspektim i vazhdueshem duhet te realizohet ne lidhje emetimet e pluhurit te atmosfere gjate transportit te materialeve dhe pajisjeve ne shesh.	Kontraktori dhe OST EPC
Hedhja e mbeturimave te lengeta	e	Monitorimi i parametrave operacionale duhet te kryhet me nje perkujdesje te larte duke perfshire mbeturinat e lengeta.	Kontraktori dhe OST EPC

Ne tabelen 21 jane dhene paramtrat qe do te duhen te monitorohen gjate fazes se operimit.

Tabela 21.: Plani i Monitorimit gjate Operimit			
Operimi i pajisjeve dhe makinerive	i dhe	Nje skenar baze per zhurmat e mundshme para fazes se ndertimit, gjate ndertimit dhe operimit duhet te realizohet. Gjate gjithë procesit te operimit duhet te monitorohet niveli i zhurmave nuk duhet ti kaloje 20 decibel.	OST-Konsulenca – Agjensite Rajonale te Mjedisit te Gjirokastres dhe Korces
Sistemi i trajtimit ujrave te zeza	i te	Sistemi i trajtimit te ujrave te zeza do te monitorohet ne baze te parametrave te lejuar nga legjislacioni ne fuqi.	OST-Konsulenca – Agjensite Rajonale te Mjedisit te Gjirokastres dhe Korces
Magazinimi dhe trajtimi	dhe i	Nuk parashikohet te perdoren materiale te rrezikshme, por ne cdo rast ato do te	OST-Konsulenca – Agjensite Rajonale

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

materialeve te rrezikshme	identifikohen, trajtohen dhe magazinohen konform legjislacionit ne fuqi. Ky proces do te jete nen mbikqyrjen e plote te OST dhe Agjensive Rajonale te Mjedisit Gjirokaster dhe Korce.	te Mjedisit te Gjirokastres dhe Korces
Lidhja linjes me rrjetat e transmetimit 110 kV.	Monitorim i intensitetit te fushes elektrike dhe fushes magnetike si rezultat i linjave te tensionit te larte qe hyjne/dalin ne nenstacion dhe zbarave te tensioneve 110 kV dhe krahasimi i tyre me vlerat e lejura te dhena ne kete VNM te permbledhur ne seksionet perkatese.	OST-Konsulenca – Agjensite Rajonale te Mjedisit te Gjirokastres dhe Korces

Secili nga parametrat e identifikuar me siper gjate fazes se ndertimit dhe fazes se operimit te linjes dhe nenstacioneve perkates te percaktuar ne planin e mitigimit do te duhet te monitorohen nga autoritet e mesiperme gjate fazes se ndertimit dhe operimit te linjes dhe nenstacioneve perkates.

9. PËRPUTHJA E PROJEKTIT TE NDERTIMIT TE LINJES 110 kV DHE ZGJERIMI APO NDERTIMI I NENSTACIONEVE PERKATESE ME PLANET E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE ME PLANET E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË ZONËS QARKUN TE GJIROKASTER DHE KORCE

Ndertimi i Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe zgjerimet apo ndertimet e nenstacioneve perkatese do te kryhet ne Qarqet e Gjirokastres dhe Korces i cili perfshin edhe Saranden. Ndertimi i kesaj linje eshte ne perputhje me planet e rregullimit te territorit te Qarkun e Gjirokastres dhe do te beje te mundur sigurimin e furnizimit ne menyre te qendrueshme me energji elektrike te ketij rajoni me shume rendesi per vendin, me nje popullesi rreth 350000 banore (ne rrang prefekturash) dhe me shume biznese sidomos ne fushen e sherbimeve, industrise se lehte, perunimit te ushqimeve dhe turizmit.

10. PËRMBLEDHJA E KËSHILLIMEVE ME ORGANET E QEVERISJES VENDORE, PUBLIKUN DHE ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE PËR MJEDISIN DHE MENDIMET E TYRE

Ne VKM Nr. 994 date 02.07.2008 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin" si dhe ne Ligjin per Kryerjen e VNM eshte theksuar se projekti dhe draft-raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis i neshetrohen debatit publik, ku marrin pjesë përfaqësues të publikut të interesuar, të autoriteteve qendrore e lokale, te organizatave jofitimprurëse për mjedisin dhe propozuesi.

Propozuesi i ketij projekti do te organizoje takime me perfaqesuesit e komunitetit dhe palet e interesuara, ku specialistet qe kane hartuar projektin inxhinjeric dhe specialistet e mjedisit te OST-se do fokusohen ne te dhenat teknike lidhur me projektin inxhinjeric te propozuar, kriteret baze mbi te cilat eshte perzgjedhur korridori i kesaj linje, ndikimet ne mjedis qe mund te sjelle zbatimi i ketij projekti sidomos per komunitetin qe jeton prane zones ku zbatohet projekti dhe masat per minimizimin/mitigimin e tyre, si dhe rendesine shume te madhe qe ka zbatimi i ketij

VNM PER NDERTIMIN E LINJES SE RE 110 KV NDERMJET PERMETIT-ERSEKES; ZEVENDESIMIN E LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET ERSEKES-KORCES; INSTALIMIN E QARKUT TE DYTE TE LINJES EKZISTUESE 110 KV NDERMJET KORCES-ZEMBLAKUT; ZGJERIMIN E NENSTACIONEVE TE ERSEKE, TE KORCES DHE ZEMBLAKUT

projekti jo vetem per zhvillimin e kesaj zone me potencial turistik te rendit te pare por per mbare vendin.

Perfaqesuesit e komunitetit do te ndjekin te gjithe planin e monitorimit te mjedisit si gjate fazes se ndertimit ashtu edhe gjate fazes se operimit te tij.

Me qellim berjen sa me te njohur per publikun e gjere ne pergjithesi dhe sidomos per komunitetet ku do te zbatohet ky projekt ne Bashkite dhe Komunat e Qarqeve Gjirokaster dhe Korce, OST sh.a ka vendosur ne websitin e saj me adrese: www.ost.al Draft-Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per Projektin ne fjale.

Agjensite Rajonale te Mjedisit te Qarqeve te Gjirokastrës dhe te Korces me ndihmen e OST-se duhet te vendose draft-raportin permbledhes te VNM (pra kete dokument) ne nje vend te dukshem i cili mund te behet i njohur per publikun e gjere.

Agjensite Rajonale te Mjedisit te Qarqeve te Gjirokastrës dhe te Korces gjithashtu duhet te vendose ne websitin e saj kete Draft-Raport VNM dhe ne se se kjo Agjensi nuk ka web faqe duhet ta vendose ate ne websitin e Qarqeve te Gjirokastrës dhe te Korces.

Gjithashtu per personat e interesuar OST sh.a ka vene ne dispozicion pa pagese kopje te Draft-Raportit te VNM per kete projekt ne adresat e meposhtme:

Zj. Etleva Kondi
Shefe e Njesise Zbatimit Projekteve
OST sh.a Bulevardi "Gjergj Fishta" Nr. 10
Tirane
Tel/fax: 2220812
E-mail: e.kondi@ost.al

Zj. Zhuljeta Hoxha
Specialiste per mbrojtjen e mjedisit
OST sh.a Bulevardi "Gjergj Fishta" Nr. 10
Tirane
Tel/fax: 2400593
E-mail: xh.hoxha@ost.al

Zj. Arzika Preci
Specialiste per mbrojtjen e mjedisit
OST sh.a Bulevardi "Gjergj Fishta" Nr. 10
Tirane
Tel/fax: 2400593
E-mail: a.preci@ost.al

Gjithashtu jane derguar per tu lexuar nga publiku i ndikuar, kopje te ketij Draft-Raporti VNM pa pagese, tek Njesite Operative e Transmetimit ne Fier dhe Korce, qe jane pikat qendrore e sistemit te transmetimit te energjise per gjithe zonen juglindore te Shqiperise, ne adresen:

Njesia Operative e Transmetimit ne Fier

Z. Markelian Zarka, Pergjegjes i Njesise Fier, Tel: 069 4076461

Z., Pergjegjes i Njesise Korce, Tel:

Njoftimin per Debatin Publik per Projektin e Ndertimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe nenstacioneve elektrike perkatese, OST sh.a e ka publikuar ne disa gazeta me te rendesishme ne vend per disa dite radhazi duke filluar nga data, ku ka ftuar publikun te njihet me Draft-Raportin e VNM per projektin e ndertimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe nenstacioneve elektrike perkatese, qe eshte dhe objekt i debatit publik dhe ka ftuar publikun qe te pergatitet per debat per te cilin kerkohen verejtjet, sugjerimet dhe propozimet perkatese.

(Miratimi i publikut do te merret pas takimit me publikun qe do te zhvillohet ne rrethin perkates dhe prezantimit te ketij Draft-Raporti te VNM.)

11. MASAT REHABILITUESE, NË RAST NDOTJEJE DHE DËMTIMI TË MJEDISIT, SI DHE KOSTO E TYRE GJATE NDERTIMIT DHE OPERIMIT TE LINJES 110 kV DHE NENSTACIONEVE PERKATESE

Nder masat me te rendesishme rehabilituese ne rast ndotje apo demtimi te mjedisit gjate zbatimit te ketij projekti, eshte rehabilitimi i siperfaqeve qe do demtohen gjate vendosjes se shtyllave te tensionit te larte me voltazh 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe shesheve te nenstacioneve perkates.

Jane perzgjedhur kryesisht ato siperfaqe qe jane te zhveshura nga bimesia per te shmangur demtimin e tyre. Gjithashtu jane perzgjedhur zona ku do te kaloje linja sa me larg te jete e mundur nga zona te banuara per te rritur sigurine e jetes se komunitetit, per te shmangur demtimet e pronave, te kulturave bujqesore, drureve dhe per te shmangur konfliktin me komunitetin.

Sidoqofte aty ku do te punohet per vendosjen e shtyllave, per hapjen e rrugeve provizore, do te kerkohet te rehabilitohen siperfaqet e demtuara, mbetjet do te zhvendosen ne vendet e paracaktuara nga komuniteti vendor.

Gjate zbatimit te ketij projekti do te kerkohet edhe prerje e drureve, proces i cili do te kryhet konform legjislacionit shqiptar. OST ne bashkepunim me Drejtorite e Sherbimit Pyjor dhe Komunitetin Vendor do te bashkrendojne punen duke marre ne konsiderate masat rehabilituese per kete qellim. Gjithashtu gjate zbatimit te ketij projekti ne rast se do te kete rrjedhje apo pikime te vajrave apo lubrifikanteve, te cilat duhet te monitorohen dhe te merren masa rehabilituese sic jane largimi i mases se ndotjes dhe zhvendosja e saj ne vende te posacme te miratuara per kete qellim, ne perputhje me legjislacionin shqiptar mbi mbrojtjen e mjedisit.

Analiza e bere ne seksionet e mesiperme si dhe eksperiencat boterore ne ndertimin e linjave te tensionit te larte tregojne se niveli i fushave elektromagnetike, rezulton mjaft i ulet i krahasur me standartet nderkombetare, keshtu qe ndertimi dhe operimi i Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak nuk krijon impakte negative mbi mjedisin, aq me teper qe Linja do te ndertohet ne larg zonave te banuara dhe do ti sherbeje ne maksimum zhvillimit te turizimit.

Sidoqofte ne takimet qe do organizohen do te trajtohet kjo tematike e cila eshte me e prekshme nga ana e komunitetit.

Duhet te theksojme se ndertimi i kesaj linje kaq te rendesishem per vendin tone do te ndikojte pozitivisht ne permiresimin e dukshem te infrastruktures se zones ky propozohet te ndertohet. Si pasoje e ndertimit te saj do te behet i mundur furnizimi ne menyre te qendueshme dhe te panderprere i zones me turisitike te vendit tone ate te Rivieres Joniane e cila per momentin po vuan cilesine e dobet te furnizimit. Efektet potenciale ndotese qe mund t'i vijne mjedisit, masat parandaluese ne rast ndotje dhe demtimi te mjedisit si dhe kosto e tyre gjate ndertimit dhe operimit te linjes se bashku me planin e monitorimit u pershkruan gjeresisht ne seksionet 7 dhe 8 te ketij dokumenti.

12. KOPJA E LICENCËS SË PERSONIT FIZIK OSE JURIDIK, QË KA PËRGATITUR RAPORTIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PER LINJEN 110 kV DHE ZGJERIMET APO NDERTIMET E NENSTACIONEVE PERKATES

Draft-Raporti i VNM per Projektin e ndertimit te Linjes 110 kV Memaliaj-Kelcyre-Permet-Erseke-Korce-Zemlak dhe zgjerimin e nenstacioneve perkates eshte pergatitur nga Ing. Z. Gezim Dapi, inxhinjer me eksperience ne kete fushe, pasi ka hartuar deri tani disa VNM ne fushen e sektorit elektroenergjitik (linja dhe nenstacione, HEC-e te vegjel dhe impianteve te tjera te gjenerimit te energjise). Kopje e licences eshte dhene bashkangjitur.

Literatura

1. Projekti i Zgjerimit te Sistemit te Transmetimit (OST), WYG 2009 (financuar nga Bashkimi European)
2. Projekti i Zgjerimit te Sistemit te Gjenerimit (KESH), MVV DECON 2002 (financuar nga Banka KfW)
3. Projekti i Zgjerimit te Sistemit te Shperndarjes (KESH), MVV DECON 2002 (financuar nga Banka KfW)
4. Plani i Zhvillimit Rajonal te Ekonomise dhe Turizimit per Qarkun e Gjirokastrës
5. Plani i Zhvillimit Rajonal te Ekonomise dhe Turizimit per Qarkun e Korces
6. Strategjia Kombetare e Energjise, aprovuar nga Keshilli i Ministrave – Qershor 2003
7. Te dhenat statistikore ne lidhje me temperaturat e ajrit te jashtem per rrethin e Tepelenes (publikime te Institutit te Metereologjise)
8. Te dhenat statistikore ne lidhje me temperaturat e ajrit te jashtem per rrethin e Permetit (publikime te Institutit te Metereologjise)
9. Te dhenat statistikore ne lidhje me temperaturat e ajrit te jashtem per rrethin e Ersekës (publikime te Institutit te Metereologjise)
10. Te dhenat statistikore ne lidhje me temperaturat e ajrit te jashtem per rrethin e Korces (publikime te Institutit te Metereologjise)
11. Te dhenat statistikore ne lidhje me shpejtesine e eres per rrethin e Tepelenes (publikime te Institutit te Metereologjise)
12. Te dhenat statistikore ne lidhje me shpejtesine e eres per rrethin e Permetit (publikime te Institutit te Metereologjise)
13. Te dhenat statistikore ne lidhje me shpejtesine e eres per rrethin e Ersekës (publikime te Institutit te Metereologjise)
14. Te dhenat statistikore ne lidhje me shpejtesine e eres per rrethin e Korces (publikime te Institutit te Metereologjise)
15. Te dhenat statistikore ne lidhje me rrezatimin diellor per rrethin e Tepelenes (publikime te Institutit te Metereologjise)
16. Te dhenat statistikore ne lidhje me rrezatimin diellor per rrethin e Permetit (publikime te Institutit te Metereologjise)
17. Te dhenat statistikore ne lidhje me rrezatimin diellor per rrethin e Ersekës (publikime te Institutit te Metereologjise)
18. Te dhenat statistikore ne lidhje me rrezatimin diellor per rrethin e Korces (publikime te Institutit te Metereologjise)
19. Komunikimi i Pare Kombetar per Vleresimin e Ndryshimeve Klimatike ne Shqiperi (financuar nga UNDP dhe pergatitur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave – 2004)
20. Komunikimi i Dyte Kombetar per Vleresimin e Ndryshimeve Klimatike ne Shqiperi (financuar nga UNDP dhe pergatitur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave – 2009)
21. Bilanci Energjetik per Shqiperine per vitet 1990-2008
22. Bilanci Elektroenergjetik per Shqiperine per vitet 1990-2008; etj.
23. Gjeografia e Shqiperise, shtepia e librit universitar-2009